

Tryeza e rrumbullakët e parlamentarëve dhe ekspertëve për çështje kushtetuese

20-22 Korrik, Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë



Tryeza e rrumbullakët e parlamentarëve dhe ekspertëve për çështje kushtetuese

20-22 Korrik, Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

Parathënie	4-5
Përmbledhja ekzekutive	6-8
Vërejtjet hyrëse	9-11
Raportet e mbajtësve të procesverbalit	12-21
Lista e pjesëmarrësve	22
Prezentimet	23-72

Prishtinë, 2 shtator 2006

Megjithëse negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës janë duke hyrë tani në fazat përfundimtare, procesi nuk do të kompletohet pa një tranzicion tërësor politik. Pavarësisht nga statusi i ardhshëm i Kosovës, çelës për këtë tranzicion janë aranzhimet e reja kushtetuese për zëvendësimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së. Kushtetuta e re do t'i përfshijë, gjithashtu, dispozitat e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe qendrore që do t'i legjitimojnë plotësisht institucionet e formuara kohëve të fundit dhe përfaqësuesit e popullit të Kosovës.

Është një përpjekje e madhe dhe nuk është shumë herët të fillohet me diskutimin e çështjeve kushtetuese. Kosova ndodhet në një situatë specifike: disa çështje, duke përfshirë decentralizimin dhe mbrojtjen e minoriteteve do të zgjidhen në kuadër të bisedimeve për statusin e ardhshëm. Rrjedhimisht, rezultati i bisedimeve për statusin do t'i imponojë disa kufizime legjitime në lidhje me ushtrimin e kushtetues.

Megjithatë, procesi kushtetues nuk është i kufizuar me çështjet për të cilat është diskutuar në Vjenë. Kushtetuta do të krijojë institucione qeveritare, do të sigurojë ndarjen e kompetencave, do t'i definojë rolet dhe përgjegjësitë e niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe të drejtat e popullit të tij. Prandaj edhe është i qenësishëm procesi i hartimit, shqyrtimit dhe zbatimit të Kushtetutës.

Çka është më e rëndësishme, një proces i suksesshëm duhet të jetë legjitim dhe të perceptohet si i tillë nga populli i Kosovës. Me qëllim të sigurimit të legjitimitetit, procesi duhet të jetë transparent – sipas parimeve demokratike - dhe gjithëpërfshirës - t'i arrijë të gjithë qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh cilit grup i takojnë.

Fundi i një periudhe të gjatë të konfliktit dhe vuajtjes në Ballkan mund të arrihet vetëm nëpërmjet krijimit të një qeverisjeje të qëndrueshme demokratike, ku secili mund t'i njehë të drejtat dhe përgjegjësitë e veta të caktuara me kushtetutë dhe plotësisht ta përkrahë promulgimin dhe zbatimin e saj. Institucionet nuk mund të funksionojnë pa përkrahjen e të gjithëve, ndërsa mekanizmat e mbrojtjes nuk mund të jenë të efektshëm nëse nuk pranohen nga të gjithë, posaçërisht në një shoqëri të ndarë në suaza etnike.

Këto janë parimet dhe qëllimet që na kanë motivuar kur e kemi organizuar Tryezën e Rrumbullakët të Parlamentarëve dhe Ekspertëve për Çështjet Kushtetuese në Shkup prej 22-22 korrik të vitit 2006. Ngjarja bashkoi ekspertët ndërkombëtarë nga Evropa dhe SHBA-të me ekspertët dhe politikanët e të gjitha komuniteteve nga Kosova.

Qëllimi i këtij publikimi është të informohet publiku i gjerë për rëndësinë e një Kushtetute, të bëhet përmbledhja e çështjeve dhe rekomandimeve kryesore që kanë të bëjnë me hartimin e një kushtetute dhe sigurimi i disa udhëzimeve konkrete për mënyrën e fillimit të procesit kushtetues.



Ambasadori Werner Wnendt
Kryesuesi i Misionit të OSBE-s në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i Tryezës së Rrumbullakët të Parlamentarëve dhe Ekspertëve për Çështje Kushtetuese ishte që t'i tubojë ekspertët ndërkombëtarë, vendorë, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesit e tjerë politik dhe partiak për të diskutuar rreth çështjeve kushtetuese dhe njëherësh për të ndihmuar në krijimin e një qasjeje të përbashkët mbi rolin e Kushtetutës në shoqërinë demokratike.

Ndonëse supozohej se disa çështje që kanë të bëjnë me hartimin e Kushtetutës diskutohen ekskluzivisht në kuadër të bisedimeve rreth statusit (posaçërisht çështjet si mbrojtja e pakicave, trashëgimia kulturore dhe decentralizimi), megjithatë, për të siguruar një tranzicion të qetë politik do të duhej që disa çështje të tjera rreth Kushtetutës të shqyrtoheshin qysh tash, duke përfshirë këtu edhe vetë procesin kushtetues. Me këtë rast, dy pikëpamje të përbashkëta që u vunë në dukje nga pjesëmarrësit kishin të bënin me:

- Tranzicionin politik pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, që do të përfundojë me miratimin e një Kushtetute legjitime. Kjo Kushtetutë do të ishte rezultat i një procesi gjithëpërfshirës ku të gjithë qytetarët e Kosovës do ta jepnin kontributin e tyre për krijimin e një vizioni të përbashkët.
- Kushtetutën, që do të kishte një ndikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm në vetë institucionet. Qëllimi përfundimtar i Kushtetutës- Kushtetutës që do të sigurojë perspektivë evropiane- është që garantojë stabilitet dhe prosperitet jo vetëm në Kosovë, po edhe në mbarë rajonin.



Ndërkaq, sukcesi kryesor i Tryezës ishte që të faktojë se vizioni mbi rolin e Kushtetutës të jetë i përbashkët për të gjithë pjesëmarrësit. Në vijim po japim një raport, që është bazuar në komentet dhe rekomandimet e ekspertëve.



Institucionet, gjyqësori, zgjedhjet...
dhe çështja e të drejtave të minoriteteve

Kushtetuta duhet të sigurojë kohezion të brendshëm, prosperitet dhe stabilitet të jashtëm, theksoi njëri nga ekspertët. Ndërsa, elementet kryesore të saj, sipas tij, janë ndarja e pushteteve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Ndarja e pushteteve: sistemi parlamentar dhe gjyqësori i pavarur

Gjatë diskutimeve rreth institucioneve dhe sistemit gjyqësor dukej se pjesëmarrësit ishin të interesuar veçanërisht rreth mënyrës së zbatimit efikas të dispozitave të Kushtetutës:

- Situata aktuale në institucione, në përgjithësi e sidomos në institucionet e sistemit gjyqësor u vlerësua si e pakënaqshme, ndaj pjesëmarrësit vunë në pah nevojën për zhvillimin e institucioneve funksionale.
- Gjer më tani, pesë palë zgjedhjet e mbajtura, që nga përfundimi i konfliktit, kanë qenë të lira, të ndershme dhe të drejta, ndaj kjo ka bërë që të shtohet besimin në sistemin demokratik. Megjithatë, me këtë rast u theksua nevoja për miratimin e sistemit zgjedhor me lista të hapura me qëllim që të shtohet legjitimiteti i përfaqësuesve të zgjedhur.
- Sipas shumicës së diskutuesve sistemi parlamentar është sistemi më fleksibil, më i përgjegjshëm dhe më i qëndrueshëm.
- Çështja e gjyqësorit të pavarur në Kosovë u cilësua si mjaft problematike nga disa pjesëmarrës, për shkak të mungesës së traditës.
- Po kështu u theksua edhe nevoja e krijimit të gjykatës kushtetuese me qëllim të interpretimit të kushtetutës dhe garantimit të respektimit të parimeve të saj. Megjithatë, kjo gjykatë nuk do të duhej të merrej me shqyrtimin e ankesave individuale (të paktën jo në fillim).

Rekomandime:

Rreth zgjedhjeve:

➤ Shumë kushtetuta përbajnë vetëm nga disa dispozita kryesore për zgjedhjet, ndaj zakonisht vendet me kushtetuta të këtilla angazhohen për hartimin e një ligji të veçantë, ndaras nga kushtetuta. Kjo bën të mundur që të krijohen norma të veçanta për t'u mbrojtur nga manipulimet eventuale nga partitë në pushtet, meqë kushtetuta vështirë ndryshohet.



- Disa parime “universale” (e drejta e secilit për të votuar dhe për t’u votuar), si dhe një mori parimesh që përcaktojnë “barazinë” (të drejtat e barabarta në zgjedhje; shpërndarja e qartë dhe e drejtë e ulëseve; barazia gjinore dhe e minoriteteve) do të duhej të përfshiheshin në dispozitat zgjedhore.
- “Ndershmëria” (e drejta që votuesit të formojnë opinionin e tyre, të jenë neutral dhe ndëshkimi i shkeljeve gjatë fushatës) dhe “fshehtësia” duhet patjetër të sigurohen.

Rreth gjyqësorit të pavarur:

- Gjyqësori duhet të: mbrojtë qytetarët nga shteti; ruajë balancin e pushtetit, të parimeve të legalitetit dhe të sundimit të ligjit; si dhe ta ruajë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor (fjala vjen, duke siguruar mbrojtjen nga politizimi, procedura gjyqësore të drejta, të jenë shpejta dhe me kosto të ulët dhe implementim adekuat të vendimeve të gjyqit).
- Kërkohej gjyqtarët të standardeve të larta (integritet, dinjitet të gjyqësorit) dhe me njohuri të thella të ligjit evropian.



Të drejtat njerëzore dhe të drejtat e minoriteteve: Mbrojtja kundruall efikasiteti

Ndonëse pjesëmarrësit nuk kishin për qëllim të diskutonin rreth çështjes së minoriteteve për arsye se këto çështje do të diskutoheshin gjatë procesit të statusit, megjithatë, kësaj çështjeje iu kushtua vëmendje e veçantë, ngase u ngrit në secilin sesion.

- Pjesëmarrësit vazhdimisht përsërisnin mendimin e tyre se kjo çështje shihej si një lloj “këmbimi apo kompromisi” midis krijimit të institucioneve efkase (që do të bënte të mundur prosperitetin), dhe mbrojtjes së minoriteteve (që do të bënte të mundur stabilitetin), duke spikatur se kjo e fundit nuk do të duhej të bëhej pengesë për të parën.
- Pjesëmarrësit po ashtu ishin dakord se një shoqëri e përçarë në baza etnike si Kosova, ndeshet me sfida më të mëdha kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave të pakicave se sa për mbrojtjen e të drejtave individuale.
- Disa përfaqësues vunë në dukje se mekanizmat mbrojtës duhet të kenë parasysh jo vetëm realitetin në Kosovë, por edhe situatën dhe interesat e veçanta të secilit komunitet.



Fjala vjen, kjo pikëpamje për “kompromisin” rreth çështjes së pakicave u përdor edhe me rastin e diskutimit të këtyre çështjeve:



- Zgjedhjeve dhe përfaqësimit: Pjesëmarrësit ishin dakord se përfaqësimi i minoriteteve ishte i rëndësishëm, por nuk u pajtuan për atë se si të arrihej një përfaqësim “i drejtë”. Madje ca nga pjesëmarrësit dyshonin se një shtet mund të quhet vërtetë demokratik nëse duhet të ketë ulëse të rezervuara, duke theksuar se sistemi aktual i Kosovës me ulëse të rezervuara ishte i padrejtë ndaj partive të shumicës.
- Gjyqësorit: Ca pjesëmarrës ishin të mendimit se definimi i natyrës dhe i larushisë së popullatës së Kosovës në Kushtetutën e Kosovës, së toku me deklaratën se gjyqësori duhet ta reflektojë këtë diversitet, do të mjaftonte për të garantuar diversitetin në emërimet që bëhen në sistemin gjyqësor. Përderisa procedura e emërimit nuk politizohet, atëherë emërimi sipas meritave do të bënte të mundur që automatikisht të sigurohet një larushi e personelit të sistemit gjyqësor.

Rekomandime:

- Të drejtat e minoriteteve: Në çdo definicion duhet të përfshihen jo vetëm të drejtat individuale të pjesëtarëve të një grupi, por edhe të drejtat kolektive të një grupi pakicë. Njëkohësisht, këto të drejta duhet të kenë një rol dhe funksion integruar.



- Përfshirja në Kushtetutë: Ekspertët sqaruan se të drejtat njerëzore, përfshirë këtu edhe të drejtat e minoriteteve janë vlera të domosdoshme, ngase ato lidhin shoqërinë me individin. Meqë kjo bazohet në ligjet e aplikueshme që përligjin obligimin për t'i mbrojtur të drejtat, atëherë këto të drejta dhe mekanizma mbrojtëse i takojnë Kushtetutës.
- Mekanizmat mbrojtëse: Spektri i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave njerëzore është ndarë në tri kategori (i brendshëm, i jashtëm dhe mekanizmat mbikombëtar). Akëçili syresh duhet të shqyrtohet me kujdes në mënyrë që të sigurohet një sistem mbrojtës më efikas dhe më gjithëpërfshirës.
- Përfshirja e ligjit ndërkombëtarë: Meqë shumica e instrumenteve për mbrojtjen e të drejtave njerëzore janë pjesë përbërëse e ligjit ndërkombëtarë, atëherë në Kushtetutë duhet të përfshihen edhe mekanizmat adekuatë për të siguruar integrimin e tyre në arkitekturën legjislativë vendore.

- Krijimi i besimit në sistem:: Lidhur me këtë ekspertët sqaruan dhe përsëritën disa herë se mënyra më e mirë për t'iu shporrur dilemave është që të krijohet vullneti i mirë dhe që ky kompromis të arrihet në këtë mënyrë: sa më shumë që grupet të kenë besim në sistem, aq më pak do të kenë nevojë për garanci dhe aq më efikase do të jenë institucionet.

Një proces kushtetues legjitim:

Krijimi i vullnetit politik

- Mbi legjitimitetin, përfshirjen dhe transparencën: Ekspertët shfrytëzuan rastin që të vejnë në dukje se procesi kushtetues luan një rol vendimtar jo vetëm në ndërtimin e vullnetit politik tek të gjitha grupet e shoqërisë, por edhe në sigurimin e një kushtetute legjitime. Procesi duhet të jetë gjithëpërfshirës ku të gjitha grupet mund të marrin pjesë në mënyrë transparente.
- Mbi rolin e politikanëve dhe ekspertëve: Gjatë procesit kushtetues, duhet të përcaktohet qartë si roli i politikanëve ashtu edhe i ekspertëve. Politikanët duhet të punojnë rreth ndërtimit të konsensusit. Ndërkaq, ekspertët, mbështetur në udhëzimet politike, duhet të impenjohen rreth gjetjes së një zgjidhjeje origjinale përmes studimeve krahasuese, veçanërisht me vendet e rajonit, duke mbajtur gjithnjë parasysh specifikat e Kosovës.

Sigurimi i legjitimitetit: Nevoja për përfshirje në proces si dhe për pronësi vendore dhe transparencë të procesit

- Sipas ekspertëve procesi kushtetues është zakonisht mjaft i gjatë, sidomos në shoqëritë e përçara në baza etnike (që është një fenomen që kërkon më tepër kohë për t'u tejkaluar se sa fjala vjen kur kemi përçarje për shkak të ideologjisë politike).
- Procesi kushtetues nuk duhet ngutur për shkak të interesave afatshkurtra. Kjo për faktin se shpejtësia mund të shkojë në dëm të arritjes së konsensusit politik dhe të rezultojë në institucione jofunksionale. Ndaj, lidhur me këtë, ekspertët theksuan nevojën që të kihet parasysh edhe agjenda e bashkësisë ndërkombëtare.

Procesi i statusit dhe kushtetuta: Faza e hartimit pas zgjidhjes së statusit

- Procesi kushtetues, nëse drejtohet si duhet, do të luajë një rol pozitiv në gjetjen e zgjidhjeve rreth mosmarrëveshjeve fillestare dhe njëherësh do sigurojë zbatimin e Kushtetutës.
- Procesi i hartimit të kushtetutës nuk duhet të përzihet me procesin e statusit me qëllim që të evitohet



përzjerja e politikës dhe ngecja eventuale e procesit, veçanërisht çështjet rreth të drejtave të njeriut.

- Procesi i statusit do të duhej të siguronte të paktën disa parime që do të merreshin parasysh gjatë hartimit të Kushtetutës. Së këndejmi, hartimi i saj duhet të bëhet vetëm pasi të dihet rezultati i negociatave.
- Njëherësh, duhet mbajtur parasysh se para se të fillohet me hartimin e Kushtetutës duhet të bëhen parapërgatitje serioze dhe shumë të rëndësishme, madje disa pjesëmarrës ishin të mendimit se Kuvendi do të duhej ta mandatonte një organ që të hartonte Kushtetutën, vetëm pasi të dihej rezultati i bisedimeve për statusin.



Rekomandime:

- Ekspertët bënë të qartë se gjatë fazës përgatitore, të gjitha forcat politike përfshirë këtu edhe të gjitha grupet duhet të bien dakord rreth këtyre çështjeve:
 - o Si të procedohet rreth hartimit të Kushtetutës?
 - o Kush duhet të jetë përgjegjës?
 - o Çfarë rregullash dhe procedurash duhet ndjekur?
 - o Si të kanalizohet kontributi i qytetarëve të Kosovës?
 - o Si të përfshihet dhe të merret parasysh kontributi i shoqërisë në këtë proces?
- Fare në fund, të gjithë pjesëmarrësit ishin dakord se përgatitjet patjetër duhet të fillojnë para se të mund të kalohet në fazën tjetër (fazën formale të hartimit).





FJALA E HAPJES NGA AMBASADORI WERNER WNENDT

20 qershor 2006

Zonja dhe zotërinj,

Do të doja që në fillim t'ju dëshiroj mirëseardhje të gjithë pjesëmarrësve në këtë Tryezë të Rrumbullakët të Parlamentarëve dhe Ekspertëve për Çështje Kushtetuese. Mirëseardhje të veçantë dhe të përzemërt i dëshiroj Kryetarit Berisha dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit, si dhe anëtarëve të grupit punues për çështje kushtetuese. Vetë pjesëmarrja juaj faktori se sa shumë rëndësi i kushtoni ju një debati kaq serioz për hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Po kështu, do të doja t'i uroj mirëseardhje të gjithë ekspertëve, të cilët erdhën këtu nga vende të ndryshme të Evropës dhe madje edhe nga Amerika e largët për të dhënë kontributin e tyre, me ekspertizën dhe përvojën e tyre, në këtë ngjarje.

Sonte është mbrëmja kur duhet të takohemi ndaj, duke pritur me padurim fillimin e diskutimeve joformale me të gjithë, ju ftoj me kënaqësi që ta shfrytëzoni sa më shumë këtë mundësi për të diskutuar me ekspertë. Më lejoni, që ta filloj fjalën time duke ua rikujtuar shkurtimisht arsyet pse kemi tubuar këtu.

Kjo tryezë e rrumbullakët është pjesë e Programit të OSBE-së për Mbështetje në vitin 2006, që ka për qëllim që t'ju ofrojë ju ekspertizë teknike dhe njohuri të tjera. Ndonëse nuk është në mandatin tonë që të marrim pjesë drejtpërsëdrejti në procesin e negociatave, qëllimi ynë është që të mbështesim në mënyrë të tërthortë të gjitha palët e përfshira në negociatë, përfshirë këtu ata që merren me çështjet kushtetuese. Siç e dini, askush nuk është duke e kontestuar faktin se me zgjidhjen e statusit do të ketë nevojë për hartimin dhe miratimin e një Kushtetute të re, së këndejmi, ne konsiderojmë se ky është një moment i volitshëm që, para pushimeve verore dhe para fillimit të fazës së re të negociatave, të organizohet një debat i këtillë.

Është e udhës të vihet në dukje se OSBE-ja nuk përkrahë ndonjë model apo zgjidhje të caktuar kushtetuese. Megjithatë, ne të gjithë jemi dakord se kjo është një çështje jashtëzakonisht e ndjeshme. Prandaj, përmes organizimit të kësaj tryeze të rrumbullakët, OSBE-ja dëshiron që të promovojë përfshirjen në proces dhe njëherësh të krijojë sensin për pronësinë ndaj këtij procesi, duke hapur kështu një debat të gjerë, ku do të përfshihen si ekspertët ashtu edhe deputetët e Kuvendit. Unë kujtoj që, ashtu si edhe në mbarë botën, Kuvendi duhet të luajë një rol vendimtar në këtë proces. Deputetët e Parlamentit kanë një detyrë të shenjtë, që të përfaqësojnë popullin dhe të gjejnë zgjidhjet më të mira për të ardhmen e Kosovës.

Kjo tryezë ka për qëllim që të shërbejë si platformë për diskutimin e çështjeve si planet e ndryshme për kushtetutën, përfshirjen e të drejtave njerëzore në kornizën kushtetuese dhe rëndësinë në përgjithësi të një dokumenti të këtillë për një shoqëri demokratike. Afër mendsh se do ngrihen dhe do të diskutohen edhe çështje që kanë të bëjnë me vendosjen e ekuilibrit midis pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Veç këtyre, do të diskutohen edhe aspekte të caktuara të sistemit të ardhshëm zgjedhor në Kushtetutë, në varësi prej asaj se a do të përfshihet dhe në çfarë mase do të përfshihet kjo çështje në Kushtetutë. Me këtë rast, do të kemi rastin t'i dëgjojmë kontributet profesionale dhe shumë të çmuara të ekspertëve, ku pos të tjerash do të mësoni edhe për shembujt dhe praktikatat më të mira.

S'ka pikë dyshimi se përgatitja e një kornize të tillë është një hap tejte i rëndësishëm për një shoqëri demokratike; megjithatë, kjo nuk mjafton. Sipas mendimit tim kjo është vetëm një nga çështjet e rëndësishme: Është e vërtetë se parimet e përgjithshme janë shumë të rëndësishme, por zbatimi konkret i këtyre dispozitave dhe normave është edhe më i rëndësishëm. Kësisoj, ju mund të keni, siç ishte rasti me Bashkimin Sovjetik, një tekst shumë të mirë dhe të fuqishëm në letër, por që nuk mund të vihet në jetë, qoftë për shkaqe politike apo për arsye se nuk ekzistojnë resurse të mjaftueshme. Vendi prej nga vi unë, Gjermania, nga ana tjetër është shembull i mirë se si duhet respektuar dhe zbatuar Kushtetuta. Në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), u themelua Gjykata Kushtetuese si një institucion i fuqishëm, i cili me shumë seriozitet e ka kryer misionin e vet të promovimit dhe zbatimit të Kushtetutës, veçanërisht kur është fjala për mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Prandaj, çështja është se si mund të garantojmë një implementim të mirëfillt? Çfarë mekanizmesh mbikëqyrës duhet të ekzistojnë? Këto janë çështje fundamentale, të cilat shpresojmë se kjo konferencë do të na ndihmojë t'i sqarojmë.

Si po shihni, është mjaft e lehtë të fillojmë të lëshohemi në këto tema, madje edhe në një fjalim të rastit. Megjithatë, i kemi dy ditë përpara për të hyrë në detaje, për të zhvilluar diskutime të frytshme dhe, madje si shpresojmë ne, për të sqaruar edhe nevojën për një marrëveshje midis të gjitha komuniteteve rreth disa problemeve dhe çështjeve kryesore siç janë të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, funksionimi i sistemit gjyqësor dhe roli udhëheqës i Parlamentit.

Më lejoni që fare në fund t'ju dëshiroj një mbrëmje të këndshme dhe relaksuese para takimit tonë të nesërm në seancën e parë. Edhe një herë ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj dhe tani fjalën e ka Kryetari Berisha.



FJALA E KRYETARIT TË PARLAMENTIT TË KOSOVËS NË SESIONIN E HAPJËS SËTRYEZËS SË RRUMBULLAKËT PARLAMENTARE DHE ME EKSPERTË MBI ÇËSHTJET KUSHTETUESE

Duke ju përshendetur juve dhe duke shprehur kënaqësinë time që po marr pjesë në hapje të kësaj tryeze të rrumbullakët parlamentare e me ekspertë, kushtuar një teme tepër të rëndësishme, ndjehem shumë i obliguar që në fillim, në emër të Parlamentit të Kosovës të falënderoj OSBE-në për organizim me kompetencë dhe për sigurimin e pjesëmarrjes në këtë tryezë të ekspertëve ndërkombëtarë me reputacion. Për këtë vërtetë meritoni mirënjohjen e Kuvendit të Kosovës sikundër edhe për shumë punë të mira që OSBE-ja i ka bërë në Kosovë dhe në rajon.

Kosova, siç dihet tanimë, ndodhet në fund të maratones pra para definimit të statusit të saj të ardhshëm. Ajo prandaj, siç do vend tjetër, duhet dhe do të ketë aktin e saj më të lartë politiko-juridik, pra kushtetutën e saj.

Pa pretenduar të lëshohem në shpjegime juridike të përmbytjes së aktit më të lartë kushtetues, për materjen që duhet të përfshijë apo për fushat që duhet të rregullojë, dua të them se tema e tryezës që po fillon sot në Shkup synon të shtjellojë ato momente dhe orientime bazike, pa të cilat nuk mund të bëhet një Kushtetutë. Këtu hyjnë shikimi krahasues i sistemeve kushtetuese që funksionojnë

në botë, dallimet në mes këtyre sistemeve, funksionaliteti i tyre pastaj ekuilibri dhe ndarja adekuate e kompetencave dhe përgjegjësiive ndërmjet Presidentit, Kuvendit, Qeverisë dhe gjyqësorit, strukturat qeveritare dhe bartja e kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, sistemi zgjedhor etj. Me një fjalë do të diskutohen të gjitha elementet që u përgjigjen dhe përshtaten më mirë rrethanave dhe aspirimeve të Kosovës dhe qytetarëve të saj për një shtet demokratik, shtet të qytetarëve të barabartë dhe me shanse të barabarta prosperiteti, pavarësisht nga diversiteti etnik, kulturor, gjuhësor apo racor.

Duke i pasur njohuritë e plota dhe të qarta për elementet përbërëse, bëhet plotësisht i qartë imazhi dhe përmbytja e tërësisë, kështu që mbi këtë fakt, kompetentët që do vendosin duhet të jenë të pajisur mirë me njohuritë e nevojshme, me kompetencë dhe cilësi. Profesionalizmi i ekspertëve pjesëmarrës në këtë tryezë, jam i sigurt se gjatë këtyre dy ditëve do lehtësojë arttijen e qëllimit të tryezës.

Është një veprim dhe organizim i duhur, jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe unë besoj edhe në kohën e duhur. Proceset aktuale në të cilat ndodhet Kosova kërkojnë si domosdoshmëri që të përshpejtohet puna dhe përgatitjet për bërjen e Kushtetutës e cila, nuk ka nevojë të thuhet se është bërë një *Conditio sine qua non*, respektivisht një domosdoshmëri që momenti i definimit të statusit të gjeje të gatshëm edhe aktin më të lartë politiko-juridik të Kosovës për të mos u krijuar vakuum kushtetues dhe institucional.

Jam i prirur të besoj se nga kjo tryezë do të dalë një ofertë e begatshme që do të ketë rëndësi të madhe në hartimin e Kushtetues së ardhshme të Kosovës. Këtë e them duke u nisur nga kapitujt tematik të punës së konferencës por sidomos e them duke u nisur nga emrat e respektuar, shumica personalitete me dije akademike ose me përvojë të cmuar në çështjet e organizimit institucional, organizimit të strukturës së pushtetit. Këtë optimizëm e mbështes edhe në listën e pjesëmarrësve nga Kosova, kolegëve tanë të cilët kanë përvojë të konsiderueshme në këtë aspekt qoftë nga angazhimet konkrete rreth organizimit të institucioneve të pasluftës në Kosovë apo edhe më herët nga praktika kushtetuese e Kosovës ose pjesëmarrja e tyre në hartimin e Kushtetutës së Jugosllavisë së dikurshme. Ju sic e dini Kosova kishte një Kushtetutë të vitit 1974 e cila për kohën dhe rrethnat ishte shumë e avansuar. Në një moment tërë populli i Kosovës doli në mbrojtje të saj duke demonstruar nëpër rrugët e Kosovës por kjo thirrje e qytetarëve të Kosovës atë kohë nuk u kuptua sa duhet nga bashkësia ndërkombëtare. Rënia e Murit të Berlinit dhe erërat demokratike të viteve 90-të sollën edhe në Kosovë një lëvizje e cila u artikulua edhe në formën e një Kushtetute të miratuar në Kacanik ndonëse nën kërcënimin e forcave të policisë serbe.

Por kjo është histori dhe nuk dua të ndalem me gjatë rreth asaj kohe. Ajo që dua të them është se presim me optimizëm epilogun e këtij takimi të Shkupit. Të gjitha parakushtet ekzistojnë për këtë pritje: përkrahja gjeneroze e bashkësisë ndërkombëtare dhe vullenti i mirë e gatishmeria e institucioneve të Kosovës.

Korniza Kushtetuese ka kohë që është bërë e ngushtë ose një lloj pengese proceseve dhe dinamikës së zhvillimit në Kosovë por edhe si e tillë në shumë aspekte mund të merret para syshë, sidomos pjesa e saj normative.

Vec kësaj kolegët tanë nga Kosova kanë sjell me vete një draft me parimet themelore të cili jam i sigurt se përmban bazë të mirë të punës për hartimin e Kushtetutes së Kosovës

Te nderuar pjesmarrës.

Në këtë paraqitje timen nuk e kam ndërmend të prezantoj ndonjë projekt të vecantë , ose mendime specifike për Kushtetutën sepse këtë jam i sigurt se do ta bëjnë ekspertet e pranishëm. Por në mënyrën më të përmbledhur dhe më simplistike më lejoni të them se ajo që duam ne është një Kushtetute moderne. Kushtetutë e cila cilron energjitë positive të zhvillimit, mundëson ekonominë e tregut të lirë, frymen e bashkëpunimit me fqinjët në interes të paqës dhe stabilitetit në rajon. Duam një Kushtetutë e cila ofron garancione për të drejtat e njeriut, model të avansuar të barazisë për minoritetet, një kushtetutë që mundëson funksionimin e shtetit ligjor, demokraci të mirëfillit sipas modelit të vendeve me të përparuar. Gjërat që në një masë të madhe i kemi rregulluar me ligje, ose premtimet e quajtura standarde tani duam ti rregullojmë në formën me të sigurt dhe më të fuqishme të quajtur Kushtetutë. Pra nga Prishtina , me konkretisht nga Kuvendi I Kosovës kam ardhur këtu në Shkup që të sjell jo ultimatutme , jo rezerva e pengesa, por vullnetin e mirë , gatishmerinë për mbështetje e kooperim maksimal në hartimin e dokumentit më të lartë juridik të Kosoves. Nuk duam improvizime, as tekst që përshkohet nga inate meskine, folklor me rezonancë nga e kaluara por draft funksional dhe modern. Kemi dëshirë që ky të jetë tekst që do të jetojë gjatë pikërisht për faktin se do të artikulojë aspiratat e qytetarëve të Kosovës, atyre që do ta duan e ta ndiejnë si dokument që hap horizonte e jo që krijon limite për askend.

Tashmë disa herë e kemi bërë të qartë , dhe kjo nuk ka qenë hipokrizi por sinqeritet, kur kemi deklaruar e premtuar se Kosova e nesërme do të jetë shtet i qytetarëve të barabrate, do të jetë shtet laik, do të jetë shtet me standardet me të avansuara për të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve të saj. Këto komponenta në mënyrën me adapte , me funksioanle do të zënë vend në Kushtetutë dhe do të garantohen përmes mekanizmave të legjitimuara nga vetë Kushtetuta.

Ja pra çfarë janë pritjet tona nga ky takim që po fillon sot në Shkup.

Edhe njëherë ju falënderoj për angazhimin tuej dhe ju uroj punë të mbarë .



RAPORTET E MBAJTËSVE TË PROCESVERBALIT

Sqarim

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument shprehin pikëpamjet e vetë folësve dhe jo të organizatave të tyre apo të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Seanca e I: "Hyrje e përgjithshme në kushtetutë"

Moderatori: Per Semb Oevind, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Fjala hyrëse: Ambasadori Verner Vnendt, Kryesuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Folësi kryesor: Poll Williams, Universiteti Amerikan, Kolegji Juridik i Uashingtonit dhe Shkolla për Shërbime Ndërkombëtare

Diskutimet e panelit: Vernon Bogdanor, Universiteti i Oksfordit, Kolegji i Brasenose

Rik Lorenc, Shkolla Xheksion për Studime Ndërkombëtare, Universiteti i Uashingtonit

Emilia Drumeva, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë

Respondenti: Hydajet Hyseni, Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Gjyqësore dhe për Kornizë Kushtetuese



Objekti

Kjo seancë iu kushtua prezantimit të funksioneve kryesore të kushtetutës në strukturat qeveritare demokratike si dhe karakteristikave themelore të saj. Pos kësaj, në këtë sesion u diskutua edhe për specifikat e procesit kushtetues.

Fjala hyrëse

Ambasadori Vnendt ka bërë të ditur se arsyeja kryesore për organizimin e tryezës së rrumbullakët është zgjerimi dhe thellimi i debatit aktual për çështjet kushtetuese, duke i bashkuar aktorët vendor dhe ekspertët ndërkombëtarë. Me këtë rast, ai vuri në pah se kjo është një detyrë mjaft e ndërlikuar dhe sfiduese, ndaj u bëri thirrje pjesëmarrësve që të përmbahen nga politizimi i debatit me qëllim që të bëhet i mundur një bashkëbisedim dhe shkëmbim i frytshëm i ideve.

Folësi i parë

Folësi kryesor theksoi rëndësinë që ka vetë procesi kushtetues sidomos për periudhën pas konfliktit, në një vend të përçarë siç është Kosova. Ai theksoi rëndësinë e këtij procesi karshi procesit të statusit, duke vënë në dukje se, edhe pse sipas të gjitha gjasave, për disa pjesë të kushtetutës do të gjendet zgjidhja pas zgjidhjes së statusit, megjithatë procesi kushtetues është proces më afatgjatë. Për të siguruar një zgjidhje dhe rezultat legjitim lipset që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe të ketë pronësisë vendore.

Ndaj, ka të ngjarë që procesi të zgjasë edhe më tepër dhe madje, sipas tij, të vazhdojë edhe pas zgjidhjes së statusit, ngase për të siguruar një konsensus politik dhe një vizion të përbashkët nevojiten konsultime gjithëpërfshirëse.



Folësi mandej bëri fjalë edhe për fazat e ndryshme të procesit. (1) Fazën përgatitore të konsultimeve fillestare me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje për një sërë rregullash të qarta dhe për afatet kohore. (2) Fazën e hartimit, me qëllim të balancimit të udhëzimeve politike dhe punës teknike. Kjo është cilësuar si faza më e vështirë, që duhet të menaxhohet me kujdes. (3) Periudhën e konsultimit publik për informimin dhe edukimin e publikut rreth kushtetutës me qëllim të sigurimit të pronësisë së gjerë në këtë proces. Prandaj, duhet të krijohet një mekanizëm për kanalizimin e kontributit publik. (4) Shqyrtimin përfundimtar në mënyrë që të bëhet përpunimi i komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve, të dala nga konsultimet me publikun. Gjatë kësaj faze, dokumenti do të mund të shqyrtohej edhe nga institucionet përkatëse për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe normat ndërkombëtare. (5) Pas miratimit, do të duhej të parashihej, faza e zbatimit me qëllim të fitimit të besimit, dhe sigurimit të legjitimitetit.

Sipas folësit, gjatë gjithë kësaj ndërmarrjeje, duhet respektuar rregullat në vijim:

- Kufizimi i mundësisë së imponimit të kontrollit, që do të mund të krijonte mosbesim dhe mungesë të legjitimitetit;
- Krijimi i mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në proces, që do të mund të gjeneronte ide të dobishme dhe njëherazi të shërbejë si model për sjelljen në mënyrë demokratike edhe në të ardhmen;
- Krijimi i strukturave të duhura për të bërë të mundur sigurimin e kompromiseve;
- Të shikohet nga e ardhmja; dhe
- Të menaxhohet me kujdes pjesëmarrja e komunitetit ndërkombëtar, posaçërisht në Kosovë ku komuniteti ndërkombëtar është shumë i involvuar në bisedimet për status.



Folësi i parë i panelit

Folësi i parë i panelit vuri në dukje se, ndonëse kushtetuta është tejet e rëndësishme, megjithatë ajo nuk është as fillimi e as fundi i procesit demokratik dhe se institucionet e krijuara nën kornizën kushtetuese mund të funksionojnë vetëm nëse ekziston një marrëveshje e përgjithshme. Së këndejmi, para së gjithash në epiqendër të vëmendjes duhet të jetë arritja e marrëveshjes politike. Kjo vlen sidomos për shoqëritë e përçara siç është Kosova, ku do të duhej bërë një balancim i kujdesshëm midis presionit për të siguruar statusin e barabartë për grupet e ndryshme dhe efikasitetit institucional. Me fjalë tjera, sa më shumë që komunitetet të kanë besim në sistem, aq më pak atyre u duhen garanci dhe aq më efikase do të jenë institucionet. Ai më tej sugjeroi se mënyra më e mirë për rritjen e besimit me rastin e miratimit të një kushtetute në një mjedis të tillë, është përdorimi i referendumit të shumëfishtë, nga një në secilin grup.

Folësi i dytë i panelit

Folësi i dytë i panelit e bëri krahasimin e gjendjes në Kosovë dhe Gjeorgji. Me këtë rast, ai vuri në dukje se ndërsa konteksti ishte krejtësisht i ndryshëm, megjithatë kishte edhe ngjashmëri me fazat e pas konfliktit të rajoneve të tjera në botë. Së këtejmi, është po ashtu me rëndësi që të bëhet krahasimi me vendet tjera si dhe nxjerrja e përvojave nga këto vende. Njëherësh, ai theksoi se një element i rëndësishëm është edhe roli që procesi kushtetues mund ta luaj në lehtësimin e procesit të pajtimit.

Folësi i tretë i panelit

Duke u mbështetur në përvojën e saj si pjesëmarrëse në hartimin e kushtetutës së Bullgarisë, pastaj si praktikante dhe aktualisht si gjykatëse kushtetuese, folësja vuri në pah rolin kryesor të ekspertëve në këtë proces, që së toku me politikanët, duhet të jenë në gjendje të tregojnë fleksibilitet dhe origjinalitet në ofrimin e zgjidhjeve të pranueshme, gjatë procesit të ndërtimit të konsensusit politik.

Duke bërë fjalë për atë se çfarë do të duhej të përmbante së paku një kushtetutë, ajo tha se së pari, një kushtetutë duhet që të përfshijë të drejtat dhe liritë elementare njerëzore dhe së dyti, ajo do të duhej të funksiononte si një kornizë ligjore për përcaktimin e standardeve dhe parimeve. Një kushtetutë nuk do të duhej të mbulonte çdo gjë, por do të duhej të ishte në gjendje të japë përgjigje në çfarëdo pyetje përmes interpretimit të saj.

Ndërsa, duke iu referuar procesit të hartimit dhe miratimit të kushtetutës, ajo bëri të ditur se edhe pse qytetarët janë elementi dhe faktori më i rëndësishëm demokratik në procesin e hartimit të kushtetutës, megjithatë për arsye praktike do të duhej të krijohet një organ kushtetues siç është kuvendi kompetent, dhe të definohet qartë modaliteti për miratim. Ajo e përmbylli fjalën e saj me dispozitat specifike që bëjnë të mundur zbatimin e kushtetutës, pa krijuar vakum pas hyrjes në fuqi. Këtu do të mund të përfshihej një pako ligjesh si hap i parë drejt kushtetutës.



Respondenti

Duke reaguar ndaj folësit kryesor, ai tha se ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme si rreth përkrahjes ndërkombëtare për procesin kushtetues, ashtu edhe për të mësuar nga përvoja e rajoneve të tjera në botë. Njëherësh, ai vuri në pah specifikat e situatës në Kosovë, për të cilën duhet gjetur zgjidhje të përshtatshme. Veç kësaj, Kosova vërtetë ka pasur përvojë kushtetuese në të kaluarën, pra ekziston një ekspertizë dhe përvojë vendore, gjë që do të luajë një rol tejet të rëndësishëm në këtë proces. Fundja, qëllimi kryesor është që i gjithë procesi të ketë ndikim pozitiv në stabilitetin e rajonit.

Duke bërë fjalë për parimet e përgjithshme, ai vuri në dukje se ka pasur konsensus jo vetëm për një kushtetutë evropiane funksionale, moderne dhe operative, por edhe për parimet e të drejtave të njeriut. Këtu do të do të përfshiheshin edhe zgjidhje më të avancuara për të drejtat e pakicave, gjë që do t'i favorizonte komunitetet pakicë dhe do të ishin në harmoni me dëshirat e shumicës. Sipas tij, ekziston edhe një pajtueshmëri e përgjithshme mbi zhvillimin e një sistemi parlamentar, i cili do të kishte për qëllim sigurimin e një funksionaliteti më të madh krahasuar me atë që është parashikuar me Kornizë Kushtetuese.

Së fundi, ai konsideron se Kuvendi përmes krijimit të së ashtuquajturës konferencë kushtetuese, do të duhej të merrte pjesë në mënyrë aktive në procesin kushtetues.

Diskutim

Procesi kushtetues – Roli i Kuvendit

Diskutimi u përqendrua më tepër në procesin e hartimit të kushtetutës sesa në përmbajtjen e kushtetutës. Afër mendsh se procesi kërkonte një pronësi vendore përmes konsultimeve të gjera të bazuara në parimet demokratike të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, në mënyrë që të sigurohet legjitimiteti i procesit. Së këndejmi, shumica e folësve theksuan se Kuvendi duhet ta ketë rolin udhëheqës në këtë proces. Njëherësh, diskutuesit vunë në dukje edhe rolin që mund të luajë grupi punues për Kushtetutë i Ekipit Negociator. Në fund, pjesëmarrësit theksuan se zbatimi i kushtetutës në tërësi është shumë më me rëndësi sesa miratimi i një teksti të mirë kushtetues.

Procesi i shkurtër kundruall procesit të gjatë kushtetues

Vlen të theksohet se është diskutuar mjaft edhe për ndërlidhjen e procesit kushtetues me procesin e statusit. Nga njëra anë, disa pjesëmarrës ishin të mendimit se kushtetuta do të duhej të ishte gati po atë ditë kur të zgjidhet statusi, ngase kësaj do të evitohet mundësia që komuniteti ndërkombëtar të imponojë një dokument kushtetues. Ndërsa, nga ana tjetër, u theksua se do të ishte gabim nëse do përshpejtohej procesi i hartimit të kushtetutës, ngaqë kjo do ta bënte të pamundur arritjen e konsensusit sidomos me komunitetet pakicë. Po kështu, duke mbajtur parasysh se në Kosovë ekziston një kornizë kushtetuese, dhe se nuk ka ndonjë rrezik për vakum ligjor, atëherë kjo punë nuk do të duhej marrë me urgjencë, sidomos nëse qëllimi i procesit është që të gjinden zgjidhje afatgjata, që do të zbusnin dhe zvogëlonin përçarjet në baza etnike. Njëkohësisht, kjo do të bënte të mundur edhe shmangien e bllokimit eventual apo mbase edhe të ushtrimit të ndikimit në procesin e statusit.



Shqetësimet e komuniteteve pakicë

Pos këtyre, gjatë diskutimeve është vënë në pah se procesi i hartimit do të duhej të mundësonte pjesëmarrjen e ekspertëve nga të gjitha komunitetet për të punuar rreth arritjes së qasjeve të përbashkëta, dhe se shqetësimet e ngritura nga komunitetet pakicë do të duhej që jo vetëm të dëgjohen dhe shënohen, por edhe të merren parasysh. Me fjalë të tjera, shumica nuk do të duhej të mendohej të përfitojë vetëm për vete nga ky proces kushtetues, por ajo do të duhej të punojë për realizimin e interesave të të gjitha palëve.

Ndërrhyrjet e diskutuesve lidhur me përmbajtjen e kushtetutës kryesisht theksonin nevojën e balancimit midis të drejtave individuale dhe atyre minoritare (apo të komuniteteve) si dhe midis efikasitetit institucional dhe atij të mbrojtjes së grupeve të veçanta. Një shqetësim tjetër që u ngrit gjatë diskutimeve kishte të bënte me atë se sa largpamëse do të duhej të ishte kushtetuta, pra a do të duhej që procesi të përqendrohej më tepër në integrimin e ardhshëm se sa në mbrojtjen aktuale.

Raportuesi: Patris Kuesada – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Seanca e II: “Institucionet”

Moderatori: Frenklin De Vrieze – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësit kryesor:

Vernon Bogdanor – Universiteti i Oksfordit, Kolexhi i Brasenose

Amjad Atallah-Iniciativa për Vlerësimin Strategjik

Arsim Bajrami – Grupi punues për Kushtetutë, Ekipi Negociator i Kosovës

Respondentja: Gjynaze Sylja, Kryetare e grupit parlamentar të AAK-së

Objekti

Në epiqendër të vëmendjes së kësaj seance ishin përgatitjet dhe marrëveshjet e nevojshme institucionale për sigurimin e një qeverie funksionale në Kosovë, përfshirë këtu edhe ndarjen e kompetencave dhe sistemin e kontrollit dhe balancit.

Folësi i parë

Folësi i parë diskutoi rreth modeleve të ndryshme të strukturave të ekzekutivit. Duke shtruar pyetjen se, kujt do t'i jepte përgjegjësi qeveria, parlamentit apo ndonjë institucioni tjetër, ai bëri të qartë se nëse qeveria është përgjegjëse ndaj parlamentit, atëherë kjo do të thotë se qeveria në të vërtetë është përgjegjëse ndaj “shumicës”.



Një alternativë mund të jetë qeveria "me komunitete", ku sipas rregullit partitë e pakicave do të ishin pjesë e qeverisë.

Folësi tutje foli edhe për rolin që mund të luajë Kryetari i shtetit për pajtimin e komuniteteve të ndryshme apo edhe për rolin simbolik që mund të ketë ai. Sido që të jetë, Kryetari, veçanërisht në rastin e Kosovës duhet t'i përfaqësojë të gjithë qytetarët.

Folësi, mandej bëri të dituar se ekziston një spektër i gjerë praktikash legjislativ për mbrojtjen e pakicave, siç janë vetot e pakicave ose kufizimi i votës së shumicës. Ai po kështu tha se problemi kryesor është se si të mbrohen minoritetet dhe si të mënjanohet përfshirja e elementeve jofleksibile në sistemin legjislativ. Një nga sugjerimet ishte që të krijohet një komision në parlament për mbikëqyrjen e punës së qeverisë. Legjislatiioni mund të shqyrtohet në disa faza: në fazën paralegjislativ, kur hartimi i legjislatiionit shqyrtohet në parlament për herë të parë; faza legjislativ, me ç'rast dëshmitarët mund të ftohen për ta informuar parlamentin; dhe faza post-legjislativ, për të konstatuar se me çfarë efikasiteti është duke u zbatuar legjislatiioni.

Folësi po ashtu vuri në dukje edhe abuzimet që mund të bëhen me rastin e shpërbërjes së parlamentit për kohë të pacaktuar nga ana e qeverisë. Ndërsa, nga ana tjetër, afatet e caktuara për parlamentin, sipas tij, mund të çojnë deri te jo fleksibiliteti dhe stagnimi. Ndaj edhe për këtë duhet të sigurohet një balancë.

Duke bërë fjalë për një sërë modelesh që praktikohen në tërë Evropën, ai theksoi se ndonëse sistemi i kontrollit dhe balancit janë pjesë përbërëse e çdo qeverie, megjithatë nuk ekziston ndonjë metodë ideale. Vetë ekzistimi i institucioneve nuk do të thotë se ato janë funksionale; çelësi për qeverisje të suksesshme është dëshira dhe vullneti për t'i bërë institucionet funksionale. Së këndejmi, nëse nuk ekziston vullneti për një gjë të tillë, madje edhe një kushtetutë e përkryer nuk do të ishte e suksesshme. Për këtë temë është bërë fjalë gjatë gjithë kohës së mbajtjes së tryezës së rrumbullakët.

Folësi i dytë

Kushtetuta dhe procesi i statusit

Folësi i dytë ishte i mendimit se është shumë vështirë që të negociohet në të njëjtën kohë për pavarësinë dhe kushtetutën. Duke marrë si shembull Palestinën, ai sqaroi se në disa raste, shtetet në zhvillim nuk e fitojnë as pavarësinë e as kushtetutën, ndaj i paralajmëroi pjesëmarrësit se procesi i hartimit të kushtetutës mund të zgjasë, madje nganjëherë zgjatë me vite të tëra. Ndërkaq, sipas tij marrëveshja dhe rregullimi më ideal kushtetues mund të arrihej nëse procesi i statusit përfundimtar dhe kushtetuta e përplotësojnë njëra tjetrën.

Si ndikon kushtetuta në formësimin e shtetit

Meqë kushtetuta përcakton formën e qeverisjes, atëherë ajo jo vetëm që ka ndikim të përhershëm në funksionimin e shtetit, por edhe në mënyrën se si perceptohet. Për më tepër, praktikave e kohëve të fundit të shteteve faktojnë se madje kushtetuta është kriteri që përcakton edhe atë se si komuniteti ndërkombëtar e sheh një shtet, si udhëheqës moral të rajonit apo thjeshtë si përsëritës të gabimeve të fqinjëve të vet. Madje në bazë të kësaj përcaktohet edhe shkalla e mbështetjes së komunitetit ndërkombëtar për shtetet. Së këndejmi, hartuesit e kushtetutës duhet ta caktojnë një standard, të mendojnë në mënyrë kreative, e jo në mënyrë teknokratike.

Çështjet kryesore, për të cilat kushtetuta duhet të gjejë zgjidhje

Së pari, duhet zgjidhur çështja e strukturës dhe rregullimit shtetëror, i cili mund të jetë konfederativ, federativ e madje edhe unitar. Pavarësisht se për çfarë modeli përcaktohet, ato që duhet të sigurohen mbi të gjitha janë respektimi i të drejtave të njeriut dhe krijimi i një ekonomie funksionale. Hartuesit nuk duhet të kufizohen me rastin e zgjedhjes së modelit; meqë me lindjen dhe zhvillimin e shteteve të reja, sipas të gjitha gjasave, do të lindin edhe struktura të reja shtetërore.



Së dyti, struktura e ekzekutivit. Një sistem presidencial mund të shërbejë si forcë unifikimi dhe të sigurojë ndarje të mirëfilltë të kompetencave. Ky sistem karakterizohet nga një shkallë e caktuar e përgjegjësisë ndaj votuesve, por mund të çojë edhe deri te autoritarizmi. Ndërsa, modeli parlamentar përfshin të gjitha grupet, dhe është më fleksibil, meqë shpesh ndodh që duhet të formohen koalicionet midis partive të ndryshme. Sistemet parlamentare janë më të përgjegjshme, më lehtë kontrollohen nga publiku dhe janë më transparente. Së këtejmi, sipas folësit, sistemet parlamentare janë shpesh më të qëndrueshme për demokracitë e reja; në fakt, të gjitha shtetet e mirëfillta demokratike që u formuan pas Luftës së Dytë Botërore kanë sisteme parlamentare. Në fund folësi vuri në dukje se sistemi i përzier mund të jetë shumë i paqëndrueshëm.

Së treti, struktura e legjislativit. Kushtetuta duhet të definojë nëse legjislativi (sistemi parlamentar) do të jetë me një dhomë apo me dy dhoma si dhe nën çfarë rrethanash mund të shpërbëhet parlamenti...

Folësi e përmbylli, duke spikatur rolin e rëndësishëm që luajnë grupet pakicë në procesin e hartimit të kushtetutës, përfshirë këtu edhe femrat. Sipas tij shtet i ri mund t'i mbrojtë pakicat nga humbja e të drejtave të tyre duke siguruar, që këto grupe të jenë pjesë e procesit të hartimit.



Folësi i tretë

Folësi i tretë vuri në dukje se kushtetuta është një kontratë ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, dhe se kushtetuta e re e Kosovës do të duhej ta mbështesë shtetin e ri dhe njëherësh t'i sigurojë të drejta maksimale për të gjitha komunitetet si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendror. Së këndejmi, synimet kryesore të Kushtetutës janë kohezioni kombëtar, uniteti i popullit dhe funksionimi i institucioneve të Kosovës.

Folësi pohoi se, ndonëse disa çështje janë duke u negociuar në kuadër të bisedimeve për status, siç është reformimi i qeverisë lokale dhe i të drejtave të pakicave, megjithatë procesi i hartimit të kushtetutës duhet të udhëhiqet nga Kuvendi, si institucioni më i lartë përfaqësues i Kosovës. Ai po ashtu tha se për përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në procesin e hartimit do të nevojitet një kohë.

Duke iu referuar ndarjes së pushteteve ai vuri në pah se çdo kushtetutë e kufizon pushtetin e qeverisë në njëfarë mënyre, fjala vjen kufizimi i mbikëqyrjes legjislativ ndaj pushtetit të presidentit për çështjet të veçanta. Ndërkaq, duke bërë fjalë për rolin e presidentit, ai theksoi se presidenti duhet t'i ketë pesë kompetenca kryesore: 1) shpalljen e ligjeve; 2) propozimin e ligjeve; 3) fuqinë e vetos; 4) emërimin e kryeministrit dhe 5) shpërbërjen e parlamentit.

Respondenti

Respondenti vuri në dukje se kushtetuta pas zgjedhjes së statusit duhet të jetë e qëndrueshme, ndaj hartuesit duhet të sigurojnë pajtueshmërinë e plotë të Kushtetutës me statusin e ardhshëm. Ndërkaq, sistemi parlamentar është përkrahur për shkak të, siç i cilësoi ajo, fleksibilitetit, përgjegjësisë së nivelit të lartë, dhe qëndrueshmërisë së tij. Duke e cilësuar sistemin aktual joefikas, folësjat theksoi nevojën për hartimin e një kushtetute të re me qëllim të definimit të institucioneve sovrane të Kosovës, përfshirë këtu edhe ministrinë e reja siç janë ministria e punëve të jashtme, ajo e mbrojtjes dhe për integrim evropian. Ndërkaq, Kryeministri, sipas saj, duhet të zgjidhet nga parlamenti dhe të jetë përgjegjës jo vetëm për politikën qeveritare, por edhe për zbatimin e ligjeve.

Diskutimi

Në themel të vëmendjes së diskutimit të hapur ishin mbrojtja e pakicave përmes procesit legjislativ dhe zhvillimi i procesit të hartimit të kushtetutës në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse. Ndërsa, seanca përfundoi me një diskutim mbi realitetet politike të hartimit të kushtetutës.

Mbi mbrojtjen e pakicave

Pjesëmarrësit ishin dakord se mbrojtja e të drejtave të pakicave është çështje që duhet të rregullohet me kushtetutë. Disa pjesëmarrës vunë në dukje mangësitë e sistemit aktual, veçanërisht ato rreth funksionimit të komisionit të Kuvendit për të drejtat dhe interesat e pakicave për punën e të cilit kishte shumë pak informacione. Shumë prej tyre nuk e kanë konsideruar këtë komision si aq të rëndësishëm, mbase për shkak se i kanë kushtuar më tepër kujdes mbrojtjes dhe ruajtjes së interesave të koalicionëve qeverisës se sa interesave të komuniteteve. Një diskutues ishte i mendimit se komunitetet duhet t'i mbrojnë vetë interesat e tyre dhe madje edhe të vendosin vetë për mekanizmat e duhura legjislativë për mbrojtjen e interesave të tyre. Së këndejmi, ai u angazhua për krijimin e një dhome të ndarë për pakicat me një shumëllojshmëri mekanizmesh për mbrojtje legjislativë si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror.

Diskutuesit tjerë ishin të mendimit se të gjitha komunitetet në Kosovë është dashur të punojnë bashkërisht për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, dhe ndonëse insistoi se ekziston nevoja për mekanizma mbrojtës, ai theksoi se megjithatë duhet të kihet kujdes që të evitohen "gabimet e Bosnjës".

Disa pjesëmarrës duke bërë ndërlidhjen e mbrojtjes së të drejtave të pakicave me balancimin e kompetencave, ishin të mendimit se për të funksionuar këto mekanizma duhet të kultivojmë zhvillimin e kulturës së konsensusit e jo kulturën e vetos. Në procesin kushtetues duhet të dominojë vullneti i mirë, si mënyra më e mirë për shmangien e ngecjeve në të ardhmen.

Mbi gjithëpërfshirjen dhe përfaqësimin

Lidhur me këtë u sugjerua përfshirja e këshillave shtetërorë, organizatave ndërlidhëse, përfaqësuesve të organizatave si dhe organizatave profesionale që i





përfaqësojnë interesat ekonomike të gjitha komuniteteve. Të gjithë pjesëmarrësit besonin se procesi i hartimit të kushtetutës duhet të jetë gjithëpërfshirës me qëllim që të gjithë qytetarët e Kosovës të ndihen jo vetëm si pjesë e procesit, por edhe pjesë e rezultatit të procesit të hartimit të kushtetutës.

Mbi realitetet politike

Pjesëmarrësit bënë fjalë edhe për ndjeshmërisë e situatës së tashme politike. Me këtë rast, ata shprehën bindjen e tyre se disa dispozita apo parime do të dalin nga vetë procesi i statusit, posaçërisht për fushat si të drejtat e pakicave, reformimi i pushtetit lokal dhe trashëgimia kulturore.

Ndaj dhe disa diskutues i bënë thirrje komuniteteve në Kosovë, që të gjejnë zgjidhje së bashku për të lehtësuar përmbylljen e bisedimeve për status.

Roli i ekspertëve dhe i politikanëve

Diskutuesit tërhoqën vërejtjen se ekspertët do ta hartojnë kushtetutën, mirëpo janë politikanët ata që duhet ta krijojnë ambientin e përshtatshëm për zbatimin e saj. Ndaj, ekspertët së toku me politikanët duhet të gjejnë zgjidhje origjinale, në mënyrë që ta bëjnë funksional shtetin e ardhshëm të Kosovës.

Zbatimi i kushtetutës

Një diskutues vuri në dukje se sundimi i ligjit është crucial për zbatimin e kushtetutës, ndërsa një diskutues tjetër theksoi se suksesi apo dështimi i Kosovës si shtet varet nga ajo se si e trajton dhe sa e respekton shumica pakicën. Ndërkaq, për t'i realizuar këto nevojitet vullnet dhe përgjegjësi nga të dy palët, si nga shtetit ashtu edhe nga qytetarët. Megjithatë, për shkak të përvojës së shtatë viteve të shkuara, akoma ekzistonte mosbesimi i madh tek institucionet. Ndaj një proces i mirëfillt kushtetues, do të mund të ndihmonte në bindjen e njerëzve që të kenë më tepër vullnet politik.

Raportuesja: Xhenifer Ober –Grupi për Ligj Publik Ndërkombëtar dhe Politika

Seanca e III: "Sistemi gjyqësor"

Moderatori: Vulf-Majkell Mors – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësit kryesor:

Gudvin Muskat Azopardi – Gjykatës Ndërkombëtar i OKB-së, Gjykata Supreme e Kosovës

Rik Lorenc – Shkolla Xhekson për Studime Ndërkombëtare, Universiteti i Uashingtonit

Nekibe Kelmendi – Grupi Punues për Kushtetutën, GNK



Respondenti: Dragisha Kërstoviq –Grupi parlamentar i SLKM-së

Objektivi

Në epiqendër të vëmendjes së kësaj seance ishin aranzhimet e nevojshme kushtetuese për sigurimin e pavarësisë së gjyqësisë si dhe aranzhimet për shqyrtime kushtetuese.

Folësi i parë

Folësi i parë kryesor theksoi se gjyqësia e pavarur është një nga parimet themelore kushtetuese. Kushtetuta duhet të definojë strukturën e qeverisë dhe kufizimet e veprimit të qeverisë. Duke cituar nga Rezolutat e Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara lidhur me këtë çështje, folësi përvijoi elementet e nevojshme për krijimin e një gjyqësie të pavarur.

Ai vuri në dukje se është me rëndësi që të ekzistojë vullneti i fortë i gjyqësorit që do të jetë në gjendje ta mbrojë individin nga shumica; në rast të konfliktit, gjykatësve duhet t'u bëhet e mundur që të marrin vendime të bazuara në ligji dhe në argumente reale. Së këndejmi, gjykatësit duhet t'i përbahen një standardi të lartë të performancës me qëllim të ruajtjes së integritetit dhe dinjitetit të gjyqësisë.

Nuk mjafton që të kemi një gjyqësor të pavarur vetëm në letër, por ai duhet të jetë vërtetë i pavarur.

Duke shprehur bindjen e tij se kushtetuta e re do të sjellë ndryshime cilësore në situatën aktuale në Kosovë, ai e vuri në dukje rëndësinë që ka krijimi i një gjyqësorie të pavarur në kuadër të perspektivës së integritimit euroatlantike, ku gjykatësit do të duhej t'i linin me një anë ligjet kombëtare për hir të ligjeve të Bashkimit Evropian.

Duke iu referuar një mori shembujsh konkretë nga kushtetutat e kohëve të fundit të vendeve të Evropës Lindore, ai theksoi nevojën e mbrojtjes së interesave të gjyqësorit nga pjesa tjetër e shtetit. Me këtë rast, ai vuri në dukje rëndësinë që ka kufizimi i veprimeve që janë në kundërshtim me postin e gjykatësit dhe nevojën për mekanizmat efektivë financiar të zbulimit për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit. Veç kësaj, ai theksoi edhe rëndësinë që ka e vet-menaxhimi i burimeve të administratës së gjykatës.

Folësi i dytë

Duke shfrytëzuar një numër të madh shembujsh nga kushtetutat e miratuara kohëve të fundit, ai i bëri të ditura llojet (stilet) e gjuhës, që mund të përdoren për krijimin e një gjyqësori të pavarur. Me këtë rast, folësi theksoi dy çështje me interes:

1. Si të sigurohet një rol objektiv për gjykata dhe/ose gjykatën kushtetuese, me qëllim për ruajtjen e një sistemi gjyqësor të pavarur.
2. Si të garantohet një larmi e personelit gjyqësor, dhe nëse një numër specifik i posteve të rezervuara për grupin minoritar është një zgjidhje e duhur.

Folësja e tretë

Ajo nënvizoi se gjykatat janë pasqyrim i natyrës së shtetit, ndaj sipas saj një gjyqësi e pavarur, e respektuar nga autoritetet ekzekutive dhe nga qeveria, është vendimtare për ruajtjen e parimeve të legalitetit dhe sundimit të ligjit, ngase është gjyqësori ai që vendosë për vlerat më të rëndësishme dhe më të vlefshme njerëzore.

Folësja rekomandoi që vlerat dhe parimet themelore të gjyqësisë së pavarur të jenë të qasshme dhe zbatueshme për publikun, në mënyrë që publiku të jetë në gjendje t'i ruajë ato vlera dhe parime.

Duke bërë fjalë rreth funksionimit dhe organizimit aktual të gjyqësorit në Kosovë, ajo shprehu pikëpamjen se që nga viti 1999 nuk është respektuar pavarësia e gjyqësorit. Folësja me këtë rast vuri në pah ekzistencën e tri juridiksioneve të gjykatës që në fakt funksionojnë paralelisht, d.m.th. gjykatat vendore të Kosovës, gjykatësit ndërkombëtarë dhe gjykatat serbe. Ajo e përmbylli diskutimin duke shprehur besimin e saj se vetëm me zgjidhjen e statusit të Kosovës do të jetë e mundur të krijohet një gjyqësi e pavarur.

Respondenti

Respondenti e filloi prezantimin e tij me një vështrim mbi gjendjen aktuale të gjyqësorit në Kosovë, duke vunë në pah një sërë mangësish si: Kornizën e paqartë ligjore të sistemit gjyqësor; mungesën e burimeve njerëzore dhe materiale; shqetësimin lidhur me autoritetin që ka PSSP-ja për emërim; mungesën e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor; kompensimin e pamjaftueshëm material për gjyqtarët; stërzgjatjen e procedurave gjyqësore. Duke u bazuar në këtë ai vuri në dukje se Kosova është rast specifik dhe se zgjidhjet e përkohshme nuk do të ishin të dobishme, ndonëse ai pranoi se këso zgjidhje mbase do të jenë të domosdoshme.

Njëherësh, ai ishte i mendimit se Kushtetuta e Kosovës duhet që, të paktën, t'i definojë dhe rregullojë këto çështje: Përgjegjësitë e gjyqëve; strukturën e sistemit gjyqësor; organizimin e gjyqëve (përfshirë këtu gjyqet e specializuara); pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit; funksionet që nuk janë në pajtim me ato të gjyqtarit; si dhe diversitetin e gjyqësorit në Kosovë. Ai e përmbylli fjalën e tij, duke theksuar se respektimi i sundimit të ligjit dhe të drejtave njerëzore në Kosovë do të varen shumë nga ajo se çfarë zgjidhjesh kushtetuese do të gjinden për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit.





Diskutim i hapur

Diskutimi i hapur u përqendrua në rëndësinë që ka krijimi i Gjykatës Kushtetuese, rolin e një gjykate të tillë, aspektet pozitive dhe negative të lejimit të ankesave individuale kushtetuese, procedurën për emërimin e gjyqtarëve, pozitën e zyrës së prokurorit, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, dhe rrezikun e implikimi të politikës në procesin e vendimmarrjes në sistemin e gjyqësor, duke mbajtur parasysh kulturën kushtetuese të Kosovës.

Mbi gjyqet kushtetuese¹

Disa pjesëmarrës ishin të mendimit se, duke mbajtur parasysh kontekstin aktual të Kosovës dhe sfidat me të cilat ndeshet zbatimi i kornizës aq komplekse ligjore, Gjykata Kushtetuese do të mund të ndihmonte në qartësimin dhe garantimin e zbatimit të ligjeve të aplikueshme dhe vlerësimin e kushtetueshmërisë jo vetëm të ligjeve aktuale, por edhe atyre që do të nxirren në të ardhmen.

Shqyrtimit i ankesave të veçanta (individuale)

Një çështje tjetër që u ngrit ishte lejimi i shqyrtimit të ankesave të veçanta (individuale) në Gjykatën Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e veprimeve publike në raste të caktuara. Shumica ishin të mendimit se, ndonëse një sistem i këtillë mund të jetë shumë i mirë, megjithatë për shkak të rrezikut që gjyqet të mbingarkohen me këso lloj padish dhe lëndësh, një gjë e tillë nuk do të duhej lejuar. Për më tepër, paditësit mund ta keqpërdorin këtë mundësi, duke e përdoruar atë si nivelin e katërt të ankimit për të faktuar bazueshmërinë e ankesave të tyre. Megjithatë, një zgjidhje e mundshme për evitimin e abuzimeve potenciale është që të bëhet e mundur që, edhe gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesave në gjykatën kushtetuese, ligjet të vazhdojnë të mbeten në fuqi. Përvojat nga Bullgaria tregojnë se shqyrtimi i ankesave individuale nuk është mirë të lejohet në fazat e fillestare të punës së gjykatës kushtetuese.

Mbi emërimin dhe procedurat buxhetore

Ca nga pjesëmarrësit shfaqën shqetësimin e tyre për emërimin e gjykatësve nga legjislativi si dhe për kontrollin e resurseve financiare nga ekzekutivi. Me këtë rast, ata vunë në dukje se për shkak të mungesës së një gjyqësori të pavarur në Kosovë, dhe praktikave e përvojave të këqija në të shkuarën, është jashtëzakonisht me rëndësi që të mbrohet gjyqësori nga ndikimi i politikës sa më tepër që të jetë e mundur. Së këndejmi, për të arritur këtë qëllim, disa pjesëmarrës ishin të mendimit që emërimi i gjyqtarëve dhe kontrolli financiar të bëhen ose përmes një Këshilli të pavarur të Lartë Gjyqësor apo përmes ndonjë organi tjetër. Megjithatë, ato po ashtu konsideronin se është shumë me rëndësi që të evitohet mundësia që një pushtet tejet i fuqishëm gjyqësor të bëhet pengesë për funksionimin e pushteteve të tjera të shtetit.



Nga ana tjetër, disa pjesëmarrës vunë në pah nevojën për krijimin e marrëdhënieve të ngushta midis gjyqësorit, shoqërisë dhe institucioneve të tjera publike. Një gjyqësor i pavarur nuk duhet ta humbë kontaktin me shoqërinë, ndaj duhet patjetër të reflektojë përbërjen e shoqërisë kosovare. Ndonëse, emërimi nga ana e Parlamentit mund ta shtojë rrezikun nga implikimi i politikës, kjo megjithatë mund të evitohet përmes sistemit të fuqishëm të kontrollit dhe balancit në kuadër të sistemit të përgjithshëm të funksionimit të institucioneve publike. Ndarja e buxhetit të gjyqësorit nga buxheti i përgjithshëm i shtetit po ashtu do të ndikonte dhe ndihmonte në ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

Përfaqësimi

Në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin dakord se gjyqësori duhet ta reflektojë larushinë (diversitetin) e popullatës së Kosovës. Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve nuk pajtoheshin me kuota, apo vende të rezervuara për sektorë (struktura) të caktuara të popullatës. Sipas tyre, një definim i qartë i specifikave dhe larushisë së popullatës së Kosovës në Kushtetutën e Kosovës tok me një deklaratë se gjyqësori duhet ta reflektojë këtë

¹ Historikisht, shqyrtimi i kushtetutshmërisë së ligjeve mund të bëhet ose a priori, para se të miratohet ligji apo a posteriori, pasi të ketë filluar zbatimi i ligjit. Për këtë të dytën, spikaten dy modele: Modeli i Austrisë, ku është themeluar Gjykata Kushtetuese, e cila merret ekskluzivisht me çështje kushtetuese apo modeli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku kompetenca për shqyrtimin e çështjeve kushtetuese i është lënë Gjykatës Supreme. Ndërkaq, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore kanë themeluar gjykata të specializuara kushtetuese me qëllim të shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve publike, ngase besohet se gjykatat e tilla janë të fuqishme dhe shumë efektive sidomos gjatë periudhës së tranzicionit.

llojlojshmëri, do të mjaftonte për të garantuar një diversitet në emërimet në sistemin gjyqësor. Përderisa procedura e emërimit nuk është e politizuar, emërimi i bazuar në merita do të duhej që automatikisht të bëjë të mundur që të ketë larushi në mesin e të punësuarve në sistemin gjyqësor.

Rreth besimit të qytetarëve/ publikut në sistemin gjyqësor

Lidhur me besimit e disa sektorëve (strukturave) të publikut në sistemin gjyqësor të vendit u ngritën një sërë çështjesh, që ndërlidheshin njëra me tjetrën. Kështu, një nga shqetësimet që u ngit ishte edhe mundësia dhe rreziku i ushtrimit të ndikimit në gjyqësinë penale përmes kontrollit të policisë dhe të zyrës së prokurorit nga ana e ekzekutivit. Njëherësh, u vu në spikamë edhe rëndësia e procedurave të drejta, të shpejta dhe pak të kushtueshme. Ndërkaq, ca pjesëmarrës ishin të mendimit se për të përmirësuar besimin e publikut duhet së pari të emërohet një numër më i madh i gjyqtarëve, të cilët do të kishin paga më të mira. Pos kësaj, ata theksuan se duhet të punohet edhe rreth tejkalimit të problemeve të zbatimit të vendimeve gjyqësore. Mirëpo, besimi i publikut, tërhoqën vërejtjen ata, nuk mund të jetë faktori përcaktues në krijimin e një gjyqësori vërtetë të pavarur, ngase gjatë marrjes së vendimeve njëra palë do të jetë gjithnjë e pakënaqur.



Raportuesi: Ronald Hugiemstra – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Sesioni i IV: “Të drejtat njerëzore”

Moderator: Vullf-Majkëll Mors – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësit kryesorë: Emilia Drumeva, Gjykata Kushtetues e Bullgarisë
Ron Hugiemstra, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Respondent: Xhezair Murati, Shef i grupit parlamentar 6+

Qëllimi

Ky sesion kishte për qëllim që të japë një vështrim të përgjithshëm rreth përfshirjes së të drejtave të njeriut dhe të mekanizmave mbrojtëse në kushtetutë.

Folësja e parë

Folësja e parë në fjalën e saj sqaroi arsyet për nevojën e përfshirjes së të drejtave njerëzore në kushtetutë. Me këtë rast, ajo u ndal tek definicioni historik që së toku me ndarjen e pushteteve është elementi i dytë më i rëndësishëm i shoqërisë demokratike². Veç kësaj, ajo bëri të ditur se në kushtetutë “të drejtat njerëzore” shndërrohen në “të drejta elementare”, ngase ato paraqesin dhe shprehin vlerat përmes të cilave lidhet shoqëria me individin.

Meqë ato të drejta paraqesin vlera objektive, ato janë “ligje që zbatohen drejtpërsëdrejti”, atëherë kjo përligj edhe obligimin për mbrojtjen e këtyre vlerave. Së këtejmi, mbrojtja është esenca e këtyre të drejtave pavarësisht nëse ato të drejta janë negative (që garantojnë lirinë nga shkeljet e të drejtave siç janë siguria, liria, të drejtat politike, të drejtat apo mjetet ligjore, e drejta për të qenë i barabartë dhe për mosdiskriminim) apo të drejta pozitive (shpërndarja e fryteve të kontributeve individuale për shoqërinë si të drejtat ekonomike dhe sociale). S’do mend se për shkak të dallimeve në natyrën e të drejtave pozitive dhe negative edhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre janë të ndryshme.



² Neni 16-të i Deklaratës për të drejtat e njeriut dhe qytetarëve, 1789



Çështja që e hapi ajo përmes këtij prezantimi teorik ishte se cilat të drejta njerëzore duhet të përfshihen në kushtetutë. Ajo po ashtu theksoi se përfshirja e të drejtave dhe mekanizmave për zbatimin e tyre duhet të përcaktohet pas kryerjes së hulumtimeve, krahasimeve mbi atë se si janë pritur dhe pranuar mekanizma të caktuar nga populli, si dhe pas hulumtimeve rreth ligjit ndërkombëtarë.

Mbi të drejtat e minoriteteve

Duke bërë fjalë për të drejtat e veçanta njerëzore që njihen si "të drejta të minoriteteve", ajo bëri të ditur se këto të drejta bëjnë pjesë në kategorinë e të drejtave elementare, ndaj dhe duhet të përfshihen në kushtetutë. Sipas definicionit, në të drejtat e minoriteteve përfshihen edhe të drejtat individuale të çdo pjesëtari të një grupi si dhe të drejtat kolektive të një grupi minoritar; njëherësh, ajo theksoi se këto të drejta duhet të kenë një funksion integruar. Mirëpo, sipas saj nuk ekziston një model universal qoftë në nivelin kushtetues apo institucional apo sa i takon shkallës së precizitetit të përfshirjes së tyre në kushtetutë. Ndaj, detajet e tepërta mund ta ngushtojnë fushëveprimtarinë e tyre dhe se mund të bëjnë që madje edhe të mos vihen re disa situata në të ardhmen.

Mekanizmat mbrojtës

Në mekanizma mbrojtës mund të përfshihen edhe mekanizmat e brendshëm (fjala vjen, përmes rregulloreve që sigurojnë garancitë për respektimin e të drejtave dhe për ndëshkimin e shkeljes së këtyre të drejtave). Në rast të kufizimeve (dhe përpos të drejtave që nuk mund të kufizohen), duhet të aplikohet parimi i proporcionalitetit dhe të përfshihet në kushtetutë. Si mekanizmat të jashtëm ajo përmendi mjetet ligjore, përfshirë këtu edhe mundësinë në qasjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë në gjykatën kushtetuese apo edhe krijimin e institucionit të avokatit të popullit (ombudspersonit). Ndërkaq, një kategori tjetër janë edhe mekanizmat mbikombëtare, në veçanti ato të proceseve të integritetit që janë duke u zhvilluar në mbarë Evropën.



Folësi i dytë

Folësi i dytë pati një qasje tjetër ndaj çështjes së të drejtave të njeriut dhe lidhjes së tyre me kushtetutën. Sipas tij, meqë të drejtat e njeriut janë të përfshira në ligjin ndërkombëtarë, atëherë preokupimi kryesor duhet të jetë raporti i ligjit ndërkombëtar me atë vendor, apo më saktësisht, meqë këto të drejta janë të përfshira në traktate, si të integrohen këto të drejta në arkitekturën e legjislativës vendor. Ndërkaq, duke bërë fjalë për kornizën kushtetuese të Kosovës, ai sqaroi se ndonëse standardet e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme, megjithatë nuk është e qartë se cilat janë marrëdhëniet e tyre me kornizën legjislativë vendore. Ndaj kjo mund të shkaktojë probleme rreth zbatimit praktik të këtyre standardeve.

Duke prezantuar dy modelet e përfshirjes së ligjit ndërkombëtar në kushtetutë, ku ekzistojnë një sërë mundësish, folësi paraqiti një listë çështjesh që duhet të adresohen me rastin e hartimit të kushtetutës, me qëllim të sigurimit të koherencës dhe efikasitetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sipas tij çështjet, të cilave duhet kushtuar kujdes i veçantë me këtë rast janë: Statusi i traktateve; hyrja e tyre në fuqi; marrëdhëniet e tyre me ligjin vendor; dhe mjetet mbrojtëse që mund të përdoren në rast të shkeljeve të drejtave dhe mekanizmat reagues për shmangien e shkeljeve në të ardhmen.

Diskutim

Shumica e përfaqësuesve ishin dakord se ndonëse korniza kushtetuese në Kosovë siguron deri diku mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e minoriteteve, megjithëkëtë kjo kornizë nuk është treguar aq e suksesshme në mbrojtjen e të drejtave pozitive siç është e drejta për të punuar. Ekuilibri midis të drejtave individuale dhe të pakicave si dhe midis të drejtave njerëzore, në përgjithësi dhe interesit të përgjithshëm sërish u diskutua si një nga çështjet kryesore, që kërkon zgjidhje në kuadër të kushtetutës.

Mirëpo, disa përfaqësues duke shfaqur shqetësimet e tyre lidhur me këtë çështje theksuan se mekanizmat mbrojtës duhet të kenë parasysh realitetin në Kosovë, veçanërisht kur është fjala për gjendjen dhe interesat e secilit komunitet. Prandaj, duhet të kemi një qasje më pragmatike kur është fjala për nivelin dhe mënyrën e integritetit të secilit komunitet.

Po ashtu, u konstatua se niveli i gatishmërisë dhe i edukimit të popullatës për të luftuar për të drejtat e tyre është faktori përcaktues në sigurimin e mbrojtjes efektive të këtyre të drejtave. Prandaj, madje edhe kushtetuta më ideale me instrumentet më të mira që burojnë nga ajo, nuk do të mjaftonin për të garantuar mbrojtje adekuatë.

Raportuesi: Patris Kuesada – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Sesioni i V-të: “Zgjedhjet”

Moderatore: Petra Blaas – Pakti i Stabilitetit

Folësi kryesor: Vernon Bogdanor – Universiteti i Oksfordit, Kolegji i Brasenosrit

Folësi kryesor: Uilliam Spenser, Grupi për Ligji Publik Ndërkombëtar dhe Politika

Respondent: Nazim Jashari, Grupi parlamentar ORA

Qëllimi

Në themel të vëmendjes së këtij sesioni ishin zgjedhjet në kontekstin kushtetues, përfshirë këtu llojet e sistemeve zgjedhore dhe krijimin e organit (institucionit) për monitorimin e zgjedhjeve.

Folësi i parë

Folësi i parë, fjalën e tij e nisi me diskutimin rreth metodave që do të siguronin zgjedhje të drejta dhe të ndershme, që do të mund të arriheshin sidomos përmes krijimit të një komisioni zgjedhor. Më pas, ai i bëri të ditura edhe pesë funksionet më të rëndësishme të një komisioni elektorale që sipas tij janë: Administrimi i zgjedhjeve; përcaktimi i drejtë i kufijve të zonave elektorale; të sigurojë që mediati të raportojnë në mënyrë të ndershme dhe që secilës parti t’i vihet në dispozicion kohë e barabartë; të sigurojë që partitë të mbajnë llogari për kontributet dhe shpenzimet e tyre; si dhe të sigurojë dhe ofrojë edukatë qytetare dhe t’i informojë votuesit.

Ai vazhdoi pastaj me sqarime rreth modeleve të ndryshme të komisioneve elektorale: Njëri model përbëhet nga anëtarë të paanshëm, jopartiak siç janë gjyqtarët, ndërsa modeli tjetër i komisionit përbëhet nga një numër i balancuar i anëtarëve të partive politike dhe kryesohet nga ndonjë anëtar jopartiak dhe në këtë model komisionesh mund të ketë edhe anëtarë ndërkombëtarë. Sidoqoftë, që të dy modelet e komisionit elektorale duhet ta fitojnë besimin e qeverisë, duke qenë të pavarura dhe transparente.

Përfaqësimi i drejtë

Duke diskutuar për krijimin e një sistemi zgjedhor që do të bënte të mundur një përfaqësim të drejtë, ai bëri fjalë edhe për shumëllojshmërinë e sistemeve zgjedhore që ekzistojnë në shtetet bashkëkohore evropiane: modelin “i pari fiton më së shumti”³, apo modelin e përfaqësimit proporcional. Sistemi është më praktik kur në garë janë më shumë parti politike dhe, ajo që është më me rëndësi, bën të mundur një përfaqësim më të drejtë të minoriteteve dhe individëve, duke i kushtuar njëherësh kujdes të veçantë barazisë gjinore. Sistemin i përfaqësimit proporcional, mund të jetë sistem zgjedhor apo kombëtar siç është rasti me Izraelin. Është me rëndësi të vihet në dukje se të gjitha vendet që e përdorin sistemin e përfaqësimit proporcional e caktojnë një prag elektorale, të cilin partia, që hyn në garën zgjedhore, duhet ta arrijë për të qenë e përfaqësuar.

Folësi po ashtu sqaroi se me rastin e përcaktimit të sistemit elektorale, duhet vendosim se a dëshirojmë të votojmë për kandidatin (me lista të hapura) apo për partinë (me lista të mbyllura). Folësi rekomandoi një përfaqësim të balancuar të zonave zgjedhore shumëkandidatëshe, ku gratë dhe minoritetet do të mund të përfaqësoheshin pa pasur nevojë për rregulla të veçanta procedurale.

Në fund, folësi vuri në pah se nuk ekziston ndonjë sistem ideal zgjedhor, ndaj dhe shtetet duhet të zgjedhin atë sistem që u përgjigjet më së miri nevojave të tyre.

³ Ku partia që fiton merr shumicën dërrmuese të vendeve në legjislativ, madje një numër edhe më të madh të vendeve se sa që kanë fituar me përqindje të votave.





Folësi i dytë

Folësi i dytë, filloi me konstatimin se shumë kushtetuta ngërthejnë në vete edhe nga disa dispozita të veçanta për zgjedhjet, ndërsa ka edhe shtete të cilat përcaktohen për nxjerrjen e ligjeve të veçanta elektorale ndaras nga kushtetuta. Sipas tij, kjo bën të mundur që të mbrohen normat nga keqpërdorimi dhe manipulimi eventual nga partia në pushtet, ngaqë kushtetuta vështirë ndryshohet. Disa nga çështjet që zakonisht rregullohen dhe përcaktohen me kushtetutë, pos të tjerash, janë: pavarësia e komisionit zgjedhor; përbërja e komisionit; mandati; e drejta e votës; regjistri i zgjedhësve; të drejtat e partive politike; kufijtë e zonave elektorale; rregullat e zgjedhjeve presidenciale; sistemi zgjedhor vendor; të drejtat për kandidaturë; kualifikimet e kandidatëve; afatet kohore zgjedhore; afatet përfundimtare; dhe zgjidhja e ankesave apo kontesteve zgjedhore.

Veç kësaj, folësi shprehu shqetësimin e tij për përfshirjen e shumë dispozitave për zgjedhjet në kushtetutë, por njëherësh theksoi se një gjë e tillë mund të jetë edhe e dobishme, ngase mund të shërbejë edhe si mbrojtëse shumë e dobishme e proceseve demokratike. Sipas tij, ekzistojnë disa parime "universale" ku bëjnë pjesë e drejta e çdo njeriu për të votuar dhe për t'u votuar, pastaj e drejta për të kërkuar që listat e zgjedhësve (regjistri elektor) të jenë të azhurnuara si dhe përcaktimi i kriterëve të qarta për ta paraqitur kandidaturën. Njëherësh, ekzistojnë edhe një mori parimesh që përcaktojnë "barazinë" si: të drejtat e barabarta për të votuar; ndarja e balancuar e ulëseve, barazia e opozitës, si dhe barazia gjinore dhe e minoriteteve. Shteti duhet të jetë neutral në zgjedhje dhe duhet t'i ndëshkojë ata që i shkelin rregullat e fushatës. "Sekreti" ruhet, duke bërë të mundur që vota të jetë individuale apo edhe private. Dhe fare në fund, "drejta për votim të drejtpërdrejtë" ruhet duke lejuar që të zgjidhet drejtpërsëdrejti së paku një dhomë e parlamentit, disa organe legjislative dhe disa këshilla⁴.

Respondenti

Respondenti foli për situatën në Kosovë dhe me këtë rast edhe një herë theksoi se Kosova ka një ligj të shkëlqyeshëm elektorale dhe njëherësh përkujtoi se Kosova ka mbajtur zgjedhje të lira dhe të drejta, ku ka pasur jo vetëm përfaqësim të drejtë të partive dhe kandidatëve por edhe mbulim të drejtë të mediave. Ai njëherësh pohoi se obligimet financiare janë përmbushur konform kodit zgjedhor, ndërsaq pos këtyre edhe kërkesat zyrtare për partitë, kandidatët dhe procedurat po ashtu janë plotësuar.

Diskutimi i hapur

Diskutimi i hapur u përqendrua rreth mbrojtjes së minoriteteve përmes procesit zgjedhor. Me këtë rast, diskutuesit u pajtuan rreth përfaqësimit të minoriteteve, por nuk ishin dakord për mënyrën se si të arrihet përfaqësimi "i drejtë". Ca diskutues ishin të mendimit se kushtetuta duhet të garantonte "siguri" apo vende të rezervuara dhe brenda mundësive edhe disa ministri të rezervuara, ashtu siç është parashikuar tani. Ndërsa, disa të tjerë shtruan dilemën nëse një shtet mund të jetë vërtetë demokratik nëse është i obliguar që të rezervojë vende (ulëse), duke tërhequr vërejtjen se sistemi aktual i ulëseve të rezervuara në Kosovë është i padrejtë ndaj partive të mëdha.

Raportuesja: Xhenifer Ober – Grupi për Ligj Publik Ndërkombëtar dhe Politika



Sesioni i III: "Çështje të tjera kushtetuese"

Moderator Pitër Vanhojte – Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësi kryesor: Poll Williams, Universiteti Amerikan, Kolegji i Drejtësisë i Uashingtonit dhe Shkolla për Shërbime Ndërkombëtare
Volf-Majkell Mors, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Respondent: Naim Jerliu, Grupi parlamentar i LDK-së

Qëllimi

Në epiqendër të vëmendjes së këtij sesioni ishin të gjitha çështjet tjera kushtetuese, që nuk bëjnë pjesë në kategoritë kryesore. Ndaj, në këtë sesion, pos të tjerash, u debatua edhe rreth procedurës për ndryshimin dhe/ose amendimin e kushtetutës, zbatimin e traktateve ndërkombëtare si dhe për procedurat e transferimit të sovranitetit tek organizatat mbikombëtare.


⁴ Folësi iu referua Komisionit të Vjenës si burim dhe shembull i shkëlqyeshëm, i cili përfaqëson "trashëgiminë" zgjedhore të Bashkimit Evropian.

Folësi i parë

Në prezantimin e tij foli për një mori çështjesh dhe u përpoq të bëjë një ndërlidhje të tyre me specifikat e Kosovës. Fillimisht ai vuri në dukje se procedura që përdoret më së shumti për ndryshimin e kushtetutës është ajo përmes votimit të shumicës së veçantë në parlament, që më pas votohet ose edhe nuk votohet në referendum. Ai më pas pohoi se supermacia ligjore e kushtetutës është parimi thelbësor. Ndërkaq, shtetësia mund të përcaktohet qoftë përmes deklarimit të drejtave dhe detyrave apo përmes deklarimit të kushteve për shtetësi. Sipas tij, çështje të tjera me rëndësi janë edhe gjuhët zyrtare apo gjuhët e mbrojtura si dhe kushtet për shpalljen dhe kohëzgjatja e gjendjes së jashtëzakonshme. Ai po ashtu konsideron se çështjet si simbolet, flamuri, himni, kryeqyteti nuk është e thënë që të figurojnë në kushtetutë, ndaj ato mund të rregullohen përmes ligjeve të veçanta.

Folësi i dytë

Bëri një analizë krahasuese të llojeve të ndryshme të kushtetutave (kryesisht të Gjermanisë, Danimarkës dhe Sllovenisë), duke vënë në pah një sërë mundësish dhe opcioneve. Ai po ashtu theksoi nevojën që t'i referohemi studimeve të ndryshme krahasuese me qëllim që të shihet se cila do të ishte zgjidhja që do t'i përshtatej më së miri Kosovës. Ndërkaq, kur është fjala për natyrën e kushtetutës, ai bëri të ditur se ajo mund të jetë qoftë normative apo edhe simbolike; se mund të ketë formulime qoftë relevante apo edhe të zakonshme (rituale); se kushtetuta mund të jetë ose kërkuese ose edhe diskriptive, se kushtetuta mund të ketë tekst fleksibil (interpretues) apo edhe të ngurtë (rigjid); po kështu, amendimet mund të bëhen qoftë duke e ndryshuar gjuhën në kushtetutë apo duke e modifikuar interpretimin e saj. Parimisht, ajo që është me rëndësi të mbahet parasysh me këtë rast është se nuk ka tekst ideal dhe që zgjidhjet duhet t'u përshtaten dhe të jenë në pajtim me kontekstin (situatën). Së këndejmi, ajo që duhet të kihet parasysh është se kushtetuta nuk është vetëm një tekst, por se ajo duhet kuptuar në kontekstin e rrethanave shoqërore dhe politike.



Respondenti

Duke bërë fjalë për procesin e statusit ai vuri në pah se supermacia e kushtetutës do të paraqiste problem për Kosovën në rast se kushtetuta do të ishte rezultat i negociatave e jo i votës së popullit. Ai po ashtu ishte i mendimit se procesi kushtetues duhet të jetë proces legjitim, ndërsa Kuvendi, sipas tij, duhet ta ketë rolin kryesor në këtë proces. Së këndejmi, Kuvendi duhet ta sigurojë pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve me qëllim që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe që të krijohet pronësia ndaj këtij procesi.

Veç kësaj, ai vuri në dukje se çështja e forcave mbrojtëse do duhej të ishte pjesë e debatit, ngase Kushtetuta do të duhej të gjente zgjidhje edhe për këtë çështje. Njëherësh, ai bëri të ditur se edhe kjo çështje është pjesë e negociatave për status.

Diskutim i hapur

Shumë nga këto çështje që u shqyrtuan në këtë sesion tanimë ishin diskutuar në sesionet e mëparshme, të cilat në themel të vëmendje kishin bashkëveprimin midis procesit të statusit dhe procesit kushtetues. Pjesëmarrësit ishin të mendimit se ndonëse të dy këto procese janë të ndërlidhura, megjithatë është më mirë që të përqendrohen në çështje jostatusore me qëllim që të evitohet mundësia që këto dy procese paralele të shkonin në drejtim të kundërt me njëra me tjetrën. Çështja tjetër që u shtrua ishte se deri ku do të shkonte procesi i zgjidhjes së statusit në këtë aspekt. Ca diskutues shprehën bindjen e tyre se kushtetuta e re, sipas të gjitha gjasave, nuk do të ofrojë më pak të drejta, sidomos për pakicat, krahasuar me kornizën aktuale kushtetuese. Së këndejmi, sipas tyre, është me rëndësi që të priten rezultatet e bisedimeve.



Raportuesi: Ludevik Vanost – Misioni i OSBE-së në Kosovë





Pjesëmarësit e konferencës PERCI

1. Ambasadori Werner Wnendt (Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë)
2. Kolë Berisha (Kryetar i Kuvendit të Kosovës)
3. Anna Gorska (OSBE)
4. Paul Williams (Ekspert)
5. William Spencer (Ekspert)
6. Amjad Atallah (Ekspert)
7. Frederick Lorenz (Ekspert)
8. Jennifer Ober (Ekspert)
9. Vernon Bodganor (Ekspert)
10. Emilia Drumeva (Ekspert)
11. Muscat Azzopardi (Ekspert)
12. Zlatko Dimitroff (UNOSEK)
13. Petra Blaess (Pakti i Stabilitetit)
14. Ramë Manaj (KK)
15. Daut Beqiri (KK)
16. Isa Mustafa (ZKMK)
17. Bardhyl Hasanpapaj (MD)
18. Gjergj Dedaj (Për Integrim)
19. Zylfi Merxha (Për Integrim)
20. Sabit Rrahmani (Për Integrim)
21. Gjylnaze Syla (AAK)
22. Zylfije Hundozi (AAK)
23. Mazllom Kumnova (AAK)
24. Myrvete Dreshaj (AAK)
25. Bislim Hoti (AAK)
26. Xhevdet Neziraj (AAK)
27. Džezair Murati (6+)
28. Mahir Yağcılar (6+)
29. Altay Soroy (6+)
30. Ergin Koroglu (6+)
31. Bajram Latifi (6+)
32. Ferid Muhić (6+)
33. Randel Nojkić (SLKM)
34. Oliver Ivanović (SLKM)
35. Dragiša Krstović (SLKM)
36. Vesna Jovanović (SLKM)
37. Slađan Ilić (SLKM)
38. Snežana Milić (SLKM)
39. Jakup Krasniqi (PDK)
40. Hydajet Hyseni (PDK)
41. Hajredin Kuqi (PDK)
42. Fatmir Limaj (PDK)
43. Selvije Halimi (PDK)
44. Enver Hoxhaj (PDK)
45. Fehmi Mujota (PDK)
46. Bajram Rexhepi (PDK)
47. Arsim Bajrami (PolStrat)
48. Nekibe Kelmendi (PolStrat)
49. Esat Stavileci (PolStrat)
50. Zejnullah Gruda (PolStrat)
51. Ilir Dugolli (PolStrat)
52. Ismet Salihu (PolStrat)
53. Sabri Hamiti (LDK)
54. Melihate Termkolli (LDK)
55. Malsore Gashi (assistant to Mrs. Termkolli)
56. Sadudin Berisha (LDK)
57. Naim Jerliu (LDK)
58. Lutfi Zharku (LDK)
59. Nazim Jashari (Ora)
60. Fatmire Kollqaku (Ora)
61. Afrim Demiri (Ora)
62. Albert Prenkaj (Ora)
63. Agon Vrenezi (Ora)
64. Chad Rogers (NDI)
65. Ben Crampton (BE)
66. Fredrik Wesslau (UNMIK)
67. Bryan Hopkinson (UNMIK)
68. Oleg Levitin (Shef i Misionit të OSBE-së në Maqedoni)



A Global Pro Bono Law Firm

PROCESI I HARTIMIT TË KUSHTETUTËS

Paul R William's
Prezantim

Korrik 21, 2006

Që në fillim do të doja të falënderoj z. Kolë Berishën dhe Ambasadorin Vnent për ftesën që m'a bënë për të marrë pjesë në këtë seminar. Falënderoj po ashtu z. Frenklin De Vrieze, z. Blerim Velën dhe znj. Xhenifer Ober për përpjekjet dhe angazhimin e tyre për organizimin e këtij seminari. Njëherësh, falënderoj pjesëmarrësit, të cilët kërkuan ndihmën tonë në kohën kur Kosova është duke përgatitur kushtetutën e saj. Jam i nderuar që mu dha rasti dhe mundësia që t'i shkëmbej idetë dhe pikëpamjet e mia me ata të cilët do ta hartojnë Kushtetutën e Kosovës.

Organizatorët kanë kërkuar nga unë që këtë seminar ta filloj me një prezantim të shkurtër lidhur me praktikatat moderne të shteteve gjatë procesit të hartimit të kushtetutës.

Qëllimi i prezantimit

Qëllimi i prezantimit tim është që të bëj një vështrim lidhur me elementet dhe praktikatat kryesore gjatë procesit të hartimit të kushtetutës në shtetet që sapo kanë dalë nga konflikti.

Së këndejmi, gjatë prezantimit tim do të bëj fjalë për mësimet e nxjerra nga modelet e kushtetutave të vendeve që kanë përjetuar konflikte kohëve të fundit, duke përfshirë Afrikën Jugore, Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Afganistanin, dhe Irakun.

Me këtë rast, kësaj çështje do t'i qasem nga një perspektivë shumë praktike. [shënimet për pjesëmarrësit nga PILPG – Bosnja në Dejton, ridraftimet e kohëve të fundit, verën e shkuar në Irak (Spence), pastaj për tri vite në Palestinë (Amjad); sapo kërkuar rishikimin e Kushtetutës së re të Nagorno-Karabahut; projekti i ri në Gjeorgji (Rick Lorenz), dhe ja sapo u kthye nga Shri Lanka.]

Do të nis prezantimin tim me një analizë të asaj që quhet "konstitucionalizëm i ri" në shekullin njëzet e një, apo me nocionin procesi pjesëmarrës në hartimin e kushtetutës.

Më pas, do të bëj një analizë të mekanizmave të përgjithshëm që janë krucial për çdo proces kushtetues demokratik, si dhe do të përqendrohem në rëndësinë e vetë procesit të hartimit të Kushtetutës.

Paskëtaj, do të bëj një vështrim mbi pesë mësimet e mësuara gjatë procesit të hartimit të Kushtetutës. Ndërsa, do ta përmbylli me një sqarim të shkurtër rreth menaxhimit të rolit të bashkësisë ndërkombëtare

Hyrje

Gjatë njëzet viteve të shkuara, pas valës së procesit të hartimit të kushtetutave në vendet e dala nga konfliktet, është paraqitur një qasje e "konstitucionalizmit të ri" që përqendrohet si në procesin demokratik ashtu edhe në rezultatet e procesit demokratik.

Një nga kritikatat që i adresohen qasjeve tradicionale të hartimit të kushtetutës është se ato kanë qasje statike, të pandryshueshme dhe kontraktuale ndaj procesit të hartimit të kushtetutës.

Deri sa qasjet tradicionale e konsideronin kushtetutën si një "akt të kryer", qasja e re e hartimit të kushtetutës përqendrohet në "në procesin pjesëmarrës të hartimit të kushtetutës" apo në "konstitucionalizmin bashkëbisedues"²

Qasja e re karakterizohet me një transparencë më të madhe dhe me një pjesëmarrje më të gjerë të publikut.

Procesi po ashtu karakterizohet edhe me shtimin e përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare në proces, ndaj ndryshe njihet edhe si "përpjekje e përbashkët me bashkësinë ndërkombëtare"³

Si rezultat, legjitimiteti i procesit kushtetues dhe i vetë kushtetutës matet me shkallën e pjesëmarrjes në proces, sa është i hapur dhe demokratik procesi, sa është përfshirë shoqëria apo sa është transparent procesi, si dhe nga ajo se a janë njerëzit që janë përfshirë në procesin e hartimit, njerëz të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe të përgjegjshëm⁴

¹ Vivian Hart, *Procesi Demokratik i Hartimit të Kushtetutës*, Instituti për Paqe i ShBA-ve, Raport Special No. 107, Korrik 2003, mund të gjendet në <http://www.usip.org/pubs/speciaheports/sr107.html> (herën e fundit është rishikuar me 3/31/05).

² Id.

³ Margaret A. Burnham, *Procesi Demokratik i Hartimit të Kushtetutës në Afrikën Jugore*, Boston Review, 1998, mund të gjendet në http://www.nidcbowen.org/p2/rni/reports/constitution_making.htm (herën e fundit është rishikuar me 3 prill 2005).

⁴ Shih Hart, supra note 1..

Fazat Kryesore të Procesit të Hartimit të Kushtetutës

Ti kthehemi tani vetë procesit të hartimit të kushtetutës. Zakonisht procesi i hartimit të kushtetutës ndahet në katër faza:

- Faza përgatitore;
- Faza e hartimit të kushtetutës;
- Faza e konsultimit publik; dhe
- Faza e rishikimit përfundimtar dhe faza e miratimit.

Faza e parë: Faza përgatitore

- Faza përgatitore përbëhet nga:
- Bisedimet fillestare lidhur me procedurën, planifikimin e procesit, dhe përcaktimin e afateve reale kohore;
- Marrëveshja mbi një sërë parimesh bazë mbi të cilat do të drejtohet procesi i hartimit të kushtetutës;
- Konsultimi dhe informimi i publikut, dialogu në nivel kombëtar rreth ndryshimeve kushtetuese apo rishikimeve të mundshme;
- Mundësia e miratimit të një dokumenti kushtetues të përkohshëm, tranzitor; (ky dokument tanimë ekziston në Kosovë)
- Dhe, themelimi i komisionit kushtetues

Faza e dytë: Faza e hartimit të kushtetutës

- Themelimi i një komisioni kushtetues të zgjedhur apo të një asambleje që do ta mbikëqyrë hartimin e dokumentit përfundimtar;
- Konsultime gjithëpërfshirëse me këshilltarë dhe ekspertë ligjorë, bashkësinë ndërkombëtare, me një spektër të gjerë të palëve të interesuara, të gjitha partitë politike që janë të interesuara të marrin pjesë në proces, si dhe publikun e gjerë;
- Përgatitja e një drafti fillestar të kushtetutës, përmes komisioneve hartuese transparente, dhe informacioneve dhe sugjerimeve (inputeve) të rregullta nga publiku, pastaj përmes përzgjedhjes së këshilltarëve ndërkombëtarë, si dhe të këshilltarëve ligjorë si vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë.

Faza e tretë: Faza konsultimeve publike

- Një informim publik në shkallë vendi, fushata në media, pranimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve;
- Përdorimi i mjeteve tradicionale dhe kreative të diskutimit dhe dialogut publik, para apo edhe gjatë procesit të hartimit të draftit të parë të kushtetutës; ueb-faqja
- Pjesëmarrje -e strukturuar mirë- nga radhët të gjitha grupet- veçanërisht gratë, minoritetet të gjitha partitë politike përfshirë ato në opozitë, dhe shoqëria civile;

Faza e katërt: Shqyrtimi përfundimtar dhe faza e miratimit

- Periudha për modifikimin e draftit të tekstit të kushtetutës për përfshirjen e komenteve dhe sugjerimeve të publikut të gjerë dhe të ekspertëve;
- Shqyrtimi nga komisioni i kushtetutës, parlamenti ose gjykatat, ashtu si edhe nga publiku, për ndryshimet e nevojshme, amendamentet ose për kontribut më të madh nga publiku;
- Miratimi i gjerë dhe përshtatja e tekstit përfundimtar nëpërmjet komisionit kushtetues, përfaqësuesit e zgjedhur, ose me anë të një procesi kombëtar të referendumit;
- Një proces pas miratimit të edukimit të publikut, i ratifikimit kombëtar, dhe konferenca për legjitimitetin e produktit përfundimtar.

Pesë rregullat e krimit të Kushtetutës

(E përshtatur nga një dokument i përgatitur nga Jennifer Widner për Institutin e SHBA ve për Paqë)

Rregulla 1: Kufizimi i ndikimit dhe dominimit të partnerëve ndërkombëtarë

Kontrolli i partnerëve ndërkombëtarë në procesin e hartimit të kushtetutës mund të sjellë deri te delegjitimimi i kushtetutës dhe të ngjallë mosbesim. Po ashtu, shfaqja e kontrollit me anë të një force ndërkombëtare, siç është Koalicioni në Irak, OHR-ja në Bosnjë, ose UNMIK-u në Kosovë mund ta delegjitimojë kushtetutën.

Masat për pakësimin e dominimit të partnerëve ndërkombëtarë:

Organizimi i një tryeze të rrumbullakët me personat kryesorë me kompetencë për të përzgjedhur një gamë formatesh ose modelesh të mundshme. Vlerësimi transparent i proceseve.

Amortizimi i procesit të ndikimit të kontrollit nga partnerët ndërkombëtarë me anë të delegimit të emërimit të pjesërishtëm të një komisioni hartues për partitë opozitare.

Gjetja e një politikani për kryesimin e seancave që është neutral, gjerësisht i respektuar dhe pa ambicie politike. Kjo, natyrisht, është më lehtë të thuhet se të arrihet.

Rregulla 2: Sigurimi i mundësive të shumëfishta për pjesëmarrje Pjesëmarrja publike mund të lindë ide të dobishme. Krijon një model për sjelljen demokratike të së ardhmes

Shpërndan informata dhe i jep formë aftësisë së qytetarëve të zakonshëm për monitorimin e përmbajtjes së rregullave themelore Ndihton mënjanimin e anshmërisë nga kontrolli i jashtëm.

Masat për sigurimin e mundësive të dhumëfishta për pjesëmarrje:

Konsultimi me qytetarët e zakonshëm para dorëzimit të tekstit të dytë për diskutim (seancat, anketat, kërkesat me shkrim) (2 milion në Afrikën e Jugut - 30,000 në Irak)

Mundësimi i grupeve sociale dhe ekonomike dhe i partive dobët të përfaqësuara për emërimin e përfaqësuesve që do të jenë krahas delegatëve të zgjedhur

Rregulla 3: Zgjedhja e rregullave procedurale që nxisin kompromis

Shumë procese të hartimit shkatërrohen si pasojë e strukturimit joadekuat të kompromiseve që kanë të bëjnë çështjet e rëndësisë primare.

Masat për zgjedhjen e rregullave procedurale që nxisin kompromis:

Në vend të kuorumeve të larta dhe shumicave të thejshta zgjedhni kushte të ulët ta kuorimit dhe supermajorancë ose shumicë të kualifikuar (ndihmon në shmangien e bojkoteve)

Inicimi i funksionimit të komisioneve të punës brenda disa ditëve të para. Ndalimi i fjalëve të gjata hyrëse gjatë seancës plenare. Mbyllja e e seancave të hershme të negociimit për media.

Balancimi i nevojës për qasjen e publikut dhe kontributit të publikut me nevojën për parandalimin e punës së komisionit nda shndërrimi në platformë publike për avantazh politik.

Rregulla 4: Përqendrimi në të ardhmen

Shikimi nga e ardhmja është i rëndësishëm për suksesin e procesit të hartimit për shkak se u ndihmon delegatëve t'i shmangen kundërpadsisë.

Masat për përqendrimin në të ardhmen:

Fillimi me një shabllon teknik (tekst) që përvijon opsionet e mundshme dhe siguron gjuhë hartuese-jo me një letër të zbrazët, dhe thirreni diskutimin për formulimin teknik.

Shmangja e fjalëve hyrëse që e theksojnë të kaluarën-kufizimi i kohës për fjalët hyrëse.

Ndalimi i komisioneve tematike që përqendrohen në çështjet jo kushtetutare. Ky është një proces i ndarë nga statusi përfundimtar

Mos u mundoni të rregulloni çdo gjë nëpërmjet kushtetutës, por ajo duhet t'i reflektojë parimet e gjera

Përdoreni kushtetutën për definimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të ndryshme, dhe për të krijuar mekanizma të zbatueshëm për përshtatjen e një marrëdhënie zhvilluese (Maqedonia po, Bosnja jo)

Kushtetuta nuk është vetëm ligj, ajo është më e rëndësishme se ligji, gërsheton parimet që do ta drejtojnë shtetin e Kosovës dhe krijon mekanizma për kompromis politik dhe për vetëqeverisje të efektshme.

Rregulla 5: Miratimi paraprak i rregullave të qarta të punës

Pasiguria për formatin dhe kohën e ngjarjeve shkakton mosbesim dhe akuza për manipulim.

Masat për zvogëlimin e pasigurisë në proces:

Shpallja paraprake e një agjende të qartë, me kritere për lejimin e zgjatjeve (meqë fleksibiliteti padyshim se do të jetë i nevojshëm)

Zhvillimi i rregullave procedurale në kuadër të takimeve të mbyllura të komisionit, por me konsultim të gjerë privat.

Zhvillimi i kapacitetit për përkthim simultan, përkthim të shpejtë, botim të shpejtë të teksteve

Menaxhimi i komunitetit ndërkombëtar

Nëse ju nuk shkruani-ata do të shkruajnë.

Kërkoni ndihmë specifike – ngarkojeni me punë komunitetin ndërkombëtar duke siguruar studime konkrete dhe takime informative. Mos kërkoni nga ta hartimin e gjuhës.

Zhvilloni rregulloren e punës për mënyrën dhe kohën kur komuniteti ndërkombëtar mund të ftohet për ofrim të ndihmës.

Kujdes me llojin laboratorik të konstruksioneve kushtetutare:

Kujdes me agjendën personale– duhet të jetë një kushtetutë e Kosovës për të gjithë kosovarët.

Përmbyllje:

Proces i gjatë dhe i komplikuar. Shumë aspekte që duhet ndërthurur mes vete. Roli specifik i partive politike, publikut dhe komunitetit ndërkombëtar. Duhet të ekzistojë një proces i strukturuar shumë mirë. Ndoshta edhe më i rëndësishëm se statusi përfundimtar – në këtë drejtim procesi u takon tërësisht Kosovarëve.

Prof.dr.Arsim Bajrami
Profesor i së Drejtes Kushtetues në Fakultetin Juridik në Prishtinë

ASPEKTET KUSHTETUESE TË NDARJES SË PUSHTETEVE DHE KONTROLLI PARLAMENTAR I QEVERISË
(qasje krahasuese kushtetuese)

Roli i Kushtetutës në shoqëritë demokratike

- ✎ Kushtetuta si kontrate midis qytetareve për ngritjen dhe ushtrimin e politikave publike
- ✎ Kushtetuta si akti i institucionalizimit të pushtetit dhe kufizimin e tij
- ✎ Kushtetuta si baze e ndertimit të shtetit politik, ekonomik dhe shoqëror
- ✎ Kushtetuta dhe sistemi i qeverisjes

Kushtetuta e Kosovës në kontestin e statusit final

- ✎ Kushtetuta e re -akt konstituviv i themelimit të shtetit të ri,
- ✎ Kushtetuta e Kosovës -akt i garantimit të të drejtave të komuniteteve pakicë në Kosovë
- ✎ Kushtetuta e re e Kosovës- bazë e funksionimit të demokracisë parlamentare në Kosovë
- ✎ Kushtetuta e Kosovës-bazë për integrimet euro-atlantike të Kosovës

Kushtetuta dhe procesi i negociatave

- ✎ Parimet kushtetues për të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë, mbrojtja e tyre, përfaqësimi në institucionet e niveli lokal dhe atë qendror;
- ✎ Parimet kushtetuese të reformës së pushtetit lokal
- ✎ Kushtetuta e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës
- ✎ Nevoja e shmangjes së vakumit kushtetues pas statusit final.
- ✎ Roli i qytetarit dhe Kushtetuta

NDARJA E PUSHTETIT SHTETËROR

- ✎ Pushteti kushtetutëdhënës dhe legjislativ
- ✎ Pushteti ekzekutiv-administrativ
- ✎ Pushteti gjyqësor



Parimi i ndarjes së pushteteve dhe forma e qeverisjes


- ✎ Sistemi parlamentar
- ✎ Sistemi presidencial
- ✎ Sistemi i përzier parlamentar-presidencial

Funksionet e ndarjes së pushteteve

- ✦ Pavarësia e pushteteve
- ✦ Kufizimi reciprok i pushteteve
- ✦ Sigurimi i demokracisë së ekuilibruar
- ✦ Sistemi chec and balances

Raporti midis pushteteve (checks and balance)


- ✦ Raporti midis pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv
- ✦ Raporti midis pushtetit legjislativ dhe pushtetit gjyqësor
- ✦ Raporti midis pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor



Mënyrat e ndarjes së pushteteve

- ✦ Ndarja fluide e pushteteve-interferenca në mes pushteteve
- ✦ Ndarja e ngurtë e pushteteve-pavarësia dhe ruajtja e ekuilibrave
- ✦ Ndarja mikste e pushteteve-ndërhyrjet reciproke

Ndarja e pushteteve në SHBA



Kongresi



Struktura e Kongresit përbëhet:

- ✦ Dhoma Përfaqësuese (435 përfaqësues)
- ✦ Senati (100 senatorë)

Presidenti

Bartës i pushtetit ekzekutiv ku edhe sistemi i qeverisjes emërtohet si presidencial



Shtëpia e Bardhë



Inaugurimi i Presidentit

Gjykata Supreme

Gjykata Supreme si bartëse e pushtetit gjyqësor e cila krahas funksioneve klasike gjyqësore ushtron edhe këto funksione:

- ✦ Kontrollin dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë
- ✦ Zgjidh konfliktet e kompetencës ndërmjet federatës dhe shteteve federative



Gjykata Supreme

Raporti midis Kongresit dhe Presidentit

Xhon Stuart Mill-i theksoi “detyrë e vërtetë e asanblesë përfaqësuese është që të mbikqyrë dhe kontrollojë qeverinë.” Ky është funksion që Kongresi vazhdon ta ushtrojë edhe sot e kësaj dite me një pavarësi të theksuar



Kabinati i Gerald Fordit

Buxheti si mekanizëm i kontrollit

- ✦ Neni I, kaptina 9, e Kushtetutës përcakton se “asnjë para nuk do të harxhohet nga Thesari për atë që nuk është e caktuar me ligj”. Kjo dispozitë i siguron Kongresit (si pushteti i kuletës) fjalën e fundit mbi shpenzimin e mjeteve
- ✦ Zyra e Administrimit dhe Buxhetit (The Office of Management and Budget-OMB) e themeluar nga Kongresi më 1921 mbikqyrë dhe përgatit buxhetin e degës ekzekutive



Nënshkrimi i ligjeve


- ✦ Kongresi mund ta kundërshtoj Presidentin në shumë mënyra: anulon çdo rezolutë që mbështet Presidentin, zvogëlon apo ndërpret fondet për zhvillimin e luftës (psh. Bushi i kërkoi Kongresit mbi 80 miliardë dollarë shtesë për luftën në Irak në vitin 2005)



Bushi duke nënshkruar një ligj

Institucioni i impiçmentit (impeachment)

- ✦ Konventi Kushtetutvënës përcaktoi se askush nuk do të jetë mbi ligjin dhe se çdo president dhe funksionar tjetër i lartë mund të jetë objekt i impiçmentit
- ✦ Impiçmenti është mekanizëm i fundit dhe gjithmonë i pranishëm ndaj ekzekutivit, si armë e fuqishme kundër tiranisë dhe arbitraritetit të këtij pushteti apo siç pohonte Joseph Story “të mbrojë shtetin nga keqpërdoruesit e mëdhenjë shtetëror”



Procedura e Impiçmentit


- ❑ Bartës i akuzës është Dhoma Përfaqësuese ndërsa Senati konstituohet si gjykatë i cili gjykon dhe vendos me akgjykim. Aktgjykimi mund të jetë lirues, ose fajësues (ku me dy të tretat e votave mund të shkarkohet Presidenti). Kryetari i Gjykatës Supreme kryeson Senatin gjatë gjyqimit



Dhoma Përfaqësuese



Senati



Andrei Xhonsoni

- ✦ Impiçmenti është zbatuar shumë rrallë, vetëm në rastin e presidentit Andrei Xhonson 1868 (me aktgjykim lirues), kundër presidentit Richard Nikson 1973 (jep dorëheqje para se Dhoma Përfaqësuese të votonte) dhe kundër presidentit Bill Klinton (me aktgjykim lirues)




Riçard Nikson



Bill Klinton

AFERA WATERGATE


- ✦ Afera Uatergate me Nixon-in provoi jo vetëm pozicionin e fuqishëm të presidentit të zgjedhur nga votat e popullit, por gjithashtu provoi se si një kombinim i pushteteve i ushtruar nga Kongresi dhe Gjykata Supreme, si dhe opinioni publik dhe mediat mund ta shkarkojnë çdo president nga detyra



Kompleksi Watergate

AFERA LEWINSKY

- ✦ Në Shkurt të vitin 1999 kriza përfundoi kur Senati dështoi të siguroj dy të tretat e votave për shkarkimin e presidentit.
- ✦ Gjykimi i Senatit ishte i ndikuar nga përkrahja dy me një e opinionit publik amerikan për të mos dënuar presidentin Klinton ngaqë vlerësonin lartë punën e tij



Gjykimi i Klintonit

Rasti - Bill Klinton-AFERA LEVINSKY

- ✦ Në vitin 1998 mediat dhe shtypi publikuan aferën e Presidentit Bill Klinton me mjeken praktike në Shtëpinë e Bardhë Monica Levinsky
- ✦ Dhoma Përfaqësuese duke u mbështetur në pohimin se vepra e Presidentit lë mundësinë për një veprë që ka të bëjë me "krime të rënda dhe keqpërdorime" si dhe për dëshmi të rreme dhe obstrukcion të drejtësisë të ndaluar nga Kushtetuta e SHBA-ve ngriti akuzën e impiçmentit



Uilliam Xheferson Klinton

Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme

- ✦ Emërimin i gjyqtarëve nga presidenti paraqet një formë kontrolli të rëndësishëm mbi Gjykatën Supreme
- ✦ Në një studim(1980) të 84 kandidaturave, 76 gjyqtarë, presidentët i zgjedhën në atë mënyrë ku filozofia politike ishte e ngajshme me të atyre dhe kjo paraqet një tregues për mënyrën e marrjes së vendimeve nga ana e gjyqtarëve



Gjyqtarët aktual në Gjykatën Supreme

Ndarja e pushteteve në britani të Madhe

- ✎ Kurora
- ✎ Parlamenti (Dhoma e Komunave, 659 anëtarë) dhe Dhoma e Lordëve me 1185 anëtarë)
- ✎ Bikameralizëm i disbalancuar
- ✎ Qeveria homogjene në formë kabineti
- ✎ Kryeministri (caktohet nga radhët e partisë që kanë shumicën në Dhomën e Komunave)

Parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve në Francë

- Presidencializmi i kontrolluar
- Bicefalizmi dhe K underfirma
- Qeveria e koalicionit me përgjegjësi të dyfishtë
- Bikameralizmi i ekuilibruar - A sambleja Nationale 491 deputetë dhe senati 305 antarë
- Sistemi elektoral i kombinuar mazhoritar dhe proporcional
- Këshilli Kushtetues

Ndarja e pushteteve në Gjermani

- ✎ Kuvendi Federal (Bundestag)
- ✎ Këshilli Federal (Bundesrat)
- ✎ Kryetari (Bundespräsident)
- ✎ Qeveria Federative (Bundesregierung)
- ✎ Kancelari Federal
- ✎ Gjykata Kushtetuese Federative (Bundesverfassungsgericht)
- ✎ Banka Qëndrore e Gjermanisë (Bundesbank)

Ndarja e pushteteve në Itali

- ✎ Parimet e qeverisjes
- ✎ Republikë parlamentare
- ✎ Bikameralizëm i ekuilibruar
- ✎ Sistemi shumpartiak
- ✎ Qeveria e koalicionit
- ✎ Roli i grupeve të interesit dhe grupeve për presion

Ndarja e pushteteve në Kushtetuten e ardhshme të Kosovës

1. Sistemi i qeverisjes në Kosovë bazohet në parimin e ndarjes së pushtetit dhe sistemit të kontrollit reciprok të pushteteve në funksion të vendosjes së barazëpeshës mes tyre;
2. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria e Kosovës . Qeveria është autoritet kryesor i drejtimit të shtetit dhe implementimit të ligjeve dhe politikave shtetërore. Qeveria i nënshtrohet kontrollit parlamentar;
3. Pushteti legjislativ i ushtrohet nga Kuvendi i Kosovës i cili do të ketë autoritet të plotë ligdhënës dhe kushtetutëdhënës.
4. Presidenti i Kosovës është simbol i unitetit të popullit, përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Kosovës.
5. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e pavarura.

Funksioni legjislativ i parlamentit

- ◆ Nxerrja dhe ndryshimi i Kushtetutës
- ◆ Nxerrja e ligjeve
- ◆ Nxerrja e akteve të përgjithshme
- ◆ Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare
- ◆ Miratimi i buxhetit

Funksioni zgjedhor i parlamentit

- ◆ **Në sistemet parlamentare**, parlamenti zgjedh dhe mbikqyrë qeverinë dhe presidentin-Shqipëria, Kosova etj.
- ◆ **Në sistemet e përzira parlamentare-presidenciale**, parlamenti zgjedh qeverinë, kurse presidenti zgjedhet nga populli-Franca
- ◆ **Në sistemet presidenciale**, qeverinë e zgjedh presidenti

Funksioni mbikqyrës i parlamentit

- ◆ **Mjetet e rregullta-**
- ◆ miratimi i buxhetit dhe raportet periodike
- ◆ **Mjetet e jashtzakonshme-**
- ◆ pytjet parlamentare,
- ◆ interpelanca,
- ◆ komisionet anketuese,
- ◆ mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi i qeverisë

Rekomandimet për Kushtetuten e Kosovës

Rekomandimi I.

Raportet mes Presidentit të Kosovës me Kuvendin duhet përcaktohen në atë mënyrë që Presidentit do t'i pranohen autoritetet për të propozuar ligje, e drejta suspensive e vetos, shpallja e ligjeve dhe shpërndarja e Kuvendit. Në anenë tjetër Kuvendi do të mund të ngriste një akuzë kushtetuese ndaj Presidentit për shkelje të Kushtetutës dhe aktin e tradhtisë dhe të inicone procedurën të Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila me një votim prej 2/3 mund ta shkarkojë Presidentin.

Rekomandimi II.

Sa i përket raporteve të Kuvendit me Qeverinë, Kushtetuta e Kosovës duhet të institucionalizojë kontrollin parlamentar përmes instrumenteve kushtetuese, të cilat mund të rezultojnë edhe me votimin e mosbesimit të qeverisë. Në rastë votimit të votëbesimit të qeverisë, Presidenti i Kosovës për të evituar krizën parlamentare mund të shpërndajë parlamentin dhe të shpallë zgjedhje të parakohëshme parlamentare.

Rekomandimi III.

Kushtetuta e re e Kosovës do të garantoj pavarësin e gjyqësorit, duke e mbrojtur atë nga ndikimet politike të Kuvendit dhe Qeverisë. Kjo do të realizohet përmes respektimit të këtyre parimeve kushtetuese; zgjedhjen e gjyqëtarëve në mandate të gjata,; emrimin e gjyqëtarëve nga presidenti i Republikës, depolitizimin e gjyqësorit, financimin e pavarur etj.

Një rol kyq në sigurimin e pavarësisë së tre pushteteve, do të ketë Gjykata Kushtetuese e cila do të zgjidh konfliktet kushtetuese midis tri pushteteve dhe do të jetë autoritet përfundimtar në mbrojtje të Kushtetutës.



PILPG

Pjesa qenësore dhe më e rëndësishme e ndërtimit të shtetit – Hartimi i Kushtetutës
Mësimet mbi ndërtimi e Institucioneve bazuar në shembullin palestinez



PILPG

- Zgjedhja e strukturës shtetërore
- S trukturimi i ekzekutivit Përvijimi i legjislativit
- Krijimi i sistemit gjyqësor



PILPG

Zgjedhja e strukturës së shtetit

- Cili sistem më së miri i adresohet nevojave të popullit për vetëvendosje, mirëqenie ekonomike dhe të drejtave individuale të njeriut?
- Rradhazi – Konfederal ----- Federal ----- Unitar
- Sistemet unitare janë shumë të centralizuara me pak kompetenca për autoritetet lokale dhe rajonale
- Sistemet federale kanë linja paralele të pushtetit
- Konfederatat lidhin dy apo më shumë njësi paraprijëse për të formuar qeverinë e përbashkët për qëllimet e vëna kushtetuese.



PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore – gjuha

- Shtet Unitar, me territor dhe komb, si subjekt i pandashëm.
- Shtet Federal – është shtet me rregullim federal.
- Konfederatë – ky rregullim i shtetit është union i [emrave të shteteve të bashkuara]. [Konfederata] duhet ta ketë kushtetutën e saj, ligjin dhe institucionet qeveritare. Të gjitha kompetencat veçanërisht të alokuara Qeverisë qendrore duhet të rezervohen për këto shtete.



PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-S tudimi i rastit palestinez

- Cili sistem më së miri i adresohet nevojave të popullit për vetëvendosje, mirëqenie ekonomike, dhe të drejtave individuale të njeriut?
- Nga pikëpamja e vetëvendosjes palestineze, opsioni më i mirë dukej të ishte krijimi i një shteti unitar palestinez prej 22% të Palestinës historike, të përbërë nga Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës.
- Ndonëse, ekonomitë e këtyre të dyjave, të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës janë plotësisht të lidhura me atë të Izraelit pothuajse edhe pas 40 viteve të okupimit. Shkëputja e këtyre lidhjeve ekonomike tanimë i ka shkaktuar çrregullime të pamashë Palestinës, dhe se pavarësia e plotë e Palestinës dhe ndarjes së saj nga Izraeli do t'i duhen dy dekada përpjekje për të krijuar lidhje të ndara ekonomike me ekonominë e dobët jordanëze dhe egjiptiane, respektivisht nga Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës.
- Nga pikëpamja e të drejtave individuale të njeriut, palestinezët u dëbuan apo u zhvendosën nga shtëpitë e tyre në Izrael, dhe se 18% të qytetarëve palestinezë të Izraelit nuk do të mund t'i ushtronin medoemos të drejtat e tyre në 78%, që do të përkufizohej si shtet tërësisht çifut.



PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore–S tudimi i rastit palestinez

- Reagimi palestinez
- I përzier, në të cilin shteti i Palestinës do të ishte shtet unitar por
- Që do të thotë me ndërveprim të vazhdueshëm ekonomik me Izraelin, që kërkon tejkalim kuptimplotë të modeleve ekonomike, rregullore, legjislativ dhe udhë të huaja.
- Të drejtat e refugjatëve dhe çështja e barazisë së qytetarëve palestinezë të Izraelit do të mbetet për t'u negociuar në të ardhmen.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore – Studimi i rastit palestinez

- Reagimi palestinez
- Neni 1: Palestina është një shtet i pavarur dhe sovran, me sistem republikan. Territori i saj është njësi e pandashme brenda kufijve dhe ujërave territoriale të saj, në prag të 4 qershorit të vitit 1967, pa cenim të të drejtave të garantuara me vendime ndërkombëtare lidhur me Palestinën. Të gjithë banorët e këtij territori do t'i nënshtrohen vetëm ligjit palestinez.




SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Studimi i rastit palestinez

- Reagimi palestinez
- Neni 13: Palestinezët, të cilët janë dëbuar apo kanë emigruar nga Palestina, si rezultat i luftës së vitit 1948, dhe të cilëve iu është mohuar kthimi atje, do të kenë të drejtën e kthimit në shtetin palestinez dhe të mbajnë këtë nënshtetësi. Kjo e drejtë është e përhershme dhe pa skadim afati. Shteti i Palestinës do të bëjë përpjekje për të zbatuar të drejtën legjitime të refugjatëve palestinez për t'u kthyer në shtetëpitë e tyre dhe për kompensim, përmes negociatave, përmes kanaleve politike dhe gjyqësore, në pajtim me Rezolutën 194 të Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të vitit 1948 dhe në pajtim me parimet e së drejtës ndërkombëtare.



SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi e kompetencave

- Përgjatë spektrit të strukturave shtetërore, shtetet mund të zgjedhin për t'i transferuar kompetencat në mënyrë që t'i plotësojnë kërkesat e caktuara, ku përfshihen:
- Përvijimi i kufijve krahinor;
- Transferimi i kompetencave në mënyrë asimetrike;
- Përcaktimi i asaj, se cilat kompetenca do të ushtrohen nga qeveria qendrore për të siguruar kornizën legjislative, dhe legjislacionin për harmonizimin e ligjeve lokale;
- Themelimi i institucioneve për mbarëvajtjen e bashkëpunimit ndërmjet qeverive qendrore dhe lokale;
- Përshtetimi i metodave për zgjidhjen e kundërshtive ndërmjet dy niveleve të qeverisë;
- Kufizimi i amendamenteve kushtetuese, që ndryshojnë marrëdhëniet qenësore ndërmjet qeverive qendrore dhe lokale.




SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi e kompetencave

- Transferimi asimetrik i kompetencave
- Disa shtete mund të zgjedhin kalimin jo-proporcional të sasisë së kompetencave një rajoni të caktuar.
- Kjo mund të merr formë të rregullimit të veçantë të autonomisë, me të cilën i garantohet një rajoni apo komune një status i caktuar.
- Theksohen kompetencat e rajonit për kontrollimin e çështjeve të veta, se sa të marrë pjesë në institucionet kombëtare.
- Në një federatë asimetrike, disa shtete mund t'i garantohen kompetenca të ndryshme, apo mund të kenë autonomi më të madhe se të tjerët.
- Kjo mund të arrijë në atë masë deri ku shtrihet zotësia për nënshkrimin e traktateve dhe angazhimin në tregun e jashtëm.
- Kjo po ashtu mund të përfshijë të drejtën e kuvendit lokal në nxjerrjen e ligjeve për të gjitha çështjet lidhur me çështjet lokale, duke u garantuar subjekteve qeverisje autonome vetanake në degët legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, dhe garantim të kompetencave të caktuara një rajoni gjatë periudës së tranzicionit, para se të përcaktohet statusi përfundimtar i atij rajoni.



SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi e kompetencave

- Kompetencat e ushtruara vetëm nga qeveria qendrore
- Në përgjithësi, kompetencat thelbësore të alokuara qeverisë qendrore përfshijnë:
- Shtërbimet e armatosura dhe siguria kombëtare
- Punët e jashtme,
- Politikën monetare, doganat dhe taksat doganore,
- Komunikimi,
- Transportin ndërrajonal,
- Menaxhimi i borxheve,
- Imigrimi dhe përshtatja,
- Menaxhimi i ekonomisë kombëtare.



SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi i kompetencave

- Kompetencat e ushtruara vetëm nga qeveritë krahinore
- Në përgjithësi kompetencat tipike të alokuara qeverisë lokale përfshijnë:
- Arsimin,
- Shtërbetësinë,
- Mirëqenien Sociale,
- Kompetencat policore,
- Tatimet vendore,
- Transportin rajonal,
- Ndonjëherë mbikëqyrjen e prejardhjes së pasurive natyrore, prodhimin dhe menaxhimin.





PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi i kompetencave

- Kalimi i kompetencave nga qeveritë qendrore dhe lokale
- Shëndetësia
- Mirëqenia
- Arsimi
- Banimi
- Transporti dhe rregulloret e trafikut
- Menaxhimi i mjedisit
- Policia dhe administrimi i burgjeve



PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi i kompetencave

- Procesi për qeveritë lokale rreth marrjes së kompetencave me kalimin e kohës
- Në kushtetutë mund të vendosen kriteret për përmbushje para ndarjes së ndonjë pushteti të caktuar siç është:
- Kërkesat lidhur me numrin e popullatës
- Pjekuria e administratës publike dhe infrastrukturës
- Shkalla e zhvillimit ekonomik dhe
- Caktimi i mundësive financiare.



PILPG

Zgjedhja e strukturës shtetërore-Kalimi i kompetencave

- Zgjidhja e kundërshtimeve ndërmjet qeverive qendrore dhe lokale
- S humë kushtetuta të pas konflikteve saktësojnë, që kundërshtitë ndërmjet qeverive qendrore dhe atyre lokale lidhur me aktivitetet kushtetutare, ligjet, kompetencat apo politikat e tjetrit mund të sillen në gjykatën kushtetuese për zgjidhje.



PILPG

Kalimi i kompetencave– S hqetësimet palestineze

- Shtetet i krijojnë kushtetutat, që pikësisht pasqyrojnë përvojat e tyre, duke përfshirë këtu druajtjet dhe shpresat.
- Konteksti rajonal arab është njëri prej autoriteteve ekzekutive posaçërisht të fuqishme me krahina të dobëta deri te ato joekzistuese, rajone, madje edhe ligjvënien.
- Historia e shkurtër palestineze e qeverisjes me pushtetin palestinez si një mjet administrimi të okupimit izraelitë është përfillur në masë të madhe të jetë me të meta, i degjeneruar dhe pa pushtete (checks and balances).
- Prandaj, kushtetuta palestineze parashikon sistem më të fortë parlamentar se sa normat në botën arabe.
- Autoriteti politikë lejohet, që të ushtrohet vetëm përmes kanaleve të qarta ligjore.



PILPG

Kalimi i kompetencave – S hqetësimet palestineze

- Neni 158: Ligji rregullon marrëdhënien ndërmjet qeverisë dhe njësive lokale, bazuar në decentralizimin administrativ. Njësitë e qeverisjes lokale gëzojnë individualitetin ligjor. Zgjidhen këshillat e tyre. Ligji merr masa për metodën e themelimit të tyre, formimin, zgjedhjen e këshillave, kompetencave dhe jurisdiksionin.



PILPG

Kalimi i kompetencave – shqetësimet palestineze

- Neni 109: Këshilli konsultativ krijohet, duke u mbështetur në këtë kushtetutë në përbërje të njëqind e pesëdhjetë anëtarëve; me individualitet të pavarur. I kushtohet kujdes formimit të pjesës së shpërndarjes së popullatës palestineze brenda Palestinës dhe jashtë saj. Ligji rregullon kushtet dhe metodat e zgjedhjes apo emërimit të anëtarëve të tij sipas vendeve ku ata jetojnë. Presidenti i shtetit lejohet t'i emëroj anëtarët e Këshillit konsultativ, të cilët nuk kanë nënshtetësi palestineze, nëse ata janë shquar për sigurimin e shërbimeve të veçanta çështjeve palestineze, me kusht që të mos tejkalohet numri prej dhjetë anëtarëve.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Kalimi i kompetencave – shqetësimet palestineze

- Neni 110: Këshilli konsultativ shqetësohet për:
 - Me studimin e çështjeve të përgjithshme strategjike dhe ofrimin e sugjerimeve lidhur me to.
 - Me dhënien e sugjerimeve për të gjitha çështjet lidhur me të drejtat kombëtare dhe integritetin e tokës palestineze dhe të drejtat e palestinezëve jashtë vendit.
 - Me diskutimin e amendamenteve kushtetuese dhe shprehjen e mendimit për ato, të cilat janë propozuar.
 - Sipas temave presidenti i shtetit i referohet Këshillit lidhur me politikën publike në çështjet arabe dhe ndërkombëtare për shtetin e Palestinës.
 - Me projekt ligjet të cilave presidenti i shtetit i referohet atyre, lidhur me palestinezët jashtë vendit.
 - Me cilët anëtarë të Këshillit konsultativ vendos t'i paraqet për diskutim në rendin e ditës.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

S strukturat e degës ekzekutive

- Kushtetuta:
 - Përkufizon strukturën e degës ekzekutive
 - Kompetencat dhe funksionet e degës ekzekutive
 - Rolin e kabinetit apo këshillit të ministrave
 - Zgjedhjen e presidentit/kryeministrit
 - Largimin e presidentit/kryeministrit
 - S strukturën e zyrës
 - Veçoritë e përshtatshme për punë në zyrë
 - Dhe marrjen e postit zyrtar

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

S strukturat e degës ekzekutive – tri modelet

- Presidencial – kryepolitikani ekzekutiv i qeverisë federale i zgjedhur drejtpërsëdrejti nga populli
 - Siguron ndarjen e kompetencave
 - Lejon shkallën e përgjegjësisë për vota
 - S hërben si një forcë unifikuese për shtetin, veçanërisht për ato me diversitet të rëndësishëm etnik apo gjuhësor.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

S struktura e degës ekzekutive – tri modelet

- S sistemi parlamentar – kryeministri shërben si kryeshef ekzekutiv i qeverisë parlamentare dhe kryesues i kabinetit. Popullata e zgjedh organin ligjvënës, dhe anasjelltas, ai e zgjedh kryeministrin.
 - Lehtëson përfshirjen e të gjitha grupeve brenda legjislaturës dhe ekzekutivit, ngase kabinetet zakonisht përbëhen nga anëtarët e legjislaturës së zgjedhur. Kjo veçanërisht është e dobishme në shtetet thellësisht të ndara.
 - Fleksibël, ngaqë koalicioni mund të formohet për të ndryshuar qeverinë në nivelin më të ulët të legjislaturës pa zgjedhje të përgjithshme dhe anasjelltas, mundëson mbajtjen e zgjedhjeve në çdo kohë me rritjen e përgjegjshmërisë.
 - Përgjegjshmëri, ngase kontrolli i publikut të gjerë dhe transparenca mbi procesin e politikë bërjes.
 - Më të qëndrueshme për demokracitë e reja – të shteteve, që fitojnë pavarësinë pas WWII, të gjitha vendet me demokraci të vazhdueshme kanë sisteme parlamentare.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

S strukturat e degës ekzekutive – tri modelet

- S sistemi i përzier presidencial/parlamentar – Presidenti zgjidhet drejtpërsëdrejti nga votuesit derisa kabineti del dhe i nënshtrohet besimit të legjislativit.
 - Përparësitë përfshijnë konsensus potencialisht më të madh, duke kërkuar që të dy krahët ekzekutivë të pajtohen para marrjes së ndonjë vendimi të rëndësishëm.
 - Por potenciali i madh për stagnim ndërmjet dy degëve ekzekutive.

SAI
STRATEGIC ASSESSMENTS INITIATIVE

PILPG

Sistemi i përzier – qasja palestineze

- Palestinezët duan ta balancojnë besimin tradicional mbi lidërshepin e fortë qendror me më shumë kërkesa demokratike të sistemit parlamentar.
- Neni 8: Sistemi politik palestinez do të jetë demokraci përfaqësues e parlamentare. Do të bazohet në pluralizëm politikë dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë qytetarëve. Këto përfshijnë të drejtën për të formuar parti politike dhe angazhim në aktivitete politike, pa diskriminim në baza të mendimit politikë, gjinisë apo religjionit. Partitë duhet t'i nënshtrohen parimeve të sovranitetit kombëtar, demokracisë dhe transferimit paqësor të kompetencave në përputhje me Kushtetutën.
- Neni 112: Presidenti i shtetit është presidenti i republikës. Ai mbron kushtetutën dhe unitetin e popullit, garanton vazhdimësinë e qëndrueshmërisë së shtetit, pavarësinë kombëtare dhe funksionimin e rregullt të autoriteteve publike. Ai i ushtron aftësitë dhe përgjegjësitë e veta, siç janë përkufizuar në pajtim me dispozitat e kushtetutës. Përveç kompetencave kushtetuese të mveshura presidentit të shtetit, kompetencat ekzekutive dhe administrative të qeverisë do të jenë në kompetencë të Këshillit të Ministrave.



PILPG

Përvijimi i legjislaturës

- Legjislatura është organi kryesor përfaqësues, që pasqyron vullnetin politik të njerëzve në nivel kombëtar.
 - Jep kompetencën për të përfaqësuar synimet dhe interesat e popullit
 - Propozon legjislacionin
 - Miraton legjislacionin



PILPG

Përvijimi i legjislaturës

- Përgjegjësitë kushtetuese të legjislaturës përfshijnë
 - Zgjedhjen e kryeministrit (në sistemin parlamentar apo të përzier/tërthor)
 - Kalimin e ligjeve dhe masave tjera administrative
 - Kalimin e amendamenteve kushtetuese
 - Marrjen e vendimeve mbi burimet dhe sasitë e të hyrave për funksionimin e institucioneve dhe obligimeve ndërkombëtare të shtetit
 - Miratimin e buxhetit për institucionet e shtetit
 - Ratifikimin e traktateve të nënshkuara nga kryeministri
 - Mbikëqyrjen e administrimit të qeverisë
 - Mbikëqyrjen e kompetencave rregullatore të qeverisë dhe ato shpenzuese



PILPG

Përvijimi i legjislaturës

- Njëdhomëshe
 - Më efikase dhe jo aq e shtrenjtë
 - Ndonëse, kërkon më shumë checks and balances për të siguruar që shumica nuk i mposht shqetësimet e pakicave.
- Dydhomëshe
 - Mënyra më efikase për kombinimin e përfaqësimit proporcional bëhet me njohjen e shqetësimeve të brendshme të qeverive lokale, rajoneve gjeografike, grupeve etnike dhe përfaqësimit në ultë të zonës elektorale.
 - Lejon shtetin si territor në tërësi dhe tërësi individuale apo rajon të përfaqësohen njëkohësisht në procesin legjislativ.



PILPG

Përvijimi i legjislaturës

- Rrënim i legjislaturës
 - Nën rrethana ekstreme si e tillë gjendja e jashtëzakonshme
 - E lidhur me votat e mosbesimit
 - Kur legjislatura nuk i plotëson përgjegjësitë e përcaktuara me kushtetutë apo ligj
- Imuniteti legjislativ
 - Dispozitat për mbrojtje dhe imunitet të anëtarëve
 - Duke përfshirë garancionet për lirinë e të folurit legjislativ
 - Imuniteti nga detyrimi ligjor derisa gjendeni në zyre



PILPG

Legjislatura në kontekstin palestinez


- Njëdhomëshe "Këshilli i përfaqësuesve"
 - Neni 65: Këshilli i përfaqësuesve ushtron autoritetin legjislativ. Ai krijon të gjitha politikat e përgjithshme të shtetit dhe buxhetin në përgjithësi, që përgatitet nga Këshilli i Ministrave. Ushtron mbikëqyrje mbi veprimet e degës ekzekutive në mënyrën e saktësuar me Kushtetutë.
 - Neni 66: Këshilli i përfaqësuesve përbëhet prej 150 deputetëve, që përfaqësojnë popullin palestinez. Ata zgjidhen sipas dispozitave të kushtetutës dhe ligjit mbi zgjedhjet. E mërimi për anëtarësim në dhomën e deputetëve duhet të jetë në pajtim me dispozitat e shpallura në këtë kushtetutë dhe në ligjin mbi zgjedhjet. Kushdo, që e drejton Këshillin e përfaqësuesve duhet të jetë palestinez, dhe nuk lejohet pas zgjedhjes së tij të ketë nënshtetësi të shtetit tjetër.



PILPG

Legjislatura në kontekstin palestinez


- Kufizimet
 - Neni 67: Anëtarët e Këshillit të Përfaqësuesve zgjidhen në periode prej pesë viteve. Një anëtarë mund të rizgjidhet më shumë se njëherë. Nuk lejohet që të zgjatet afati i Këshillit të Përfaqësuesve, përveç në rast domosdoshmërie dhe për arsye të miratimit të ndonjë ligji nga Këshilli i përfaqësuesve, nga dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve
 - Neni 70: Këshilli i përfaqësuesve, në mbledhjen e tij të parë të çdo seance vjetore zgjedh folësin, dy zëvendës folës dhe sekretarin e përgjithshëm, duke përbërë Presidiumin e Këshillit të përfaqësuesve. Anëtarit të Presidiumit të Këshillit nuk i lejohet të pretendoj për ndonjë pozitë në qeveri apo ministri. Anëtarit i Këshillit të përfaqësuesve mund të marr ndonjë pozitë në ministri me kusht që numri i përgjithshëm i anëtarëve, që shërbejnë si ministra në qeveri nuk është më i lartë se gjysma e numrit të përgjithshëm të ministrave.



PILPG

Legjislatura në kontekstin palestinez

- Shpërbërja
 - Neni 88: Nëse presidenti i shtetit apo kryeministri, në rast nevoje i sugjeron Këshillit të Ministrave shpërbërjen e Këshillit të Përfaqësuesve, atëherë kjo shpërbërje mund të miratohet nga dy të tretat shumicë të anëtarëve të saj, dhe presidenti e lëshon vendimin për shpërbërje. Qeveria i bën thirrje votuesve të bëjnë zgjedhjen e Këshillit të ri të përfaqësuesve në periodën jo më pak se gjashtëdhjetë ditë, në pajtim me procedurat e saktësuara me ligjin mbi zgjedhjet. Nëse zgjedhja nuk bëhet gjatë periodës së përcaktuar, atëherë Këshilli duhet t'i ushtroj detyrat e veta derisa të bëhet zgjedhja e Këshillit të ri. Këshillit të shpërbërë nuk i lejohet të humbë besimin nga qeveria. Sipas Kushtetutës, nuk lejohet të bëhet shpërbërja e Këshillit të Përfaqësuesve gjatë vitit të parë kur është formuar, apo gjatë periodës së gjendjes së jashtëzakonshme.



PILPG

Legjislatura në kontekstin palestinez


- Shpërbërja
 - Neni 89: Qeveria bën thirrje për zgjedhjen e Këshillit të Përfaqësuesve brenda gjashtëdhjetë ditëve para përfundimit të afatit të ligjshëm, në pajtim me procedurat e rregulluara me ligj. Nëse qeveria nuk ia del t'i mbaj zgjedhjet brenda periodës së dhënë, folësi i Këshillit të Përfaqësuesve mund të bëjë kërkesë, që rendi i Gjykatës Kushtetuese të bëjë thirrje për zgjedhje. Nëse zgjedhjet nuk mund të mbahen në kohën e caktuar shkaku i luftës, apo rrezikut të pashmangshëm të luftës, apo rrethimit, i cili parandalon funksionimin e rregullt të organeve kushtetuese, Këshilli i Përfaqësuesve do të vazhdon t'i kryej detyrat e tij, derisa të mund të mbahen zgjedhjet brenda gjashtëdhjetë ditëve të mbarimit të pengesave.



PILPG

Krijimi i gjyqësorit

- Të gjitha kushtetutat e pas konfliktit krijojnë një funksionim të pavarur të gjyqësorit për mbështetjen e kushtetutës dhe zbatimin e ligjeve të shtetit.
- Dispozitat për funksionimin dhe strukturën e gjyqësorit përfshijnë:
 - Kompetencat dhe funksionet
 - Pavarësinë gjyqësore
 - Autoritetin gjyqësor
 - Strukturën e gjyqësorit
 - Administratën e gjyqësorit



PILPG

Krijimi i gjyqësorit


- Gjyqësori i pavarur kërkon
 - Ndarjen e gjyqësorit nga degët tjera të qeverisë
 - Krijimin e këshillit gjyqësor për mbikëqyrjen e gjyqësisë dhe gjyqtarëve, si dhe administrimin në mënyrë efikase dhe të pavarur.
- Synimet e një gjyqësori të pavarur përfshijnë
 - Mbrojtjen e të drejtave të njeriut
 - Avancimin e stabilitetit politik
 - Krijimin e një ekonomie të mirëfilltë
 - Sigurimin e drejtësisë së barabartë



PILPG

Krijimi i gjyqësorit

- Kushtetutat zakonisht parashohin kur vendimet gjyqësore janë të detyrueshme ndaj degëve tjera të qeverisë.
- shpjegojnë jurisdikcionin e çdo gjykate, individi, institucioni apo agjencitë kanë qëndrime për të parashtruar raste në gjykata të ndryshme
- sigurojnë rolet e gjykatave të veta
- saktësojnë se si gjykatat punojnë së bashku me organet tjera qeveritare dhe agjencitë, përfshirë këtu se si lejohet legjislatura të krijoj gjykata të specializuara.



PILPG

Krijimi i gjyqësorit

- Struktura e gjyqësorit
 - Disa kushtetuta parashikojnë krijimin e gjykatave të specializuara
 - Disa ia lënë legjislaturës krijimin e gjykatave, ndryshe nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese
 - Kjo përfshin rolin dhe përgjegjësinë e gjykatave
 - Ekzistimin e gjykatave kombëtare, lokale dhe krahinore
 - Pavarësinë e gjykatave nga agjencitë tjera qeveritare, organizatat dhe individët
 - Efektin detyrues i vendimeve të gjykatës
 - Hollësitë e disa apo të gjitha gjykatave
 - E drejta për të lëshuar vendime për të drejtën civile dhe penale dhe për të rishikuar vendimet administrative.
 - Nevoja për një gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur



PILPG

Krijimi i gjyqësorit

- Gjykata Kushtetuese
 - Është vendimtare për sigurimin e pavarësisë ligjore dhe sigurimin e mekanizmit për mbështetje dhe zbatim të kushtetutës.
 - Ka përgjegjësi për të vendosur për
 - Kushtetutshmërinë e akteve legislative dhe ekzekutive
 - Moszbatimin e kushtetutës
 - Çështjet e diskutueshme kushtetuese
 - Amendamentet kushtetuese



PILPG

Krijimi i gjyqësisë

- Gjykata Supreme
 - Vepron si gjykata më e lartë apeluese e shtetit
 - Bën shpallje pa gjykatën kushtetuese, gjithashtu delegon rishikim kushtetues të Gjykatës Supreme
 - Vendimet në përgjithësi janë të prera dhe të detyrueshme ndaj agjencive, subjekteve qeveritare dhe individëve



PILPG

Krijimi i gjyqësorit në kuadër të kushtetutës palestineze

- Neni 159: Dega e gjyqësorit është e pavarur. Ka jurisdiksion të mirëfilltë për të kryer funksionin ligjor dhe marrje të vendimeve mbi të gjitha çështjet e diskutueshme dhe rastet e krimeve. Ligji përcakton institucionet e degës së gjyqësorit dhe rregullon strukturën e tyre. Përcakton llojet e gjykatave, nivelin e tyre, jurisdiksionin dhe procedurat. Nuk mund të formohen gjykata të veçanta.
- Neni 16: Këshilli Supreme për Gjyqësor autorizohet për çështjet e institucioneve gjyqësore. Ligji përcakton formimin dhe kompetencat e tij, duke ia siguruar pavarësinë dhe garantimin e barazisë në kornizën e bashkëpunimit me autoritetet tjera publike. Kërkohet marrja e mendimit të tij në projektligje për rregullimin e çështjeve të gjyqësorit. Ka të krijuar rregulloren e brendshme.



PILPG

Krijimi i gjyqësorit në kuadër të kushtetutës palestineze

- Neni 170: Gjykata për anulim është ndërtuar me jurisdiksion mbi apelet në çështjet penale dhe civile. Metoda e formimit të saj, jurisdiksioni dhe procedurat në veprim janë të përcaktuara me ligj.
- Neni 171: Gjykata e lartë e drejtësisë është e themeluar me jurisdiksion për të marrë vendime mbi çështjet e diskutueshme administrative dhe rastet për çështje disiplinore siç janë të përcaktuara nga ligji i hartuar, që rregullon bazën e veprimit, kushtet e emërimit të gjyqtarëve dhe punëtorëve, dhe procedurat që duhet të ndiqen paraprakisht. Krijimi i gjykatave të ulëta administrative lejohet me ligj.



PILPG

Krijimi i gjyqësorit në kuadër të kushtetutës palestineze

- Neni 178: Gjykata Kushtetuese krijohet për arsye, që kushtetuta ta ushroj jurisdiksionin e saj në mënyrë të pavarur, dhe ta mbroj ligjshmërinë e institucioneve shtetërore. Ajo përbëhet prej nëntë gjyqtarëve, të emëruar nga kreu i shtetit, me nominim të Këshillit të Ministrave dhe të miratuar nga Këshilli i Përfaqësuesve. Gjykata cakton rregulloren e brendshme, e cila organizon procedurat e saj të punës. Gjyqtarët emërohen për një afat prej nëntë vitesh, kohëzgjatje kjo, që nuk ripërtërihet apo zgjatet.

KUSHTETUTA E KOSOVËS

1. Roli i kushtetutës.
 - a. Kufizimi i kompetencave.
 - b. Procedurat a amandamentimit.
 - c. Dispozitat që nuk mund të amandamentohen.
 - d. Garantimi i të drejtave të njeriut. Konventa Evropiane e Të Drejtave të Njeriut. Nevoja për avancimin e të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me mbrojtjen e minoriteteve në arsim, punësim dhe për zhvillimin religjioz dhe kulturor të tyre.
2. PARIMI I NDARJES SË KOMPETENCAVE. Në shoqëritë e ndara, modeli i Uestminstrit nuk funksionon. Zor se mund të bëhet alternimi i kompetencave.

MIRËPO - ndarja e kompetencave nuk është panace.

RREZIQET E NDARJES SË KOMPETENCAVE.

- a. Përforcimi i dispozitave.
- b. Rreziku nga bllokimi.
- c. Mungesa e opozitës dhe hapësira shumë e vogël për zgjedhje demokratike.

Ndarja e kompetencave si formë e TRANZICIONIT.

STRUKTURA E QEVERISË.

3. Legjislatura.
 - a. Metoda e zgjedhjeve. Shih shënimin e ndarë.
 - b. Marrëdhënia me ekzekutivin: Ideja e qeverisë së përgjegjshme. Alternativat e qeverisë së përgjegjshme. Shembujt e Austrisë dhe Irlandës Veriore.
 - c. Roli i komisioneve.
 - d. Mbrojtja e minoriteteve. Shumicat e ngarkuara/ vetot e minoriteteve. Procedurat e ziles alarmuese. Shembulli i Belgjikës.
 - e. Dispozitat për shpërbërjen e legjislaturës.
4. Ekzekutivi.
 - a. Roli i presidentit. 'Super-presidenti'? Shembulli i Nelson Mandelës. Roli i udhëheqësisë. Presidenca e dyfishtë me kërkesën për veprim të përbashkët për çështjet fundamentale?
 - b. Roli i miratimit të komuniteteve të kryqëzuara dhe proporcionaliteti në emërimet ekzekutive. Shembujt e Austrisë dhe Irlandës Veriore.
 - c. Parimet e përgjegjësisë së Kabinetit.
5. Shërbimi gjyqësor dhe publik.
 - a. Parimet e PAANSHMËRISË dhe PROPORCIONALITETIT.
 - b. Emërimi i gjykatësve nëpërmjet procesit të paanshëm dhe jopolitik. Komisioni për Emërimet Gjyqësore. Mirësjellja gjatë periudhës së shërbimit. Politikanët nuk do të jenë në gjendje t'i shkarkojnë ata.
 - c. Emërimi i shërbyesve civilë dhe i zyrtarëve publikë me anë të procesit të paanshëm dhe jopolitik. Komisioni i Shërbimit Civil. Komisioni për Emërimet Publike.
6. Parimi i decentralizimit. Mirëpo, duhet të kombinohet me parimin që përfiton dhe ngarkon duhet të varet nga nevoja e jo nga gjeografia. Komunitetet kulturore dhe linguistike. Shembujt e Belgjikës dhe Estonisë. Ideja e federalizmit personal. Ideali i AUTONOMISË GRUPORE në kuadër të një kornizë kombëtare të të drejtave dhe detyrave.
7. Lidhjet me vendet tjera pa kompromentuar parimin e sovranitetit. Shembulli i Këshillit Verior/Jugor, që lidhë Irlandën Veriore që mbetet pjesë e Britanisë së Madhe, ndërsa Irlanda vend i ndarë. Të kërkohet bashkëpunimi me anë të marrëveshjes derisa në të njëjtën kohë respektohen identitetet e kombeve të ndryshme

Pavarësia e gjyqësorit

Tryeza e rrumbullakët parlamentare
mbi çështjet kushtetuese

Definicioni i kushtetutës

- Ligje themelore; strukturë themelore e qeverisjes
- Kushtetutshmëri demokratike
- Liri individuale
- Të drejtat e bashkësive
- Pushtet i kufizuar i qeverisjes

Të drejtat individuale karshi mendimi të shumicës

- Kush vendosë?
- Gjyqësor i fuqishëm dhe i pavarur
- Të drejtat e njeriut kanë përparësi ndaj vërejtjeve (kundërshtimeve) të shumicës

Sundimi i ligjit

- Gjykata të fuqishme, të pavarura
- Autoritet
- Resurse
- Prestigj
- Të mbahen të përgjegjshëm zyrtarët shtetëror ndaj ligjeve the rregulloreve

Pavarësia gjyqësore

- Aspektet individuale dhe aspektet institucionale:
- Gjyqtarët individë duhet të jenë të pavarur
- Gjyqtarët si trup, duhet të jenë të lirë nga çdo ndikim nga organet tjera shtetërore.

Si të sigurohet pavarësia

- Kryesisht duke i mbajtur pagat dhe postet e gjyqtarëve të paprekura nga fuqitë e jashtme.
- Mbajtja e funksionit gjatë "sjelljes së mirë"
- Fuqizohet siguria në paga dhe pozita.

Cilat janë obligimet e gjyqtarëve?

- Pa anshmëri, personale ose tjetër
- Integritet i plotë
- Sjellje etike
- Shtimi i mundësisë së zgjedhjes për gjyqtarë është fundamentale.
- Të përgatitur juridikisht, me integritet të plotë
- Nga shtresa të ndryshme të popullatës

Rezoluta e KB 40/32 dhe 40/146 1985

- Përvoja e nxjerrë shumë-kulturore
- Garantuar nga shteti dhe paraparë në kushtetutë
- Detyra e organeve tjera për respektimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Nenet 2 & 3

- Vendosja e çështjeve në mënyrë objektive dhe pa kufizime, ndikime ose ndërhyrje
- Autorizime ekskluzive për të vendosur se çfarë bie në kuadër të kompetencës gjyqësore

Neni 4

- Pa ndërhyrje të paarsyeshme në procesin gjyqësor, pa revizion të vendimeve gjyqësore.
- Rezervimi i rishqyrtimit gjyqësor dhe ndërmjetësimit ose zëvendësimit.

Nenet 5, 6 & 7

- Mbrojtja e kompetencës gjyqësore
- Pavarësia e gjyqësorit kërkon që gjyqtarët ta zbatojnë procedurën në mënyrë të drejtë dhe duke i respektuar të drejtat e palëve.
- Shtetet të sigurojnë mjetet adekuate për gjyqësorin në kryerjen e funksioneve të veta.

Çështjet tjera

- Liria e shprehjes, bashkimit dhe tubimit
- Standardet në përzgjedhjen e gjyqtarëve, përzgjedhje mos të jetë në duart e qeverisë dhe administratës

Kushtet e shërbimit

- Mandati
- Pavarësia, dhe siguria, shpërblimi, pensionimi, moshë e pensionimit
- Sigurohen në mënyrë adekuate me ligj.

Shkarkimi nga detyra/disiplina

- Të parashikohet procedura ligjore definitive për shkarkimet disiplinore.
- Procedimi i kërkesave me shpejtësi dhe në mënyrë korrekte

Siguria financiare, promovimi, imuniteti

- Pa dallime në shpërblim dhe beneficione gjatë mandatit.
- Promovimi i bazuar në faktorët objektiv
- Imuniteti personal. Vendimi mbi arrestimin të merret nga organi gjyqësor.

Resurset

- Gjyqtarët të mbrohen nga ndikimi i pjesëve tjera të pushtetit
- Financim adekuat, punësim dhe shkarkim i personelit gjyqësor, nxitje dhe organizim i informatave.

Gjatë mandatit gjyqësor

- Të mirëmbahet besimi publik
- Pasi të emërohen gjyqtarët, ata t'u përmbahen në mënyrë rigorozë standardeve etike. Ose përmes vet-rregullimit ose përmes respektimit të kodit
- Pa perceptime të pikëpamjeve politike, pa korrupsion, dhe tipare jo etike

Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore

- Gjashtë vlerat themelore
- Pavarësia,
- Paanësia
- Integriteti,
- Zotësia,
- Barazia
- Kompetenca

Korniza kushtetuese

- Mënyra më e mirë nuk është e gdhendur në gur.
- Vendosja e gjërave në kontekst dhe në perspektivë
- Perceptimi i tanishëm
- Aspekti i Bashkimit Evropian.

Përfshirjet e propozuara për kushtetutën e re

- Pavarësia e gjyqësorit
- Ndarja e pushteteve
- Ekuilibrimi i pushteteve
- Detyra specifike për secilën degë dhe për gjyqtarë.

Përfaqësimi

- Nevoja për bashkëbisedues
- Ministria e Drejtësisë, këshilli gjyqësor, etj.
- Dega e pavarur duhet ta përfaqësojë vetveten.

Gjykatat Kushtetuese

- Rishqyrtimi i legjislacionit dhe akteve ekzekutive.
- Përzgjedhja e gjyqtarëve të rëndësishë themelore
- Ideale do të ishte, që shqyrtimi gjyqësor të bëhet nga gjykatat e rregullta ose nga gjyqtarët e emëruar rregullisht.

Papërshtatshmëria

- Lidhjet personale ose profesionale
- Aktivitetet komerciale
- Zakonisht, pagesat për punën akademike, artistike.

Transparenca

- Transparenca financiare mund të ndihmojë rritjen e shkallës së përgjegjshmërisë
- Transparenca është esenciale



Administrata gjyqësore

- Gjyqësia duhet të menaxhojë vetë resurset vetjake.
- Shpeshherë si problem paraqitet përgjegjësia buxhetore
- Procedurat transparente.

Tryezë e Rrumbullakët e OSBE-së mbi Çështjet Kushtetuese

Gjyqësori

Fredrik Majkëll Lorenc JD, LLM

Grupi për të Drejtën Publike Ndërkombëtare dhe Politika

Pushteti dhe funksionet

- Gjyqet do të sigurojnë drejtësi njëloj për të gjithë. Ato do të përkujdesen për mbrojtjen e interesave legjitime të gjithë qytetarëve, individëve, entiteteve legale, dhe shtetit.
- Gjyqet do të jenë përgjegjëse për administrimin e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën si dhe statutet, normat dhe ligjet e obligueshme ndërkombëtare.

Struktura e Gjyqësorit

- Pushteti gjyqësor realizohet përmes dispozitave kushtetuese apo legjislacionit kushtetues.
- Opsioni i 1-rë: **Gjyqet do të përbëhen nga [shënimi emrat e gjyqeve].**
- Opsioni 2-të: **Gjykatat do të përbëhen nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata Supreme, dhe gjykatat e tjera, si ato të çarkut, komunale dhe gjykatat për kundërvajtje, që parashihen me ligj.**

Gjykata Supreme

- **Gjykata Supreme do të jetë instanca më e lartë e ankesave në shtet, ndaj dhe ankesat ndaj gjykatave të tjera, përfshirë këtu edhe gjykatat e specializuara do të jenë nën jurisdiksion (autoritetin) e kësaj gjykate.**

Gjykata Kushtetuese

- "Gjykatat nuk e kanë as pushtetin e forcës e as të ndalimit të financimit, prandaj, meqë për këto çështje ato varen nga mbështetja e publikut, sidomos në vitet e para, duhet të kenë kujdes, dhe të mos ia ulin autoritetin vetes, duke u marrë me çështje, të cilat mund të zgjidhen shumë më mirë nga institucionet e tjera."
- **Prof. Herman Shvarc, Shkolla Juridike Amerikane**

Austria

- Kushtetuta e Austrisë ishte e para në botë që ka rregulluar me ligj (në vitin 1920), kontrollin nga ana e gjyqësorit, që më vonë u njoh me emrin "sistemi austriak". Sipas këtij sistemi ekziston një gjykatë e veçantë kushtetuese e cila merret me shqyrtimin dhe verifikimin e kushtetutshmërinë së ligjeve. Së këndejmi, shumë vende të Evropës e kanë pranuar sistemin austriak pas Luftës së Dytë Botërore.

Përvoja e Latvisë

- Programi për çmimin (Ciceron 2005) për gjyqet e reja (moderne), është fokusuar në transparencë, seancat e hapura gjyqësore dhe fushatën mbi marrëdhëniet me publikun, gjë që ka ndihmuar në bindjen e qytetarëve se gjyqi është duke punuar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre.

Latvia (vazhdimi)

- "Roli i Gjykatës Kushtetuese është i dobishëm dhe i domosdoshëm sidomos gjatë periudhës së tranzicionit politik në disa vende të vogla, ku disa gjëra duhet t'i bëjnë më ndryshe në krahasim me Gjykatën Kushtetuese Gjermane (tradicionale)"

Znj. Gjintra PEDEZE, Këshilltare e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Latvisë

Kushtetuta lituaneze

■ KAPITULLI I VIII GJYKATA KUSHTETUSE

Neni 102

Gjykata kushtetuese do të vendosë lidhur me atë nëse ligjet apo aktet e tjera të Seimas (Kuvendit) janë në kundërshtim me Kushtetutën si dhe nëse dekretet e Presidentit të Republikës dhe të



Pavarësia e gjyqësorit

- Gjyqësia e [emri i shtetit] do të jetë autonome dhe e pavarur.
- Gjyqtarët do të jenë autonomë, të pavarur dhe do të veprojnë vetëm në përputhje me ligjin.

Pavarësia gjyqësore

Tri herë në historinë e Amerikës, shumica dominante politike e ka sfiduar haptazi pushtetin dhe pavarësinë e Gjykatës Supreme të SHBA-ve si institucion:

- 1805 Mosbesimi i Ndjekjes Gjyqësore
- 1868 propozoi ligjin për kufizimin e jurisdiksionit të Gjykatës Supreme
- Plani "Court-packing" i Franklin Ruzveltit në vitin 1937.

Pavarësia Gjyqësore

- "Se deri në çfarë shkalle do të ruhet pavarësia gjyqësore do të varet në njëfarë mase nga respekti i publikut ndaj gjyqësorit. Kultivimi i këtij respekti dhe përmbajtja apo ruajtja e vullnetit të mirë të publikut, pa iu nënshtruar opinionit publik mbetet një sfidë për gjyqësinë federale.
- Kryetari i Gjykatës Supreme të SHBA-ve Uilliam H. Renkuist Mars 2004

Ngjarjet në SHBA

- Kongresi u përpoq ta zhvesh Gjykatën Supreme të SHBA –ve nga juridiksioni për të proceduar me rastin e Hamdan kundër Rumsfeld, kur u fuqizua Akti mbi Trajtimin e të Burgosurve në dhjetor 2005 duke cituar "asnjë gjykatë, drejtësi, apo gjykatës" nuk ka juridiksion t'i dëgjoj kërkesat e caktuara të parashtruara nga ana e të arrestuarve në gjirin Guantánamo.

Pavarësia gjyqësore

- Institucionet e shtetit dhe organet administrative duhet t'i binden vendimeve të gjyqit; këto subjekte nuk duhet t'i ndryshojnë as vendimet e gjykatës e as ta vonojnë ekzekutimin e tyre.

Mandati: Opcionet

- Gjykatësit e Gjykatës Supreme duhet të zgjidhen në afat prej [X] viteve dhe mund të zgjidhen përsëri në zyre. Mandati i gjykatësve të gjykatave tjera duhet të përcaktohet me ligj.
- Këshilli Gjyqësor duhet të ketë përgjegjësinë për disiplinën dhe largimin e gjykatësve [sipas ligjit].
- Gjykatësit mund të shkarkohen, suspendohen, transferohen ose pensionohen vetëm në bazë, dhe si subjekt garancioni sipas ligjit.
- Gjykatësi duhet të lirohet nga detyra, vetëm nëse është shpallur fajtor për ndonjë krim, që ia pamundëson kryerjen e funksionit të tij, [ose] nëse ai shpallet i paaftë përgjithmonë për ta kryer funksionin, [ose ndonjë arsye tjetër e përcaktuar me ligj].

Zgjedhja e gjykatësve: Tri opsione

Opsioni 1: Zgjedhja me bashkëpunim

- Gjykata [Supreme/kushtetuese /të tjera] përbëhet nga [9] gjykatës. Kryetari duhet t'i zgjedh [3] prej gjykatësve. Kuvendi duhet t'i zgjedh [3] prej gjykatësve dhe Këshilli Gjyqësor duhet t'i zgjedh [3] prej gjykatësve për gjykatën [Supreme /Kushtetuese/të tjera].

Opsioni 2: Sistemi pluralist

- Gjykatësit e Gjykatave duhet të zgjidhen nga kryetari dhe të miratohen nga [2/3] e deputetëve të Parlamentit [dhe Këshillit Gjyqësor].

Opsioni 3: Sistemi me shumicë votash

- Gjykatësit e gjykatave duhet të zgjidhen me [2/3] e deputetëve të Parlamentit [dhe të miratohet nga Këshilli Gjyqësor].

Paanshmëria

- Gjykatat e të drejtës duhet të jenë autonome dhe të pavarura nga çdo organ, autoritet, zyre, grup individësh, apo individ.
- Gjatë mandatit të tyre, gjykatësit nuk duhet të mbajnë ndonjë zyre publike apo të angazhohen në ndonjë shërbim tjetër apo profesion, që nuk parashihet me ligj për të mos qenë në mospajtim me funksionin gjyqësor.

Kualifikimet dhe diversiteti

- Gjykatësit e të gjitha gjykatave duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Ata duhet të jenë juristë të shquar të karakterit të lartë moral, me kualifikime adekuate, përfshirë këtu edhe arsimimin e lartë në drejtësi. Anëtarësimi i gjyqësorit duhet të pasqyroj diversitetin e njerëzve.

Tryeza e Rrumbullakët e Parlamentarëve dhe Ekspertëve Kosovarë për Çështjet Kushtetuese

Përfshirja e të drejtave të njeriut në Kushtetutë

Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë

20-22 korrik 2006

Shkup, IRJ e Maqedonisë

Të drejtat e njeriut janë pjesë e kushtetutës.

Ndaj, përfshirja e tyre në Kushtetutë është *conditio sine qua non*.

Organizimi i institucioneve në çdo Kushtetutë për të ushtruar pushtetin si – pushtete të veçanta- bëhet për një qëllim të veçantë- për të garantuar respektimin e të drejtave njerëzore/ individuale. Pikërisht për këtë arsye kushtetuta miratohet- këtu është qëllimi dhe justifikimi i saj. Deklarata e të Drejtave të Njeriut, e miratuar në gusht të vitit 1789, nga Asambleja Nationale e Francës pos të tjerash vë në dukje se një shoqëri e cila nuk ka ndarje të pushteteve dhe që nuk i mbron të drejtat e individit, nuk ka kushtetutë /neni 16/; me fjalë të tjera, ndarja e pushteteve dhe të drejtat e njeriut shkojnë së bashku dhe ato përbëjnë dy komponente të domosdoshme për një Kushtetutë. Kjo deklaratë është një njohje zyrtare e vlerave të individit.

Në Kushtetutë të drejtat njerëzore bëhen të drejta elementare

Të drejtave elementare u obligohen autoritetet publike.

Të drejtat elementare dhe kushtetuese shpeshherë përdoren si sinonime. Ndërsa, në ditët e sotme nocioni i – të drejtave elementare- është zgjeruar si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga aplikimi i tij – madje i ka tejkaluar kufijtë e shteteve dhe është në gati një parim (institucion) të ligjit të Bashkësisë Evropiane me Kartën mbi të Drejtat Elementare të Bashkimit Evropian.

Të drejtat elementare i obligojnë legjislativin, ekzekutivin dhe degën e gjyqësorit që këto të drejta t-i zbatojnë drejtpërsëdrejti si ligje. Së këndejmi, autoritetet publike janë të obliguara që t-i mbrojnë ato- të gjitha ligjet (aktet) e autoriteteve duhet t-i respektojnë të drejtat elementare dhe të mos ndërhyjnë në këtë sferë, përpos në raste të veçanta kur një gjë e tillë përlligjet me shkaqe kushtetuese. Në qoftë se të drejtat e individit, të proklamuar në Kushtetutë, shkelen, atëherë ka të drejtë individi, të cilit i janë shkelur të drejtat ka të drejtë të kërkojë eliminimin e kësaj shkeljeje, respektivisht ka të drejtë për dëmshpërblim dhe kompensim. Ndërsa, ekzekutimi i kërkesave të tilla është detyrë e ligjvënësve.

Të drejtat elementare paraqesin formën e përshtatshme, përmes së cilës midis individëve dhe shoqërisë bëhet një këmbim i vlerave që janë të rëndësishme vitale për të dyja palët. Të drejtat elementare i përforcojnë gjykimet e vlerave kushtetuese që e avancojnë mbrojtjen e të drejtave individuale. Në të drejtat elementare përfshihen ato parime dhe norma që janë të domosdoshme për mirëqenien normale të individit si person ose si qytetar. Ato strukturojnë marrëdhënie, pa të cilat përmbushja e nevojave të një personi, nga njëra anë, dhe përshtatja e tyre me interesat publike, nga ana tjetër, do të ishte e paimagjinueshme. Megjithatë, realizimi i të drejtave elementare është i mundshëm vetëm aty ku shteti e një kapacitetin individual të secilit person.

Natyra e të drejtave elementare:

- të drejtat subjektive /në ligjin- sferën publik-e /.
- vlerat objektive;

Në fakt, njohja e të drejtave elementare si burim i të drejtave subjektive individuale në të drejtën publike është arritur pasi është kaluar një rrugë e gjatë dhe përmes shumë zhvillimeve historike, duke filluar nga programet dhe parimet për ushtrimin e pushtetit politik dhe duke vazhduar deri te zbatimi i të drejtës së subjekteve për ankesë kundër autoriteteve publike, fillimisht vetëm kundër ekzekutivit. Vetë agjenda e krijimit të shoqërisë civile është mbështetur në ndërtimin e të drejtave elementare, të cilat gradualisht u shpërfaqën dhe –shndërruan- në të drejta subjektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të secilit person. Paraqitja e të drejtave sociale në kushtetutat moderne dhe përfshirja e tyre në katalogun e të drejtave elementare si të drejta subjektive shënoi një përpjekje, që përmes garancive kushtetuese, të mbulohet edhe funksionimi social i shtetit. Natyra e të drejtave elementare si të drejta subjektive e justifikon kuptimin e tyre parësor/ specifik- qëllimi i të drejtave elementare është që para së gjithash ta mbrojnë individin dhe të drejtat e tij/ saj, që të jetë i lirë nga ndërhyrjet e autoriteteve publike.

Justifikimi i të drejtës subjektive përfshihet në një normë të rendit legal/ në rastin tonë, një dispozitë kushtetuese lidhur me të drejtat elementare/, që mund ta përlligjë qoftë drejtpërsëdrejti apo edhe përmes një veprimi ligjor një pretendë/ kërkesë të një qytetari të caktuar. Prandaj, norma legale mund të shërbejë si bazë për interesat individuale të qytetarëve, në mënyrë që qytetari, si bartës i të drejtës, të mund të kërkojë nga autoritetet publike dhe personave (palëve) -të treta- respektimin e të drejtave. Kapaciteti i të drejtave elementare të qytetarëve si burim i të drejtave subjektive në të drejtën publike është më i rëndësishmi për nga natyra.

Të drejtat elementare kanë po ashtu edhe një domethënie tjetër, po aq të rëndësishme në aspektin e kuptimit "objektiv": ato janë parime objektive të rendit ligjor kushtetues, dhe njëherësh edhe të rendit të përgjithshëm ligjor.

Çfarë mbrohet me Kushtetutë? – thelbi i të drejtave elementare.

Dy parime lidhur me esencën e të drejtave elementare:

- liria;
- pjesëmarrja/involvimi.

Rrjedhimisht, kemi dy kategori kryesore

- të drejtat mbrojtëse/negative;
- të drejtat pjesëmarrëse/ pozitive

Meqë të dy kategoritë e të drejtave janë të ndryshme për nga natyra, ato gëzojnë mbrojtje të ndryshme.

Cilat të drejta njerëzore të shpallen si të drejta elementare në Kushtetutë?

Së pari, të drejtat për mbrojtje që merren me mbrojtjen e të drejtave private të individëve ndaj autoriteteve publike. Së dyti, domsdoshmërisht të drejtat për pjesëmarrje/ shoqërore.

Fillimisht, ndryshimet kushtetuese, të nxitura nga të drejtat e natyrshme, kanë treguar mirëkuptim ndaj sigurimit të lirisë për ankesën e individit ndaj autoriteteve publike. Të drejtat religjioze, e drejta e lirisë së shprehjes, mbrojtja e pronës dhe liritë tjera duhet të sigurojnë hapësirë dhe mundësi për të gjithë që të kenë mundësi të marrin vendime dhe veprime individualisht, - të lirë nga shteti. Ndaj dhe funksioni i kushtetutës sa i përket të drejtave elementare ka qenë kryesisht “mbrojtës” d.m.th. kufizimet para autoriteteve publike. Madje, edhe tani ky funksion dhe kjo specifikë e të drejtave elementare si të drejta të mbrojtjes/ Abwehrrechte- dt., droits-resistances-fr./ është shumë me rëndësi dhe ka dimensione të reja – p.sh. pacenueshmëria e të dhënave personale dhe e regjimit të tyre.

Aspekti tjetër mbështetet në teorinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në të arriturat e shtetit. Kjo ide është drejtpërdrejt e ndërlidhur me nocionin mbi shtetin social dhe doktrinën ligjore gjermane. Pjesëmarrja do të thotë e drejta e secilit për të marrë pjesë në vendimmarrje, duke bërë të mundur kësajsoj ndikimin e të drejtave dhe interesave të individëve të caktuar. Në këtë kuptim pjesëmarrja është një element i shtetit demokratik dhe të drejtave të njeriut /Teilhaberechte-dt., droits-exigences-fr./ ku përfshihen të drejtat për të dalur ne zgjedhje, liria për të krijuar shoqata dhe kuvende etj. Megjithatë, lidhja ndërmjet përfshirjes dhe shtetit social shtrihet në domenin e përfshirjes në të arriturat ekonomike dhe sociale të shtetit dhe shoqërisë. Qëllimi këtu nuk është që të mbrohet individi nga përzjerja e autoriteteve publike, por që të kërkojë një hisë, një pjesë të të arriturave – të sukseseve të arritura të shtetit. Për këtë arsye ato të drejta quhen të drejta të pjesëmarrjes, të drejta pozitive- ato kanë të bëjnë me kërkesën për të marrë pjesë të arriturat, duke konsideruar arritjen e sukseseve si diçka të përbashkët. Këto të drejta mund të ushtrohen vetëm nëse ndërmer masa të caktuara dhe siguron atë që nevojitet për të krijuar, në radhë të parë kushte ekonomike për realizimin e të atyre të drejtave sociale. Këto të drejta pranohen më mirë si të drejta elementare sociale- e drejta për punë, e drejta për pushim, etj.

Nocionet e të drejtës për mbrojtje dhe për pjesëmarrje, që në Gjykatën Kushtetuese të Bullgarisë paraqesin po ashtu të drejtë precendentale kanë një bazë dhe natyrë të ndryshme nga ato dy grupe të të drejtave elementare, që edhe pasqyrojnë mekanizmat e ndryshme të mbrojtjes të tyre. Meqë ra fjala, ky dallim e rritë të kuptuarin e gjerë, kryesisht në ideologjinë ligjore amerikane, se të drejtat pjesëmarrëse nuk janë fundamentale për nga natyra dhe nuk janë të barabarta me të drejtat/liritë klasike. Argumentet në vijim janë dhënë për shkak të kësaj: së pari financiare: të drejtat e tilla sociale mund të ushtrohen vetëm nëse i kemi kapacitetet përkatëse ekonomike; së dyti, procedurale: shumë të drejta sociale nuk mund të definojnë qartazi, prandaj në parim nuk janë mbrojtëse d.m.th. ushtrimi i tyre nuk garantohet me anë të mbrojtjes gjyqësore. Aty ku teoria juridike influencohet nga ato qëndrime, ekziston një hierarki në të drejtat elementare të qytetarëve: të drejtat e justifikueshme shihen si klasike dhe më të larta për nga rangu sesa të drejtat sociale. Ky kuptim, po ashtu, rekomandon se të drejtat sociale duhet të jenë të diferencuara nga të drejtat elementare dhe se duhet të vendosen në norma kushtetuese të cilat i rregullojnë qëllimet kryesore të shtetit ose direktivat programore ndaj ligjvënësve.

Megjithatë, teoria moderne juridike në masë të madhe e përkrah qëndrimin se të drejtat sociale janë në masë të barabartë fundamentale. Kjo mbështetet nga deklarata se preferenca ndaj njërit lloj të të drejtave ose tjetrit është një zgjedhje politike, rezultatet e së cilës do të mund të ishin fatale madje edhe për vlerat e mbrojtura nga vet Kushtetuta.

Një shembull indikativ është liria e mendimit ose e drejta/liria e të shprehurit si e drejtë klasike individuale: ka për qëllim që secilit t’i sigurojë mundësinë për t’u zhvilluar si person dhe për të grumbulluar njohuri në mjedisin natyror dhe social të tij ose saj; theksi i njëanshëm në natyrën e justifikueshme të kësaj të drejte nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e këtij qëllimi – ditëve të sotme, shpërndarja e informatave është një industri masive; shumë veprime ndërmerren nga shteti në mënyrë që liria e të menduarit të mund të mbrohet si duhet d.m.th. e drejta për informim mbështetet nga obligimi në anën e shtetit për sigurimin e informatave të nevojshme.

Në fakt, ky shembull i ilustron përpjekjet e praktikës moderne kushtetuese për tejkalimin e kundërshtisë së brenda qenësishme ndërmjet “të drejtave mbrojtëse” dhe “të drejtat pjesëmarrëse/sociale”. Zgjidhja kërkohet përmes gjetjes së përgjigjes në pyetjen çfarë do të duhej të ishin parimet dhe vlerat e shoqërisë: vetëm “individualizmi, liberalizmi dhe barazia para ligjit” apo edhe “solidariteti, demokracia dhe mundësitë e barabarta”?

Që të dyja kategoritë u takojnë një Kushtetute moderne me mekanizma të duhura të implementimit dhe përforcimit.

II. TË DREJTAT MINORITARE

Termi.

Termi përfshin dy koncepte të ndara:

- të drejtat individuale të secilit pjesëtarë, qoftë minoritet racor, etnik, religjioz, gjuhësor, kulturor ose seksual;
- të drejtat kolektive që u takojnë një grupi të caktuar minoritar.up.

Mbrojtja minoritare

Nocion i së drejtës ndërkombëtare. Hapat e parë në kohërat moderne janë bërë në vitin 1815 gjatë Kongresit të Vjenës. Pas Luftës së Parë Botërore mbrojtja minoritare bazohej në marrëveshjet bilaterale. Pas Luftës së Dytë Botërore në baza multilaterale; në fillim është futur si shtesë e Deklaratës Universale të vitit 1948 për ta përfshirë këtë çështje specifike. Më vonë pasoi një zhvillim dinamik në kornizën e OKB-së: 1966, Konventa e OKB-së për të drejtat civile dhe politike;

Nën-komisioni për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e minoriteteve.

U caktuan obligimet për autoritetet publike për mos pengimin e grupeve minoritare në ushtrimin e gjuhës amtare, religjionit dhe kulturës së tyre.

Po ashtu, në kuadër të Këshillit të Evropës u zhvillua një rregullim intensiv i të drejtës ndërkombëtare, posaçërisht pas ndryshimeve demokratike në Evropën Qendrore dhe Lindore:

1990 Standardet e Kopenhagës për dimensionet humane;

1991 Takimi i ekspertëve në Gjenevë;

1991 Drafti i Komisionit të Venedikut për një konventë Evropiane për mbrojtjen e minoriteteve;

1992 Karta Evropiane për gjuhët minoritare dhe rajonale;

1995 Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare.

Kështu, mbrojtja minoritare sipas Konventës kornizë përfshin jo vetëm gjuhën, kulturën, religjionin dhe traditat, por edhe arsimin, mediat, etj.

Ligji kombëtar/ligji kushtetues në dekadat e fundit paraqet një larmi rregulloresh, disa prej tyre shumë të detajuara – për ish-Kushtetutën e Sllovakisë. Në të njëjtën kohën ligji modern kushtetues paraqet edhe fleksibilitet: disa kushtetuta i shpallin të drejtat elementare, që i mbrojnë grupet minoritare pa ato që e kanë statusin e minoritetit kombëtar /Bullgaria/.

Përmbyllje: E drejta ndërkombëtare dhe ligji kushtetues u kanë caktuar autoriteteve publike obligime pozitive për mbrojtjen e grupeve minoritare nëse janë të pranishme kriteret objektive dhe nëse do të manifestohen kriteret e subjekteve.

Rekomandime

Meqë, nuk ka ndonjë model universal të mbrojtjes së minoriteteve, të drejtat e grupeve minoritare duhet të shpallen në Kushtetutë në të dyja rastet: "me" ose "pa" status minoritar, në mënyrë që të drejtat individuale të mund të ushtrohen në bashkësi.

Të sigurohet Ombudspersoni për minoritete me anë të Kushtetutës si një mbrojtje speciale e përforcuar.

Sigurimi i të drejtave elementare në Kushtetutë pa marrë parasysh çfarë është origjina etnike, përkatësia religjioze ose gjuhësore, paraqet një pjesë të garancive për një qëndrueshmëri dhe stabilitet të gjatë në Kosovë.

III. Mekanizmat e implementimit dhe të përforcimit për të drejtat elementare

- Mbrojtja e brendshme-parimi i proporcionalitetit;
- Mbrojtja e jashtme:
- Rruga për në gjykatë gjithnjë duhet të jetë e lirë.
- Kontrolli për kushtetutshmëri/duke përfshirë edhe ankesat individuale kushtetuese?/
- Ombudspersoni/at/rrjeti?/
- Mekanizmat supranacionalë.

Të drejtat elementare, me shpresë edhe mekanizmat mbrojtës, u takojnë krijimit të një sistemi ligjor dhe administrate funksionuese, të një shoqërie civile, çka do të thotë- ato u takojnë konceptit të sundimit të ligjit.

Të drejtat elementare dhe sundimi i ligjit përfaqësojnë një hap kyç drejt të ardhmes evropiane të Kosovës.

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Ronald Hugimstra
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Hyrje:

Ligji për të drejtat e njeriut është ligj ndërkombëtarë

Prandaj:

Për t'i përfshirë të drejtat njerëzore, në Kushtetutë njëherësh do të duhej të përfshihej edhe ligji ndërkombëtarë

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Traktatet kryesisht përmbajnë dhe mbështeten në ligjin ndërkombëtar

ÇFARË ËSHTË TRAKTATI?

Marrëveshje midis shtetesh

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

SI HYN NË FUQI TRAKTATI?

1. Nënshkrimi
2. Ratifikimi (Miratimi)
3. Shpallja

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Traktatet për të drejtat njerëzore përbëhen nga tri pjesë:

- | | |
|---------------------------|--|
| 1. Preambula= | 1. PËRSE palët janë dakorduar për të rregulluar një çështje |
| 2. Dispozitat kryesore = | 2. ÇFARË janë marrë vesh palët për të rregulluar |
| 3. Dispozitat operative = | 3. SI janë marrë vesh palët për ta zbatuar marrëveshjen |

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

DY NIVELE OBLIGIMESH:

1. Ndaj shteteve të tjera
2. Brenda shtetit

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

DY LLOJE OBLIGIMESH:

1. Sigurimin e të drejtave njerëzore
2. Zbatimin e të drejtave njerëzore

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Shembull për obligimin e 1-rë:

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Elementare Njerëzore (ECHR)

Neni 1

Palët e marrëveshura, brenda jurisdiksionit të tyre, do t'i sigurojnë të gjitha të drejtat dhe liritë ashtu si është parashikuar në Seksionin (Pjesën) e 1-rë të kësaj Konvente.

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Shembull për obligimin e 2-të:

ECHR

Neni 13

Çdo personi që i janë shkelur të drejtat dhe liritë njerëzore, ashtu si është përshkruar në këtë Konventë, do të ketë mundësi dhe mjete efikase që ti mbrojnë të drejtat përmes autoriteteve shtetërore, pavarësisht nëse kjo shkelje është bërë nga ndonjë person që mban post zyrtar.

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Me fjalë të tjera shteti do të duhej:

Ti respektojë të drejtat e njeriut

dhe

Të ndërhyjë për ta përmirësuar situatën nëse gjërat nuk shkojnë mirë

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Së këndejmi, Kushtetuta do të duhej të:

- Përcaktojë statusin e traktateve në kuadër të rendit juridik shtetëror
- Përcaktojë se si hyjnë në fuqi traktatet në rendin juridik shtetëror
- Sqarojë marrëdhëniet e ligjit të traktatit me Kushtetutën, dhe me ligjin shtetëror
- Përcaktojë obligimet e autoriteteve shtetërore për mbrojtjen e të drejtave njerëzore në legjislacion, me rastin e marrjes së vendimeve si dhe gjatë veprimeve të ndryshme
- Përcaktojë se si do të zgjidhen, përmes procedurave ligjore, rastet e shkeljes të të drejtave njerëzore; dhe në rastin ideal
- Specifikojë mënyrën se si do të sigurojnë autoritetet shtetërore që shkeljet, sapo të tejkalohen, të mos përsëriten më (reagimi)

Të drejtat njerëzore dhe ligji kushtetues

Dy raste të veçanta

1. Holanda
2. Anglia

Holanda

Holanda është Monarki Kushtetuese

Ka Kushtetutën dhe një rol të rezervuar për Mbretin
Mbreti është Sovran

Roli i Mbretit në këtë Monarki në përgjithësi mund të thuhet se është i barasvlershëm me rolin e një Presidenti të Republikës

Holanda

LISTA E TË DREJTAVE

Kushtetuta e Holandës fillon me një listë të drejtash dhe lirish elementare të të gjithë qytetarëve të Holandës. Kjo listë përfshinë 23 dispozita të veçanta, të cilat mbulojnë një mori të drejtash, që në përgjithësi i ngjasojnë Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948.

Holanda

STATUSI I TRAKTATEVE

Neni 91

1. Mbretëria nuk është e obliguar t'i respektojë traktatet, por traktatet nuk mund t'i refuzojë pa miratimin e Parlamentit.
2. Në rast se traktati përbanë dispozita që janë në kundërshtim me Kushtetutën, apo të cilat kërkojnë ndryshime në Kushtetutë, atëherë Parlamenti mund të bëjë ndryshime, por vetëm nëse ato miratohen nga shumica prej dy të tretave.

Holanda

HYRJA NË FUQI

Neni 93

Dispozitat e traktateve dhe vendimet e organizatave publike ndërkombëtare që, sipas përmbajtjes së tyre, mund të jetë të obligueshme për të gjithë, bëhen të obligueshme vetëm atëherë kur të jenë bërë publike.
(Dispozitat e traktateve dhe vendimet e vetë-zbatueshme të organizatave publike ndërkombëtare e kanë fuqinë e ligjit.)

Holanda

HYRJA NË FUQI

Neni 95

Ligji parashikon rregulla mbi atë se si bëhen publike traktatet dhe vendimet e organizatave ndërkombëtare publike.

Holanda

MARRËDHËNIET ME LIGJIN VENDOR

Neni 94

Dispozitat ligjore të Mbretërisë që janë fuqi nuk mund të zbatohen nëse zbatimi i tyre nuk është në pajtim me dispozitat e traktateve dhe vendimeve të vetë-zbatueshme të organizatave publike ndërkombëtare.

Holanda

OBLIGIMET PËR TË MBROJTUR?

Neni 73

1. Këshilli i Shtetit do të konsultohet jo vetëm për propozimet ligjore dhe hartimin e rregulloreve, por edhe për propozimet për miratimin e traktateve nga ana e Parlamentit.

(Shqyrtimin e legjislacionit primar edhe subsidiar për të vërtetuar pajtueshmërinë e tij me obligimet që dalin nga traktati, Kushtetuta dhe ligjet e tjera në fuqi)

Holanda

MJETET LIGJORE?

Neni 120

Gjyqet nuk merren me shqyrtimin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe traktateve.

Mirëpo, nëse shqyrtimi bëhet në lidhje me nenin 94, gjyqet megjithatë mund të shqyrtojnë zbatimin e dispozitave ligjore për rastet që i adresohen për të verifikuar pajtueshmërisë me dispozitat e traktateve dhe vendimeve të vetë-zbatueshme.

Anglia

Anglia është Monarki Kushtetuese
Ka një Kushtetutë të qartë
Parlamenti është Sovran

Kjo do të thotë se asnjë ligj nuk mund të jetë më i vlefshëm se sa Ligji (Akti) i Parlamentit

Anglia

STATUSI I TRAKTATEVE

Meqë Parlamenti është Sovran, atëherë traktati që ratifikohet nga Parlamenti e obligon Anglinë në raportet e këtij shteti me vendet e tjera.

Së këtëjmi, asnjë traktat nuk mund të ketë ndikim në rendin juridik të brendshëm të vendit para se traktati të shndërrohet në Ligj të Parlamentit.

Anglia

PËRFSHIRJA E TRAKTATEVE

Traktatet për të drejtat e njeriut kanë fuqi morale në rendin e brendshëm juridik, por jo edhe fuqi ligjore.

Në vitin 1998, Parlamenti e ka përfshirë ECHR-në në kuadër të rendit të brendshëm juridik përmes

Aktit për të Drejtat e Njeriut 1998

Anglia

AKTI I TË DREJTAVE NJERËZORE 1998

Në Aktin e të drejtave njerëzore përsëriten të gjitha të drejtat e parashikuar në ECHR dhe njëherësh përcaktohen procedurat përmes të cilave këto të drejta mund të vihen në jetë në kuadër të rendit të brendshëm juridik si dhe gjatë veprimeve publike dhe procedurave gjyqësore.

Anglia

RAPORTET ME LIGJIN VENDOR

Seksioni 3(1)

Për aq sa është e mundur, legjislacion primar dhe dispozitat nënligjore duhet të shqyrtohen dhe miratohen në pajtim me të drejtat e Konventës.

Anglia

MARRËDHËNIET ME LIGJIN VENDOR

MEGJITHATË:

Seksioni 3(2)(b)

Kjo pjesë nuk ka ndikim në vlefshmërinë, vazhdimësinë e funksionimit apo zbatimin e çfarëdo legjislacioni primar, që nuk është kompatibil.

Anglia

OBLIGIMI PËR MBROJTJE – 1

Seksioni 6

- (1) Është e paligjshme që një autoritet publik të veprojë dhe të sillët në kundërshtim me të drejtat e Konventës.
- (2) Nëseksion (1) nuk aplikohet ndaj një ligji nëse, për shkak të apo më tepër dispozitave, autoritet, nuk kanë mundur të veprojnë ndryshe.

Anglia

OBLIGIMI PËR MBROJTJE – 2

Seksioni 19

- (1)(a) Ministri i Mbretërisë që është përgjegjës për një Ligj në akëcilën Dhomë të Parlamentit duhet të deklarojë se sipas mendimit të tij dispozitat e Ligjit janë në pajtim me të drejtat e Konventës.

Anglia

MJETET LIGJORE- 1

Seksioni 7

- (1)(a) Personi i cili pretendon që autoritetet publike kanë vepruar (apo që beson se kanë vepruar) në aso mënyre që sipas Seksionit 6 (1) konsiderohet e paligjshme, ka të drejtë të hapë procedurë gjyqësore kundër autoriteteve sipas këtij Akti (Ligji) në një gjykatë apo tribunal të caktuar.

Anglia

MJETET LIGJORE- 2

Seksioni 8

Kur kemi të bëjmë me veprimeve të autoriteteve publike [...] për të cilat gjykata konsideron se janë [...] të paligjshme, atëherë gjykata mund të japë apo të sigurojë aso ndihme apo mjetesh, apo të lëshojë aso urdhëri, brenda kompetencave të saj, për të cilin konsideron se është i drejtë dhe adekuat.

Anglia

MJETET LIGJORE– 3

Seksioni 4

(2) Nëse gjyqi është dakord se dispozitat [e legjislacionit primar] nuk përputhen me të drejtat e Konventës, atëherë mund të bëjë një deklaratë lidhur me këtë papajtueshmëri.

Anglia

REAGIM– 1

Seksioni 5

(1) Në rastet kur gjyqi konstaton se ka papajtueshmëri, Mbretëria ka të drejtë të veprojë në pajtim me vendimet e gjyqit.

Anglia

REAGIM– 2

Seksioni 10

[nëse është konstatuar se një dispozitë ligjore është inkompatibile me të drejtën e Konventës]

(2) Nëse një ministër i Mbretërisë konsideron se ekzistojnë arsye që hapë procedurë lidhur me këtë seksion, atëherë ai mundet që me urdhër të bëjë ndryshime në ligj me qëllim që t'i shmangë mospërputhjet.

Të drejtat njerëzore dhe ligji ndërkombëtar

LISTA E KONTROLLIT

- ✓ Statusi i traktateve
- ✓ Hyrja në fuqi
- ✓ Raportet me ligjin vendor
- ✓ Obligimi për mbrojtjen e të drejtave njerëzore
- ✓ Mjetet ligjore kundër shkeljeve
- ✓ Mekanizmi i reagimit për t'i parandaluar shkeljet në të ardhmen

Zgjedhjet dhe kushtetuta: Gjetja e baraspeshës dhe ndërtimi i mirëbesimit

- Falënderimi për OSBE-në, veçanërisht për Perin, Franklinin, Blerimin dhe Jenniferin. Ndjesë përkthyesve për shkak se flas shpejtë!
- Fillimisht, është e rëndësishme të theksoj se zgjedhjet nuk e bëjnë demokracinë, e cila është një varg i vlerave, institucioneve dhe praktikave. Megjithatë, zgjedhjet demokratike nuk janë të mundura pa i respektuar të drejtat e njeriut, e në veçanti lirinë e shprehjes dhe të shtypit, lirinë e lëvizjes brenda vendit, lirinë e tubimeve dhe lirinë e asociimit.
- Por si mundet që kushtetuta të mbrojë dhe të kujdeset për procesin demokratik si dhe të ndërtojë mirëbesimin dhe legjitimitetin në procesin zgjedhor? Kur shikohet procesi i zgjedhor brenda procesit kushtetues, është me rëndësi të gjendet baraspesha ndërmjet parimeve dhe rregullave të rrënjosura në kushtetutë dhe mundësimin e fleksibilitetit dhe përgjegjshmërisë që i mundësojnë ligjet dhe rregulloret. Po ashtu më duhet të vë në dukje se Kosova tanimë e ka të shkruar një kornizë të fortë të ligjit të zgjedhjeve.

Çka duhet të përmbajë kushtetuta?

- Dy burime: Manuali i Hartuesve të Kushtetutës Post-Konfliktuale dhe Kodi i Praktikave të Mira i Komisionit të Venedikut për Çështjet e Zgjedhjeve. Të dyjat janë burime të shkëlqyeshme. Manuali i hartuesve përfshinë:
 1. Llojet e sistemeve zgjedhore
 2. Metodatat e ndarjes së zonave zgjedhore
 3. Mekanizmat për përfaqësimin e pakicave dhe të grave
 4. Procedurën për zgjedhjet në degët legjislativë dhe ato ekzekutive
 5. Të drejtën e votuesve për të votuar, dhe
 6. Rolin e organeve menaxhese të zgjedhjeve.

Zgjedhjet në kontekstin kushtetues

- Proceset zgjedhore janë komplekse, aktivitete të standardizuara që kërkojnë përkufizime ligjore të qarta, të thjeshta dhe relativisht gjithëpërfshirëse për të promovuar konsistencë, barazi dhe kuptim të gjërë të kornizës së zgjedhjeve nga të gjithë personat e përfshirë në zgjedhje, thotë IFES-i.
- Kushtetutat i trajtojnë çështjet e zgjedhjeve në mënyra të ndryshme në varësi nga kërkesat e veçanta të vendit. Dispozitat zgjedhore mund të jenë në formë të një kapitulli të veçantë ose të neneve në kushtetutë, ndërsa të tjerë çështjen e vëjnë në kontekst të zgjedhjeve për degët ekzekutive dhe ato legjislativë.

Korniza ligjore e zgjedhjeve

- Korniza ligjore e zgjedhjeve të një vendi gjithashtu duhet të specifikojë kërkesën për një organ për menaxhimin e zgjedhjeve (OMZ). Mënyra se si vepron OMZ-ja mund të përcaktohet me shumë instrumente të llojeve të ndryshme, përfshirë traktatet ndërkombëtare, kushtetutën, ligjet dhe rregulloret nacionale dhe rajonale.
- Traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare ofrojnë një kornizë e cila mund të përdoret për të definuar dhe vlerësuar kornizën zgjedhore të një vendi: Dokumenti i Kopenhagës, KNDKP, KEDNJ.
- Ekziston një trend drejt definimit të çështjeve kyçe të zgjedhjeve në kushtetutë, të cilat mund të ofrojnë një mënyrë funksionale për të rrënjosur normat e zgjedhjeve kundër manipulimeve të partisë në pushtet. Po ashtu, rregullimet zgjedhore mund të definojnë edhe në ligjet dhe rregullat nacionale.
- Ligji zgjedhor i një vendi mund të jetë një ligj i vetëm ose disa ligje të cilët natyrisht duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. OMZ-ja ose dega ekzekutive e qeverisë mund të zhvillojnë rregulloret të cilat e mundësojnë plotësimin e zbrastësirave në ligj; zakonisht këto i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Për të krijuar mirëbesim në procesin e zgjedhjeve, është me rëndësi që të gjitha pjesët e kornizës zgjedhore – nga traktatet e deri te rregulloret – të diskutohen dhe çdonjëri që është i përfshirë në proces të ketë qasje të lirë në to.
- Duhet të gjendet një baraspeshë ndërmjet sigurimit të një kornize ligjore konsekuente dhe të parashikueshme, krahas mundësimin të OMZ-së për të pasur fleksibilitet për t'u përgjigjur ndaj ndryshimeve të rrethanave politike. Më e rëndësishmja është që masa e detajeve në kushtetutë ose në ligje statutare të jetë në funksion të mirëbesimit që pjesëmarrësit kanë në sistem.

Kushtetuta

- Një numër gjithnjë në rritje i vendeve po i përfshijnë dispozitat zgjedhore në kushtetutat e tyre, shpesh duke u përqëndruar në formimin e organeve menaxhuese të zgjedhjeve. Disa vende i formojnë OMZ-të si organe kushtetuese, siç janë:
 1. Bangladeshi
 2. Kosta Rica

3. Figji
 4. Gana
 5. India
 6. Indonezia
 7. Iraku dhe
 8. Uruguai
- Vënja e dispozitave zgjedhore në kushtetutë do të thotë se ato nuk mund të ndryshohen aq lehtë sikurse ligjet, dhe zakonisht kushtetutat kanë pengesa shumë të mëdha për t'i ndryshuar. Bariera që rrënjosja kushtetuese u imponon partive në pushtet mund t'u japë grupeve opozitare ndjenjën e një mbrojtje më të madhe. Në anën tjetër, kjo rrënjosje ia vështirëson më shumë sistemit zgjedhor përshtatjen ndaj ndryshimeve.
 - Disa dispozita zgjedhore të cilat shpesh përfshihen nëpër kushtetuta përfshijnë si vijon:
 1. Pavarësinë e OMZ-së
 2. Përbërjen e OMZ-së
 3. Mandatin e OMZ-së
 4. Autorizimet dhe funksionet e OMZ-së
 5. Të drejtën e votës ose kualifikimet për regjistrimin e votuesve
 6. Të drejtat e partive politike
 7. Autoriteti ose parametrat për përcaktimin e kufijve
 8. Sistemet për zgjedhjet presidenciale
 9. Sistemet e zgjedhjeve nacionale legjislative
 10. Të drejtat ose kualifikimet për të kandiduar
 11. Orari i zgjedhjeve ose datat përfundimtare dhe
 12. Mekanizmat për kontestimin e zgjedhjeve
 - Përfundimisht, ajo që është brenda kushtetutës ose pjesë e ligjeve dhe rregulloreve varet nga rrethanat lokale dhe ndryshon gjerësisht. Për shembull,
 1. Kushtetuta e Austrisë përcakton anëtarësinë e OMZ-së, të drejtën e votimit, rolin e Gjykatës Kushtetuese në kontestet e zgjedhjeve si dhe sistemin e zgjedhjeve;
 2. Bangladeshi definojnë autorizimet, pavarësinë dhe funksionet e OMZ-së, të drejtën e votimit, kualifikimet e kandidatëve dhe afatet përfundimtare për caktimin e datave të zgjedhjeve;
 3. Kushtetuta e Kamerunit i trajton të drejtat e partive politike, kualifikimet e kandidatëve, afatet përfundimtare për datën e zgjedhjeve si dhe autorizimet e Gjykatës Supreme dhe të Këshillit Kushtetues për t'i zgjidhur kontestet që kanë të bëjnë me zgjedhjet;
 4. Kosta Rika ka përcaktuar pavarësinë, anëtarësinë dhe funksionet e OMZ-së si dhe trajton të drejtën e votimit, të drejtat e partive politike (përfshirë financimin nga qeveria), sistemet zgjedhore dhe kualifikimin e kandidatëve;
 5. Kushtetuta e Republikës Çeke definojnë të drejtën e votimit, sistemin zgjedhor dhe afatin përfundimtar të datës së zgjedhjeve;
 6. Gana e trajton të drejtën e votimit, themelon OMZ-në, të drejtën për të formuar ose për t'iu bashkuar një partie politike dhe përcaktimin e kufijve të zonave zgjedhore;
 7. Kushtetuta e Indisë themelon OMZ-në, definojnë të drejtën e votimit dhe listën e votuesve, i pengon gjykatat nga ndërhyrja në çështjet e zgjedhjeve dhe rezervon vende për "kastat" dhe "fiset" në Shtëpinë e Popullit;
 8. Madagaskari përcakton të drejtat për të kandiduar, sistemin zgjedhor për Senatën dhe Presidencën si dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në zgjedhje dhe në kontestet e zgjedhjeve.
 9. Kushtetuta e Namibisë i përkufizon kualifikimet dhe procedurat për zgjedhjet presidenciale; dhe
 10. Kushtetuta e Perusë themelon institucione të ndryshme që kolektivisht e kryejnë punën e një OMZ-je dhe i definojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe institucioneve të tjera.
 - Ndërsa futja e shumë dispozitave zgjedhore në kushtetutë do të ishte një mënyrë për ta ndërtuar besimin dhe legjitimitetin në procesin e përgjithshëm, ekzistojnë mangësi të qarta nëse futen shumë detaje. Korniza zgjedhore vështirë se mund të ndryshohet ose ndryshimi mund të marrë shumë kohë.
 - Shkalla deri në të cilën dispozitat zgjedhore përfshihen në një kushtetutë në mënyrë të konsiderueshme varet nga niveli i besimit në administratën e zgjedhjeve të një vendi. Në shumë demokraci të konsoliduara, ku ekziston nivel i lartë i besimit në administratën ligjvënëse dhe atë publike, në kushtetutë nuk përmendet konstituimi i OMZ-së.
 - Prapëseprapë në botë është gjë e zakonshme që të ketë OMZ të pavarura dhe të fuqishme, të cilat mbështeten nga kornizat e sofistikuar dhe të detajuara ligjore të cilat përfshijnë dispozita zgjedhore kyçe në kushtetutë. Kjo praktikë e nxit besimin e bartësve kryesorë në procesin e zgjedhjeve.

Përtej kushtetutës: Ligjet dhe rregulloret e zgjedhjeve

- Në vend që themelimi i një OMZ-je të vendoset në kushtetutë, OMZ-ja mund të themelohet me statut. Vendet si Mbretëria e Bashkuar (e cila nuk ka kushtetutë të shkruar), Australia, Burkina Faso dhe Kanadaja i kanë themeluar OMZ-të e tyre në tërësi me ligj.
- Legjislacioni i tillë duhet të definojë statusin e OMZ-ve nacionale dhe/ose çdo OMZ-je tjetër plotësuese, duke përfshirë përgjegjësitë, kompetencat dhe funksionet. Ligji po ashtu duhet të ofrojë një kornizë të qartë dhe mjaft të detajuar për të siguruar besimin dhe efikasitetin, të cilat do të përfshinin:
 1. Emërimin e anëtarëve dhe të personelit të OMZ-së, si dhe mandatin e tyre;
 2. Çështjet e menaxhimit operativ që kanë të bëjnë me regjistrimin e votuesve, regjistrimin e partive politike dhe të kandidatëve, fushatat politike, edukimin e votuesve, transparencën e OMZ-së, votimin, numërimin e votave, dhe shpalljen e rezultateve;
 3. Çështjet e menaxhimit financiar dhe të mjeteve themelore; dhe
 4. Shkeljet në zgjedhje dhe zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.
- Çështjet e tjera të cilat po ashtu mund të përfshihen këtu janë edhe përcaktimi i kufijve, kodet e sjelljeve për anëtarët dhe personelin e OMZ-së, për partitë politike, mediat dhe vëzhguesit e zgjedhjeve.
- Përsëri, ekziston një baraspeshim i duhur ndërmjet tepër shumë hollësive dhe tepër pak syresh që duhet të gjendet. Nëse ka tepër shumë hollësi në legjislacion, kjo mund të ketë si rrjedhojë një OMZ që nuk do të jetë në gjendje t'u përgjigjet sfidave dhe zhvillimeve të reja. Një shembull i mirë i kësaj do të mund të ishte votimi elektronik ose ndryshimi i organizimit të OMZ-së.

Ndarja në zona zgjedhore

- Në përgjithësi në kushtetuta specifikohet sistemi i zgjedhjeve si sistem me një zonë zgjedhore ose sistem me shumë zona zgjedhore; shtetet duhet të vendosin se sa përfaqësues do të zgjedhen nga secila zonë zgjedhore. Shtetet duhet të shqyrtojnë mënyrën e përcaktimit të kufijve të zonave zgjedhore – ato mund të vizatohen nga kufijt ekzistues ose mund të konfigurohen të rinj.
- Shembulli i rindarjes në zona zgjedhore të Teksasit

Mekanizmat për pakicat

- Shumë shtete në kushtetuta e tyre përfshijnë mekanizma për të siguruar përfaqësimin e pakicave, siç janë vendet e ndara ose kushte të caktuara për partitë sa u përket pakicave. Vendet e ndara janë vende të rezervuara për pakicat etnike dhe religjioze. Kushtet për partitë parashohin që të gjitha partitë politike në radhët e veta duhet të përfshijnë kandidatë nga grupet e ndryshme etnike ose fetare.
- Kodi i Praktikave të Mira i Komisionit të Venedikut i Korrikut 2002, vë në dukje se rregullat e posaçme që u garantojnë pakicave vende të rezervuara (ose që sigurojnë përjashtime nga ndarja e zakonshme e vendeve – për shembull, lirimi nga kushti i kuorumit) nuk janë në kundërshtim me idenë e të drejtës së barabartë për votim. Po ashtu kodi vë në dukje se as kandidatët, e as votuesit nuk duhet të detyrohen të bëjnë publike përkatësinë e tyre si pjesëtarë të një pakice kombëtare, ndërkaq aty theksohet se informimi për votuesit duhet të vihet në dispozicion në gjuhën lokale të pakicës.

Gender Provisions

- Po ashtu shtetet mund të përcaktohen për vende të ndara (të rezervuara) ose kushte të caktuara ndaj partive sa u përket femrave. Në Kodin e Praktikave të Mira të Komisionit të Venedikut po ashtu thuhet se rregullat ligjore me të cilat kërkohet përqindja minimale e personave të secilës gjini në mesin e kandidatëve nuk duhet të konsiderohet si diçka në kundërshtim me parimet e të drejtës së barabartë për votim nëse ato kanë bazë kushtetuese.

Procedura për zgjedhjen e legjislaturës dhe të ekzekutivit

- Po ashtu mund të ketë dispozita për legjislaturën: legjislatura mund të jetë organ njëdhomësh, që promovon efikasitetin dhe unitetin. Në shtetet me legjislaturë dydhomëshe, dhoma e parë zakonisht u shërben interesave të tërë shtetit, ndërsa dhoma e dytë mund t'i përfaqësojë rajonet, krahinat dhe interesat ose njësitë e tjera. Në kushtetuta mund të përfshihen edhe dispozitat përkitazi me zgjedhjen e ekzekutivit, duke përfshirë zotësinë juridike, kohëzgjatjen e mandatit, kërkesat për nominim dhe rizgjedhje, si dhe përqindjen e votave të nevojshme për të fituar zgjedhjet.

E drejta e votës dhe e drejta për të qenë kandidat

- Kodi i Praktikave të Mira i Komisionit të Venedikut për Çështje të Zgjedhjeve, i nxjerrë në Tetor të vitit 2002 përvijon “parimet e themelore të Trashëgimisë Evropiane në fushën e Zgjedhjeve.” Ky është një burim i dobishëm sa u përket standardeve

kushtetuese. Komisioni i Venedikut përvijon pesë parimet: e drejta (universale) për votim - të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.

- E drejta universale e votimit në parim do të thotë se të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtën e votës dhe të drejtën e kandidimit në zgjedhje. Kjo e drejtë mund dhe në të vërtetë duhet t'u nënshtrohet kushteve të caktuara: mosha, përkatësia kombëtare, vendbanimi, si dhe heqja e të drejtës së votës ose mundësisë për të qenë i zgjedhur.
- Nga aspekti procedural, Komisioni i Venedikut, thekson se kjo do të thotë se listat e votuesve duhet të jenë të sakta, të publikohen, të jenë të azhuruara, si dhe të ketë mekanizma për zgjidhjen e kontesteve. Po ashtu Komisioni vë në dukje se një pjesë e të drejtës universale për votim përfshin edhe procedura të qarta për dorëzimin e kandidaturave.
- E drejta e barabartë e votimit konsiston në të drejta të barabarta të votimit, fuqinë e votimit (shpërndarjen e qartë dhe të baraspeshuar të vendeve sipas kriterëve specifike, barazinë e mundësive njësoj si për partitë, ashtu edhe për kandidatët, përfaqësimin e pakicave etnike, si dhe barazinë gjinore dhe paritetin.
- E drejta e votimit të lirë përfshin disa parime, duke përfshirë lirinë e votuesve që të krijojnë një mendim (kjo do të thotë se shteti duhet të jetë neutral sa i përket financimit të partive, mediave, demonstratave, etj., dhe se autoritetet duhet t'u mundësojnë votuesve që t'i njohin personat për të cilët ata votojnë, si dhe shqiptimin e masave për shkeljet e caktuara.
- E drejta e votimit të lirë po ashtu do të thotë se votuesit duhet të jenë në gjendje t'i shprehin dëshirat e tyre dhe të luftojnë mashtrimin zgjedhor: kjo do të thotë se procedurat e votimit duhet të jenë të thjeshta dhe administrata duhet të jetë transparente.
- Votimi i fshehtë: Për votuesin, votimi i fshehtë nuk është vetëm e drejtë por edhe detyrë, dhe çdo fletëvotim i publikuar duhet të diskualifikohet. Votimi duhet të jetë individual dhe nuk duhet të publikohet asnjë listë e personave që në të vërtetë votojnë.
- Votimi i drejtpërdrejtë: Kodi i Komisionit të Venedikut po ashtu vë në dukje se duhet të zgjedhen me votim të drejtpërdrejtë, si vijon:
 1. Së paku një dhomë e parlamentit nacional;
 2. Organet legjislativë nën-nacionale; dhe
 3. Këshillat Lokale.
- T'i kthehemi edhe një herë kësaj, çdo proces kushtetues është lokal, dhe se çfarëdo që ndodh me kushtetutën e Kosovës, ajo do të duhet dhe duhet të pasqyroj rrethanat e veçanta të Kosovës. Baraspesha duhet të gjendet ndërmjet ligjeve dhe Kushtetutës, dhe se procesi duhet të jetë transparent, ashtu që të ketë besim në sistem.
- Faleminderit që më dëgjuat dhe kërkoj falje që e zgjata kaq shumë!

SISTEMI I ZGJEDHJEVE.

1. Nevoja për paanësi në procedurat e zgjedhjeve, krijimi i kufijve të zonave zgjedhore dhe administrimi i zgjedhjeve. Roli i një komisioni të zgjedhjeve të paanshëm.
2. Sistemi i zgjedhjeve. Përfaqësimi proporcional më përshtatshëm për një shoqëri të ndarë. POR – përfaqësim proporcional nuk quhet një sistem i vetëm të zgjedhjeve, por një llojllojshmëri e tërë e sistemeve, secili prej tyre kërkon që të arrijë një përfaqësim ideal sipas zgjedhjes së zgjedhësve.

ZGJEDHJET KRYESORE QË DUHET BËRË;

- a. Sistemi i listës kombëtare ose i listës së zonave zgjedhore. Shembulli i Izraelit.
- b. Niveli i pragut nën të cilin një parti nuk mund të ketë përfaqësim.
- c. Më e rëndësishmja mbi të gjitha – nëse sistemi ua mundëson zgjedhësve për të zgjedhur mes kandidatëve të ndryshëm të partisë që ata e preferojnë – madje edhe në mesin e partive të ndryshme – ose nëse i kufizon ata për të votuar për listën e një partie, me renditjen e kandidatëve që përcaktohet nga partia.

Listat e MBYLLURA. Izraeli dhe Gjermania. Sistemi gjerman.

Listat FLEKSIBILE. Belgjika.

Listat e HAPURA. Finlanda. Kombinon zgjedhjet e përgjithshme me zgjedhjet primare.

Listat e LIRA. Zvicra dhe Luksemburgu. Mbase më i përshtatshëm për shoqëritë konsensuale.

Vernon Bogdanor,
Korrik 2006

Çështje të tjera Kushtetuese

Vullf-Majkëll Mors
Misioni i OSBE-së në Kosovë
Vullf-Majkëll.Mors@osce.org

Përmbajtja

- Krahasimi i Kushtetutave
- Zhvillimi Kushtetues
- Transferi i Sovranitetit

Krahasimi i Kushtetutave



Kushtetutat normative dhe simbolike
→ shkalla e ndikimit në realitetin social dhe politik

Krahasimi i Kushtetutave




Kushtetutat relevante dhe rituale
→ niveli i efikasitetit regullon sjelljen politike dhe shoqërore

Krahasimi i Kushtetutave



Kushtetutat kërkuese dhe diskriptive
→ raporti ndaj fuqive/ kompetencave de fakto në shoqëri

Zhvillimi/ Ndryshimi i Kushtetutës



Ndryshimi i formulimeve
në Kushtetutë

Ndryshimi i interpretimeve
në Kushtetutë

Ndryshimi i formulimeve në Kushtetutë

Kushtetutat Fleksibile/ Rigjide

- Kushtetutë që nuk shkruhet në një dokument
- Shumica parlamentare
- Burime të ndryshme kushtetuese
- Vetëm disa shembuj
- Kushtetutë e shkruar në një dokument
- Mbrojtje nga fleksibiliteti i tepërt
- Teorikisht teksti duhet të jetë burimi i vetëm
- Modeli më i zakonshëm

Gjermania

Neni 79 [Amandamenti i Kushtetutës]

- (1) Kushtetuta mund të ndryshohet vetëm përmes aktit të parlamentit, përmes të cilit bëhet ndryshimi apo plotësimi i tekstit të saj me qëllim të caktuar. [...]
- (2) Çdo akti i tillë i parlamentit kërkon pëlqimin e dy të tretave të anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve [Bundestagut] si dhe dy të tretat e votave të Senatit [Bundesratit].
- (3) Amandamentet e kësaj Kushtetute që ndikojnë në ndarjen e Federatës në shtete [Länder], pjesëmarrjen në parim të shteteve në legjisllacion [Länder], apo në parimet bazë të përcaktuara në Nenin 1 dhe 20 janë të papranueshme.

Gjermania

- Propozimi nga Qeveria, 5% të deputetëve apo Senati (Bundesrati)
- Amandamentet duhet të përcaktohen dhe deklarohen qartazi
- 2/3-at e të dy dhomave
- Limit absolut

Danimarka

Seksioni 88 [Amandamentet Kushtetuese, Vota e zgjedhësve]

Kur Parlamenti miraton një Projektligj për përfshirjen e një dispozite të re në Kushtetutë, dhe kur Qeveria është e gatshme ta mbështesë këtë çështje, atëherë do të bëhet ftesë për zgjedhje të anëtarëve të Parlamentit të ri. Ndërsa, nëse Projektligji miratohet pa ndryshime në Parlamentin, i cili mblihet pas zgjedhjeve, atëherë Projektligji gjashtë muaj pas miratimit të tij do t'i prezantohet zgjedhësve për miratim apo refuzim përmes votimit të drejtpërdrejtë. Rregullat e votimit do të përcaktohen përmes Aktit të Parlamentit. Nëse shumica e personave që marrin pjesë në votim, e së paku 40 për qind e elektoratit ka votuar në favor të Projektligjit, ashtu si është miratuar nga Kuvendi, dhe nëse Projektligji merr pëlqimin e Mbretërisë, atëherë Projektligji do të bëhet pjesë integrale e Kushtetutës.

Danimarka

- Çdo deputet mund të paraqesë një projektligj
- Parlamenti e miraton projektligjin
- Parlamenti shpërndahet
- Zgjedhjet parlamentare
- Parlamenti i ri e miraton projektligjin
- Aprovimi me referendum me pjesëmarrje prej më së paku 40 % të votuesve

Slovenia

[Pjesa] IX Procedurat për ndryshimin e Kushtetutës

Neni 168 (Propozimi për iniciimin e procedurës)

(1) Propozimi për iniciimin e procedurës për ndryshimin e Kushtetutës mund të bëhet nga njëzet deputetë të Kuvendit, nga Qeveria apo të paktën njëzetmijë votues.
(2) Për propozim të këtillë vendos Kuvendi me shumicën prej dy të tretave të deputetëve prezent.

Neni 169 (Ligjet/ Aktet për ndryshimit të Kushtetutës)

Kuvendi i miraton ligjet/ aktet për ndryshimin e Kushtetutës me shumicë, dy të tretat e të gjithë deputetëve.

Neni 170 (Konfirmimi i ndryshimeve kushtetuese me referendum)

(1) Kuvendi është i obliguar që t'ia paraqesë ndryshimet e propozuara kushtetuese votuesve për miratim në referendum, nëse një gjë e tillë kërkohet nga së paku tridhjetë deputetë.

(2) Një ndryshim kushtetues mund të miratohet në referendum nëse shumica e votuesve, që marrin pjesë në votim, votojnë në favor të ndryshimeve dhe me kusht që shumica e votuesve merr pjesë në referendum.


Neni 171 (Shpallja e ndryshimeve kushtetuese)

Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi pas shpalljes së tyre në Kuvend.

Slovenia

- Propozimi nga 20 deputetë, Qeveria apo të paktën 30.000 votues
- 2/3-at e deputetëve prezent miratojnë propozimin për iniciimin e procedurës
- Miratimi nga 2/3-at e deputetëve
- 30 deputetë mund të kërkojnë referendum
- Aprovimi me referendum me pjesëmarrjen e së paku 50 % të votuesve

Zhvillimi/ Ndryshimi i Kushtetutës



Ndryshimi i formulimeve
në Kushtetutë

Ndryshimi i interpretimeve
në Kushtetutë

Ndryshimi i interpretimeve në Kushtetutë

Danimarka

- Autoriteti suprem
- Mbreti nuk do të japë llogari për veprimet e tij; personalitetit i tij është i paprekshëm.
- Emërimi/ Shkarkimi i ministrave
- Shpërndarja e parlamentit/ zgjedhjet e reja

Transferi i Sovranitetit Gjermania

Neni 24 [Sistemi kolektiv i sigurisë]

(1) Federata sipas ligjit mund të transferojë pushtetin sovran tek insitucionet ndërqeveritare.

[...]

(2) Me qëllim të ruajtjes së paqes, Federata mund të bëhet pjesë e sistemit të përbashkët të sigurisë kolektive; në këtë mënyrë, duke u pajtuar me kufizime të tilla të sovraniteti, ajo do të kontribuojë në krijimin e rendit dhe paqes afatgjate si në Evropë ashtu edhe midis popujve të tjerë në mbarë botë.

[..]

Gjermania

Neni 23 [Unioni Evropian]

(1) Me qëllim të realizimit të unifikimit të Evropës, Gjermania merr pjesë në zhvillimin e Bashkimit Evropian, i cili mbështetet në parime demokratike, të sundimit të ligjit, dhe atyre sociale dhe federale si dhe në parimin e subsdiaritetit dhe siguron mbrojtjen e të drejtave elementare, që në thelb janë të njëjta me ato të kësaj Kushtetute. Së këtejmi, federata mundet që me pajtimin e Senatit [Bundesratit], ta delegojë fuqi/kompetenca që burojnë nga sovraniteti. Neni 79 II dhe III është i aplikueshëm si për Bashkësinë Evropiane ashtu edhe për dispozitat/ rregulloret përmes së cilave ndryshohet domethënia e kësaj Kushtetute, apo për ato ndryshime për të cilat Parlamenti është kompetent.

Gjermania

- Bashkimi Evropian që mbështetet në parime demokratike, të sundimit të ligjit, dhe atyre sociale dhe federale si dhe në parimin e subsdiaritetit dhe siguron mbrojtjen e të drejtave elementare, që në thelb janë të njëjta me ato të kësaj Kushtetute
- Shumica prej 2/3-ave në të dhomat
- Limit absolut

Danimarka

Seksioni 20 [Delegimi i kompetencave/ pushtetit]

- 1) Pushteti/ kompetencat e Mbretërisë sipas Kushtetutës mund, për aq sa do të përcaktohet me Aktin e Parlamentit, t'i delegohet autoriteteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve reciproke me shtete të tjera, me qëllim të promovimit të sundimit të ligjit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit.
- (2) Për miratimin e një Projektligji që merret me çështjet e sipërpërmendura nevojiten pesë të gjashtat e deputetëve të Parlamentit. Nëse kjo shumicë e votave nuk mund të sigurohet, por sigurohet vetëm shumica që nevojitet për miratimin e Projektligjeve të rëndomta, dhe nëse Qeveria e mbron këtë Projektligji, atëherë Projektligji do t'i dorëzohet Elektoratit për miratim apo refuzim në pajtim me rregullat e Referendumit të përcaktuara në Seksionin 42.

Danimarka

- Ligji
- për promovimin e sundimit ndërkombëtar të ligjit dhe bashkëpunimit
- Shumica prej 5 të 6-tave
- Nëse nuk arrihet shumica në parlament, atëherë duhet t'i dërgohet elektoratit për miratim → Ku duhet të votojë shumica dhe ku duhet të marrin pjesë në votim jo më pak se 30% të elektoratit

Slovenia

Neni 3a [Unioni Evropian]

- (1) Pas ratifikimit të traktatit të Kuvendit të miratuar me votën e shumicës prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, Sllovenia ka të drejtë t'ia transferojë disa të drejta, që burojnë nga sovraniteti i saj, organizatave ndërkombëtare, të cilat i respektojnë të drejtat elementare njerëzore, demokracinë dhe parimet e sundimit të ligjit dhe njëherësh mund të hyjë në aleanca ushtarake me shtetet që i respektojnë këto vlera.
- (2) Para ratifikimit të traktatit në paragrafin e mësipërm, Kuvendi ka të drejtë të organizojë referendum. Propozimi konsiderohet i miratuar nëse në referendum nëse shumica e atyre që kanë marrë pjesë në të kanë votuar favor të propozimit. Ndërsa, Kuvendi është i detyruar ta respektojë vendimin e dalë nga referendumi. Nëse mbahet një referendum i këtillë, atëherë nuk do të ketë nevojë për mbajtjen e referendumit për ligjin mbi ratifikimin e traktatit në fjalë.
- (3) Aktet ligjore dhe vendimet e miratuara nga organizatat ndërkombëtare, tek të cilat Sllovenia ka transferuar disa të drejta që burojnë nga sovraniteti i saj, do të jenë të zbatueshme në Slloveni në pajtim me rregullat ligjore të këtyre organizatave.
- (4) Qeveria do ta informojë Kuvendin si për propozimet për aktet dhe vendimet ashtu edhe për aktivitetet e veta rreth procedurave për miratimin e akteve ligjore dhe vendimeve që merren në organizatat ndërkombëtare, tek të cilat Sllovenia ka transferuar ushtrimin e disa të drejtave që burojnë nga sovraniteti i saj. Ndërsa, Kuvendi mund t'i miratojë qëndrimet e veta, të cilat Qeveria do t'i marrë parasysh gjatë aktiviteteve të saja. Marrëdhëniet e Kuvendit me Qeverinë që dalin nga ky paragraf do të rregullohen në hollësi nga një ligj që do të miratohet nga votat e dy të tretave të deputetëve prezent.

Slovenia

- organizata ndërkombëtare që i respektojnë të drejtat elementare njerëzore, demokracinë dhe parimet e sundimit të ligjit dhe njëherësh mund të hyjë në aleanca ushtarake me shtetet që i respektojnë këto vlera.
- dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve
- Parlamenti mund të organizojë referendum (nëse po, atëherë ata janë të obliguar ta respektojë atë)
- Veprimet e Qeverisë në organizata përkatëse



Dispozitat kushtetuese shitesë

Paul R. Williams

E drejta Ndërkombëtare Publike dhe
Grupi për Politikë

www.publicinternationallaw.org

Dispozitat

- Miratimi i kushtetutës
- Amandamentimi i kushtetutës
- Identiteti shtetëror
- Epërsia e Kushtetutës
- Identitetit kombëtar
- Shtetësia
- Kryeqyteti zyrtar, flamuri, himni, simboli dhe festat
- Gjuha zyrtare
- Gjendja e jashtëzakonshme

Promulgimi I kushtetutws

- Sigurimi i mekanizmave efektivë për dekretimin dhe amendamentimin e një kushtetute është thelbësor për garantimin e integritetit dhe të stabilitetit të dokumentit.
- Shumë shtete pas konfliktit e kushtëzojnë futjen në fuqi të kushtetutës së re me anë të miratimit formal të saj. Shtetet, zakonisht zgjedhin të miratojnë kushtetutat e tyre nëpërmjet njëres prej dy mënyrave: (1) votës së legjislativit ose (2) me anë të referendumit popullor. Një numër i vogël kushtetutash të pas konfliktit lejojnë të dy këta mekanizma miratimi. Pavarësisht nga plan veprimi i miratimit, kushtetuta mund, gjithashtu, ta specifikojë datën kur do të hyjë në fuqi.

Vota e Legjislativit

Disa shtete pas konfliktit i miratojnë kushtetutat e tyre nëpërmjet miratimit të legjislativit, në mënyrë tipike me anë të dy të tretave ose tri të katërtave të votave shumicë. Pas miratimit të kushtetutës nga numri i kërkuar i legjislatorëve, ajo mund të hyjë në fuqi ditën kur shpallet në legjislaturë. Një përparësi e kërkitit të më shumë sesa një shumicë e thjeshtë është se e thekson rëndësinë e përkrahjes së gjerë dhe siguron se kushtetuta është duke e përfaqësuar vullnetin e më shumë se vetëm një shumicë të ngushtë të partive, që do të ndihmojë në avancimin e stabilitetit më të madh.

Shembulli tekstual: Vota e legjislativit

Kjo kushtetutë miratohet nga [dy të tretat/tri të katërtat] e votave shumicë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në Kuvend.

Kjo kushtetutë hyn në fuqi ditën kur ajo shpallet në Kuvend.

Amandamentimi I kushtetutws

Shumica e kushtetutave pas konfliktit krijojnë një procedurë të pandryshueshme për propozimin dhe miratimin e amendamenteve. Procedura është e rëndësishme sepse ndryshimet e një kushtetute mund t'i ndryshojnë parimet themelore të shtetit dhe potencialisht të ndikojnë në pjesën më të madhe ose në tërë popullatën. Në përvijimin e procesit të amendamentimit të një kushtetute, ka disa pika kryesore që një shtet pas konfliktit duhet t'i shqyrtojë: procesi për propozimin e amendamenteve; procesi për hartimin e amendamenteve; dhe vendimi nëse duhet futur kufizime në tëmën në fjalë dhe/ose në caktimin e kohës për amendamentet.

Procesi për propozimin e amendamenteve

Kushtetutat mund të specifikojnë një ose më shumë metoda për propozimin e amendamenteve; mundësitë mund të ndahen në katër kategori të përgjithshme.

Së pari, një amendament mund të propozohet me anë të votës së një numri të pandryshueshëm të anëtarëve të legjislativit të shtetit. Për shembull, numri i pandryshueshëm mund të jetë një e pesta, një e treta, një e dyta ose dy të tretat e anëtarëve. Mundësia e dytë është kur i tërë autorizimi i jepet vetëm Ekzekutivit. Mundësia e tretë është dhënia e kompetencave një grupi të madh qytetarësh me të drejtë vote. Madhësia e këtij grupi duhet të jetë mjaftë i vogël sa të mundësojë diskutime kuptimplote, por edhe mjaftë i madh sa të demonstrojë zotim ndaj një pjese domethënëse të popullatës. Mundësia e fundit është t'i mundësohet publikut të gjerë të propozojë amendamente nëpërmjet një referendumit popullor. Kushtetuta mund të përfshijë cilindo kombinim të këtyre katër mundësive.

Shembulli tekstual: Propozimi i amendamenteve

Mundësia 1: Vota e legjislativ

Iniciativa për revizionimin e kësaj kushtetute mund të ndërmerret nga jo më pak se [dy të tretat/tri të katërtat] e anëtarëve të Kuvendit.

Mundësia 2: Propozimi i ekzekutiv

Propozimi për amendamentimin e cilësdo dispozitë të kushtetutës mund të iniciohet nga [Kryetari/kryeministri].

Mundësia 3: Kuvendi kushtetues

Propozimet për amendamentimin e kësaj kushtetute mund të bëhen me anë të një kuvendi kushtetues, të përbërë nga [numri] personat me të drejtë vote.

Mundësia 4: Referendumi popullor

Propozimet për amendamentimin e kësaj kushtetute mund të bëhen nga njerëzit me anë të një referendumi popullor.

Procesi i hartimit të amendamenteve

Disa kushtetuta pas konfliktit përfshijnë dispozita speciale dhe/ose kërkesa për hartimin e një amendamenti të propozuar. Disa shtete pas konfliktit kërkojnë krijimin e një komisioni qeveritar për përgatitjen e një drafti të amendamentit kushtetues të propozuar. Pothuajse ka mundësi të pakufishme procedurash me anën e të cilave shtetet e pas konfliktit mund të lejojnë amendamente të kushtetutave të tyre. Pa marrë parasysh se çfarë janë procedurat e përzgjedhura, shtetet ndodhë ta dëshirojnë shqyrtimin e nevojës për një shkallë të lartë të mbështetjes publike për ndryshimin e kushtetutës. Po ashtu, shtetet mund ta shqyrtojnë nevojën për kohën e mjaftueshme që i nevojitet publikut dhe legjislativit në mënyrë që ta kuptojnë dhe ta debatojnë ndryshimin e propozuar.

**Shembulli tekstual: Hartimi i amendamenteve
Krijimi i Komisionit Special**

Me qëllim të zbatimit të propozimeve që kanë të bëjnë me amendamentin e kushtetutës, me anë të një dekreti presidencial do të krijohet komisioni i përbërë nga anëtarët e [Qeverisë/Kuvendit/Gjykatës Supreme], ndërsa komisioni do ta përgatisë një draft amendamentesh.

Procesi i miratimit të amendamenteve

Procesi i miratimit të amendamenteve të kushtetutës ndryshon në masë të madhe nëpër shtete. Për shkak se kushtetutat i parashirojnë parimet thelbësore dhe strukturat themelore të një shteti, shumë shtete vendosin të kërkojnë nivel më të lartë të pajtimit social dhe politik për amendamentimin e kushtetutës sesa për miratimin e legjislationit të përgjithshëm.

Plan veprimet e mundshme të miratimit përfshijnë:

- (1) miratimi i amendamentit të propozuar nga një numër i pandryshueshëm i anëtarëve të legjislativ;
- (2) miratimi i amendamentit të propozuar nga një numër i pandryshueshëm i anëtarëve të legjislativ plus klauzola shtojcë e ekzekutiv;
- (3) miratimi i amendamentit të propozuar nga një numër i pandryshueshëm i anëtarëve të legjislativ i përcjellur me ratifikimin nga referendumi popullor;
- (4) nënshtrimi i amendamentit të propozuar për miratim në referendum;
- (5) miratimi nga një numër i pandryshueshëm i legjislativ të shteteve anëtare të kombit; dhe
- (6) debati publik dhe referendumi.

Shembulli tekstual: Miratimi i amendamenteve

Mundësia 1: Miratimi nga Legjislativi kombëtar

Amendamentet kushtetuese duhet të miratohen nga shumica [dy të tretat/tri të pestat] e anëtarëve të Kuvendit.

Mundësia 2: Miratimi nga Legjislativi kombëtar

I shoqëruar nga miratimi i Ekzekutiv
Amendamentet kushtetuese duhet të miratohen nga shumica [dy të tretat/tri të pestat] e anëtarëve të Kuvendit. Menjëherë pas miratimit nga legjislativi, ekzekutivi duhet ta parafojë amendamentin para se ai të hyjë në fuqi.

Mundësia 3: Miratimi nga Legjislativi kombëtar

I shoqëruar nga Referendumi Popullor
Amendamentet kushtetuese duhet të jenë të miratuara nga shumica [dy të tretat/tri të pestat] e anëtarëve të Kuvendit. Posa të jetë miratuar amendamenti nga Kuvendi, ai duhet t'i nënshtrohet ratifikimit nëpërmjet referendumit, që do të drejtohet sipas ligjit mbi referendumin.

Mundësia 4: Referendumi popullor

Amendamenti duhet të bëhet i ratifikuar pas miratimit nga [dy të tretat/tri të katërtat] personat me të drejtë vote në kuadër të referendumit popullor.

Mundësia 5: Miratimi nga Legjislativi shtetëror

Amendamenti duhet të ratifikohet nga legjislativat [dy të tretat/tri të katërtat] e provincave ose nga konventat [dy të tretat/tri të katërtat].

Mundësia 6: Miratimi nga Legjislativi kombëtar

I shoqëruar nga debati publik dhe referendumi
Një amendament i propozuar, pas miratimit nga Kuvendi, duhet t'i nënshtrohet debatit publik dhe një referendumi.

Kufizimet

Meqë kushtetutat përfshijnë shpesh parime fundamentale dhe thelbësore të shtetit, shtetet e pas konfliktit mund ta dëshirojnë kufizimin e amendamentimin të kushtetutave të veta. Në mënyrë specifike, disa shtete nuk lejojnë kurrfarë amendamentimi të kushtetutës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose luftës. Të tjerat i ndalojnë amendamentet që kanë të bëjnë me religjionin. Shtetet tjera i kufizojnë amendamentet kushtetutare që u përkasin të drejtave fundamentale në mënyrë që amendamenti të jetë i pamundur përveç nëse të drejtave të tilla u sigurohet mbrojtje më e madhe. Së fundi, disa shtete i kufizojnë amendamentet në atë mënyrë që ato të mos mund t'i ndryshojnë aspektet fundamentale të shtetit.

Shembulli tekstual: Kufizimet

- *Nu ka amendamente gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose luftës:*
Kjo kushtetutë nuk mund të amendamentohet gjatë një [gjendja e jashtëzakonshme].
- *Nuk ka amendamente që kanë të bëjnë me religjionin:*
Nuk lejohen amendamentet që kanë të bëjnë me bazat e religjionit shtetëror.
- *Nuk ka dobësim të të drejtave fundamentale :*
Amendamentet që kanë të bëjnë me të drejtat fundamentale të njerëzve lejohen vetëm me qëllim të shtimit të efikasitetit të tyre.
- *Nuk ka ndryshime në natyrën e shtetit:*
Asnjë amendament kushtetutar nuk mund ta shkelë natyrën e shtetit ose integritetin e territorit kombëtar.

Identiteti shtetëror

Kushtetutat mund ta identifikojë llojin e qeverisë dhe kufijtë e shtetit që ajo qeveri i qeverisë, ashtu si edhe natyrën e kufijve. Shumë kushtetuta pas konfliktit, po ashtu, përfshijnë një dispozitë që shpallë pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit. Deklarata e tillë mund ta përfshijë gjuhën që thekson se sovraniteti i shtetit është i patjetërsueshëm, i pandashëm dhe i patransferueshëm. Po ashtu, kjo dispozitë mund të theksojë se burimi i sovranitetit-përgjithësisht e ka prejardhjen nga njerëzit dhe se u takon atyre.

Shembulli i gjuhës: Identiteti shtetëror

Kufijjtë:

Kufijjtë e [shtetit] janë [përshkrimi gjeografik i kufijve]. Kufijjtë mund të ndryshohen vetëm në pajtim me ligjin ndërkombëtar, me mjete paqësore dhe sipas marrëveshjes.

Lloji i qeverisë:

[Shteti] është një [republika parlamentare].

Sovraniteti:

[Shteti] është shtet i pavarur dhe sovran. Sovraniteti është i patjetërsueshëm, i pandashëm, i patransferueshëm, ndërsa buron nga, dhe u takon njerëzve të [shtetit].

Epërsia e Kushtetutës

Kushtetutat e pas konfliktit përfshijnë një dispozitë që siguron se ajo është ligji suprem i vendit dhe se të gjitha ligjet që nuk janë pajtueshmëri me të nuk kanë kurrfarë fuqie. Përfshirja e një dispozite të tillë mund t'i parandalojë qeveritë krahinore ose komunale nga miratimi i ligjeve që nuk janë në pajtim me parimet kushtetuese.

Shembulli tekstual: Epërsia e Kushtetutës

Kjo Kushtetutë është ligji suprem i [shtetit]. Cilido ligj që nuk është në pajtim me Kushtetutën duhet të anulohet.

Identiteti kombëtar

Shtetet pas konfliktit që përmbajnë përkatësi kombëtare ose etnike përfshijnë shpesh një dispozitë në kushtetutën e tyre që përshkruan identitetin e tyre kombëtar. Gjatë përshkrimit të identitetit kombëtar, kushtetutat mund ta njohin shumëllojshmërinë e kombeve brenda shteteve, derisa njëkohësisht t'i përmendin veçoritë e përbashkëta dhe të veçanta të qytetarëve të shtetit.

Shembulli tekstual: Identiteti kombëtar

[Shteti] është vend i shumë përkatësive kombëtare. [Shteti] u takon të gjithëve që jetojnë në të, të bashkuar me diversitetin tonë, historinë e përbashkët, qëllim dhe fat, dhe të përkushtuar për të punuar bashkërisht për avancimin e qeverisjes së mirë dhe të mirëqenies së të gjithë qytetarëve të [shtetit].

Shtetësia

Shumë kushtetuta pas konfliktit e adresojnë shtetësinë në një ose dy mënyra: qoftë nëpërmjet përshkrimit të kushteve specifike për shtetësi ose thjeshtë duke cekur se qytetarët kanë si të drejtë ashtu edhe obligim për marrjen e shtetësisë. Nëse shteti në kushtetutën e vet, përcakton detajisht kushtet për shtetësi, ky seksion përfshinë mjetet me anën e të cilave individët cilësohen për shtetësinë e shtetit. Mënyrat e zakonshme për marrjen e shtetësisë janë lindja në shtet, posedimi i njërit ose të dy prindërve si shtetasë, ose të qenit i natyralizuar si shtetas i atij shteti.

Shembulli tekstual: Shtetësia

Mundësia 1: Të drejtat dhe obligimet ndaj shtetësisë

Të gjithë qytetarët e [shtetit] u takojnë në mënyrë të barabartë të drejtat, privilegjet dhe përfitimet nga shtetësia; dhe në mënyrë të barabartë u nënshtrohen obligimeve dhe përgjegjësisë ndaj shtetësisë.

Mundësia 2: Kushtet për marrjen e shtetësisë

Cilido person që ka lindur në [shteti], që ka njërin prind qytetar të [shtetit], ose që është natyralizuar si qytetar i [shtetit], do të konsiderohet qytetar i [shtetit].

Kryeqyteti zyrtar, flamuri, himni, simboli dhe festat

Disa kushtetuta pas konfliktit i specifikojnë kryeqytetin e shtetit, flamurin zyrtar, simbolin, himnin dhe festat. Sido që të jetë, shumë kushtetuta pas konfliktit sigurojnë se specifikat e këtyre çështjeve duhet të përcaktohen me ligj. Nëse dispozitat e tilla janë të detajuara në kushtetutë, ato në përgjithësi janë përshkrime të thjeshta dhe të drejtpërdrejta.

Mundësia 1: Specifikimi i kryeqytetit të shtetit, flamurit, himnit, simbolit dhe festave në Kushtetutë

Kryeqyteti i [shtetit] është [kryeqyteti].

Flamuri kombëtar është [përshkrimi i flamurit].

[Shenja/simboli] i [shtetit] është [përshkrimi i shenjës/simbolit].

Himni kombëtar i [shtetit] është [titulli i himnit kombëtar].

Festat(k) kombëtare të [shtetit] [është/janë] [titulli dhe data(t) e festës(ave) kombëtare].

Mundësia 2: Përcaktimet specifike të kryeqytetit të shtetit, flamurit, himnit, simbolit dhe festave zyrtare i lihen ligjit

Përcaktimi i kryeqytetit, festave kombëtare, forma dhe dimensionet e flamurit dhe të simboleve kombëtare, përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar dhe përdorimi i tyre do të rregullohen me ligj.

Gjuha zyrtare

Disa kushtetuta pas konfliktit gjuhë zyrtare të shtetit përcaktojnë një ose më shumë gjuhë. Megjithatë, në shtetet ku fliten shumë gjuhë, njohja kushtetuese e një gjuhe zyrtare mund të çojë deri te fërkimi ose konflikti për shkak të marginalizimit të perceptuar të individëve që flasin gjuhë jozyrtare. Njëra mundësi është mandatimi i një ose më shumë gjuhëve zyrtare. Mundësia e dytë është shpallja e një ose më shumë gjuhëve zyrtare, në të njëjtën kohë duke njohur dhe mundësuar dhe/ose mbrojtur përdorimin e gjuhëve tjera. Kjo e fundit mund të dëshirohet në shtetet me shumë gjuhë indigjene ose rajonale.

Mundësia 1: Mandatimi i një ose më shumë gjuhëve zyrtare [Gjuha(ët)] do të jenë gjuhë zyrtare.

Mundësia 2: Mandatimi i gjuhës(ve) zyrtare, por mbrojtja edhe e gjuhëve tjera

[Gjuha(ët)] do të jenë gjuhë zyrtare. Garantohej barazia e të gjitha gjuhëve, ndërsa qytetarët kanë të drejtë t'i arsimojnë fëmijët e tyre në gjuhën e tyre amtare.

Gjendja e jashtëzakonshme

Kushtetutat e pas konfliktit zakonisht përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me gjendjet e jashtëzakonshme.



Definimi i gjendjes së jashtëzakonshme

Disa kushtetuta definojnë se çka e përbën një gjendje të jashtëzakonshme, qoftë gjatë gjendjes së luftës, rrezikut të drejtëpërdrejtë të pavarësisë dhe unitetit të vendit, ose në rast të fatkeqësive të rënda natyrore. Të tjerat, definimin dhe shpalljen e gjendjeve të jashtëzakonshme ua lënë zgjedhjes së një ose më shumë degëve të qeverisë.

Shembulli tekstual: Definimi i një gjendjeje të jashtëzakonshme

Mundësia 1: Definimi i shkoqitur

Shpallja e një gjendjeje të jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm nëse jeta e kombit kërcënohet me luftë, pushtim, kryengritje të përgjithshme, çrregullim, fatkeqësi natyrore ose gjendje tjera të jashtëzakonshme publike; ndërsa shpallja është e domosdoshme për rivendosjen e paqes dhe rendit.

Mundësia 2: Mundësimi i qeverisë për definim

Kur duket se një rrezik i pashmangshëm ka pasojë të rënda për rendin publik ose në rast se ngjarjet paraqiten vetvetiu, për nga natyra ose rëndësia e tyre, karakteri i fatkeqësisë publike ose natyrore, [Kryetari, Kryeministri/shumica e anëtarëve të Kuvendit] mund ta shpallin gjendjen e jashtëzakonshme.

Autorizimi për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme

Kushtetuta mund të përfshijë dispozitat që kanë të bëjnë me autorizimin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Disa vende pas konfliktit ua besojnë këtë kompetencë vetëm degës ekzekutive. Të tjerat kërkojnë konsensus më të gjerë siç është vota afirmative e dy të tretave shumicë të Kuvendit, me planin rezervë në rast se legjislativi nuk është në gjendje të takohet.

Shembulli tekstual: Autorizimi për

Mundësia 1: Ekzekutivi mund të shpallë

[Kryetari/Kryeministri] mund ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme.

Mundësia 2: Legjislativi mund të shpallë

Gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet me anë të një vote vërtetuese nga [shumica/dy të tretat] e anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk mund të thirret gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, [kryetari] i [shtetit], me propozimin e [Këshillit të Ministrave], mban të drejtën për të lëshuar akte që e kanë fuqinë e ligjit, e që duhet të miratohen nga Kuvendi në takimin e parë të tij.

Kufizimet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

Po ashtu, Kushtetuta mund t'i definojë llojet dhe gamën e kufizimeve gjatë një gjendjeje të jashtëzakonshme. Kufizimi i tillë ka për qëllim ndalimin e të gjitha amendamenteve. Mundësia e dytë është kufizimi i të gjitha kufizimeve të lejueshme atyre që nuk i përkasin të drejtave fundamentale siç janë: e drejta për jetë, ndalimi i torturës, trajtimit mizor ose degradues, ose të definimeve ligjore të kundërvajtjeve dhe ndëshkimeve penale.

Po ashtu, gjatë një gjendjeje të jashtëzakonshme, kushtetutat, mund të përfshijnë një dispozitë që ndalon shpërbërjen ose suspendimin e cilitdo organ shtetëror ose të kompetencave të tyre të dhëna me kushtetutë.

Shembulli tekstual: Kufizimet

Nuk ka amendamente kushtetuese:

Në gjendje të jashtëzakonshme nuk mund të ndërmerren kurrfarë revizionime të Kushtetutës.

Nuk ka amendamente kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat fundamentale:

Në gjendje të jashtëzakonshme të luftës, të drejtat dhe liritë e njeriut ashtu siç janë definuar me Kushtetutë dhe ligje tjera u nënshtrohen kufizimit vetëm me ligj.

Një ligj i tillë nuk mund të ndikojë në të drejtën për jetë, lirinë e të menduarit, ndërgjegjes, religjionit, si edhe të drejtën për të mos qenë subjekt i torturës ose trajtimit jonjerëzor dhe mizor.

Nuk ka shpërbërje të qeverisë

Kuvendi nuk mund të shpërbëhet në gjendje të jashtëzakonshme.

Kohëzgjatja e gjendjes së jashtëzakonshme

Hartuesit mund ta specifikojnë kohëzgjatjen maksimale të një gjendjeje të jashtëzakonshme dhe mënyrat, nëse ka ndonjë, me të cilat periudha e tillë të mund të zgjatet.

Shembulli tekstual: Kohëzgjatja

[Këshilli i Ministrave/Kryetari/Kryeministri] mund të shpallë një gjendje të jashtëzakonshme në njërin pjesë ose në tërë territorin shtetëror, që zgjatë aq kohë sa zgjatë rreziku, por jo më gjatë se [30/60/90] ditë.

Zgjatja e periudhës së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me miratimin e [Kuvendit], për çdo [30] ditë, për një periudhë kohore jo më të gjatë se [90] ditë.

